ISSN 2308-6106

AUDITIMI PUBLIK

KLSH

KËRKIMORE

SHKENCORE

INFORMATIVE

REVISTË 4-MUJORE Nr. 22

2019

ALSAI

EUROSAI

INTOSAI

Seria : botime KLSH - 07/2019/109

Tiranë, 2019

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Experentia mutua omnibus prodest

AUDITIMI PUBLIK

REVISTË KATËRMUJORE

kërkimore-shkencore-informative

shqip-anglisht

Nr. 22/2019, Tiranë

ISSN 2308-6106

Viti i VIII-të i botimit 2019

Janar - Prill 2019

Seria: botime KLSH – 07/2019/109

Titulli:

AUDITIMI PUBLIK NR. 22

Redaktore: Irena Islami

Amantja Patozi

Art Design: Elisa Metaj

Seria: botime KLSH - 07/2019/109

Shtypur në Shtypshkronjën ”JUPITER Group”

Tiranë 2019

ALBANIAN SUPREME AUDIT INSTITUTION

Experentia mutua omnibus prodest

PUBLIC AUDIT

of research, science and information
in Albanian and in English

No. 22/2019, Tirana
ISSN 2308-6106
January - April 2019
Series:Publications ALSAI -07/2019/109

BORDI SHKENCOR

Dr. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH	Kryetar
Prof. Dr. Omer Stringa Profesor, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Dhori Kule, Dekan, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Jorgji Bollano, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Kontabilistëve	Anëtar
Prof. Dr. Skënder Osmani, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave	Anëtar
Prof. Dr. Ardian Nuni, Fakulteti i Drejtësisë	Anëtar
Prof. Dr. Sotiraq Dhamo, Përgjegjës i Departamentit të Kontabilitetit FE (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Aurela Anastasi, Akademik, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Argita Berisha, Profesor, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Lindita Lati, Drejtore e Përgjithshme, KLSH	Anëtar
Prof. Dr. Heinz-Dieter Wenzel, Profesor, Universiteti i Bambergut, Gjermani	Anëtar
Dr. Igor Soltes, ish-President i Gjykatës së Auditimit të Sllovenisë	Anëtar
Dr. Sang M. Lee, Universiteti i Nebraskës, SHBA	Anëtar
Prof. Dr. Tonin Kola, Profesor, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Prof. As. Dr. Sazan Guri, Instituti " G& G Group"	Anëtar
Prof.As. Dr. Manjola Naço, Drejtore e Përgjithshme, KLSH	Anëtar
Prof.As.Dr. CPA Hysen Çela, Kryetar i IEKA**,** Managing Partner,nH EuroConsult	Anëtar
Prof. As.Dr. Flutura Kola, Profesor, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar

SEKRETARIATI

Irena Islami	Sekretare Kolegjiumi

I NDERUAR LEXUES !

Numri i 22-të i Revistës Kërkimore shkencore të KLSH-së është botimi i 109-të i kolanës së botimeve të KLSH-së.

Në këtë numër të Revistës kanë kontribuar me shkrimet e tyre personalitete të njohura të auditimit të jashtëm publik, auditues dhe drejtues të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA dhe të Gjykatës Evropiane të Audituesve, pedagogë, profesorë, Presidenti i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë, etj.

Janë të ftuar të publikojnë punimet dhe opinionet e tyre kontabilistë, financierë, ekonomistë të përgjithshëm, specialistë të enteve publike dhe private, akademikë, ekspertë të shoqërisë civile, profesionistë të pavarur si dhe çdo i interesuar që gjen me vend trajtimin e një çështjeje të caktuar me interes në auditimin dhe vlerësimin e administrimit publik të vendit, bazuar në moton e INTOSAI *"Experentia mutua omnibus prodest (Eksperienca e Përbashkët ju shërben të gjithëve)".*

Bordi Shkencor i Revistës ju fton të shprehni vërejtjet dhe sugjerimet tuaja në funksion të përmirësimit, të rritjes së cilësisë dhe efikasitetit të saj me qëllim që kjo Revistë Shkencore, të jetë një mundësi më shumë për zhvillimin e debatit në fushën e auditimit dhe më gjerë.

Adresa e redaksisë

Kontrolli i Lartë i Shtetit
Rruga "Abdi Toptani"nr. 1,
Tiranë Tel./ Fax. 04/ 228485, Tel. 04/ 251267
Web-site: www.klsh.org.al, E-mail: revista@klsh.org.al, klsh@klsh.org.al

PËRMBAJTJA

TITULLI	AUTORI	FAQE
Ta trajtojmë "kancerin e korrupsionit" përmes komunikimit, bashkëpunimit dhe zhvillimit të kapaciteteve	James-Christian Blockwood, Drejtor i Zyrës së Planifikimit Strategjik dhe Drejtor i Revistës Zyrtare të GAO-s. *Publikuar në INTOSAI Journal, Pranverë 2019*	**11**
Kuadri ndërkombëtar i angazhimeve të sigurisë, një garanci më shumë për shërbime profesionale cilësore	Prof.Dr.Hysen Çela President, IEKA	**15**
Ujërat e brendshme detare - koha për auditim	Prof.Dr.Sazan Guri "G&G" Group Ing.Alush Zaçe, KLSH	**23**
Ndikimi i faktorëve Makroekonomikë në numrin e njësive ekonomike të falimentuara	Brunilda Neli, Dr. Eni Numani Pedagoge, Universiteti i Tiranës Fakulteti i Ekonomisë	**31**
Opinionet e ECA-s mbi propozimet ligjore të Komisionit për luftën kundër mashtrimit	Eva Lindstrom, Anëtare e ECA-s; *Publikuar në revistën e ECA, Nr.2, 2019.*	**41**
Lidershipi i ndershëm si një përgjigje ndaj korrupsionit dhe mashtrimit	Alex Brenninkmeijer, Anëtar i ECA-s; *Marrë nga revista ECA Nr.2, 2019*	**47**
Ndryshimi i këndvështrimit: Nga lufta kundër korrupsionit tek ndërtimi i integritetit	Ina de Haan, Gjykata Hollandeze e Auditimit; *Publikuar në revistën e ECA, Nr.2, 2019.*	**53**

Mashtrimi dhe korrupsioni në BE: studimi i katër rasteve të fundit	Camilla Barlyng, Drejtoria e Presidencës, ECA *Publikuar në revistën e ECA, Nr.2, 2019.*	**59**
Info nga vendi	Aktivitete të KLSH – së (janar - prill 2019)	**63**
Kontrolli Financiar i Lihtenshtejnit	Profil	**95**
Komisioni Suprem i Llogarive i Principatës së Monakos	Profil	**97**

Content

Title	AUTHOR	PAGE
Addressing the "Cancer of Corruption" with communication, collaboration and capacity development	James-Christian Blockwood, Managing Director, GAO *INTOSAI Journal, Spring 2019*	**103**
The international framework of assurance engagements, one more guarantee for qualitative professional services	Prof.Dr.Hysen Çela President, IEKA	**107**
Marine waters – time to audit	Prof.Dr.Sazan Guri "G&G"Group Ing.Alush Zaçe, AL-SAI	**115**
The impact of macroeconomic factors in the number of bankrupt entities	PhD Cand.Brunilda Neli PhD. Eni Numani Faculty of Economy University of Tirana	**123**
ECA Opinions on the Commission's legislative proposals for fighting fraud	Eva Lindstrom ECA Member *ECA Journal No.2/2019*	**133**
Moral leadership as an answer to corruption and fraud	Alex Brenninkmeijer ECA Member *ECA Journal No.2/2019*	**139**
Flipping the narrative : from fighting corruption to building integrity	Ina de Haan Netherlands Court of Audit *ECA Journal No.2/2019*	**145**

Fraud and corruption in the EU :top four cases in recent times	Camilla Barlyng Directorate of the Presidency, ECA *ECA Journal No.2/2019*	**151**
Events and activities of ALSAI during January – April 2019	INFO	**157**
Financial Control of the Principality of Liechtenstein	Profile	**187**
Supreme Accounts Commission of the Principality Of Monaco	Profile	**189**

TA TRAJTOJMË “KANCERIN E KORRUPSIONIT” PËRMES KOMUNIKIMIT, BASHKËPUNIMIT DHE ZHVILLIMIT TË KAPACITETEVE

Jam me fat dhe krenar që jam pjesë e një organizate dhe e një komuniteti global që rrit vizibilitetin, partneritetet dhe aftësinë për të trajtuar këto tema - tema që kanë një rëndësi të konsiderueshme për ne si individë, organizata, kombe dhe botën.

Nga: James-Christian Blockwood, Drejtor i Zyrës së Planifikimit Strategjik dhe Drejtor i Revistës INTOSAI Journal

Publikuar në INTOSAI Journal, Pranverë 2019

Në fjalimin e tij si President i Bankës Botërore në vitin 1996, James David Wolfensohn theksoi nevojën për t’u fokusuar tek përgjegjshmëria, kapaciteti dhe transparenca për sigurimin e përdorimit të mjaftueshëm dhe efikas të burimeve, veçanërisht për grupet më në nevojë.

Në të njëjtën fjalim, ai nënvizoi besimin se ne gjithashtu duhet të merremi me "kancerin e korrupsionit". Ky është një mesazh bindës që përshkruan veprimet që dëmtojnë (vjedhjet, abuzimet) një komb dhe qytetarët e tij, minojnë besimin dhe dobësojnë besueshmërinë tek qeveria. Të vëzhguarit e korrupsionit përmes kësaj lente gjithashtu qartëson se - bota duhet të bëjë më shumë, sesa thjesht të trajtojë këtë "sëmundje". Ne duhet të punojmë për të kuruar problemin dhe të marrim masa për të parandaluar rikthimin e tij.

Megjithëse kemi bërë përparime në qasjen ndaj korrupsionit, duke pasur parasysh klimën globale ku pasiguritë janë të natyrshme në sisteme komplekse të qeverisjes - zhvendosjen demografike, ndryshimet ekonomike, risqet e reja e në zhvillim dhe inovacionin teknologjik - ende kemi punë për të bërë.

Ne duhet të udhëheqim përmes shembullit. Duhet të komunikojmë. Gjithashtu duhet të kthejmë fjalët tona në veprime dhe të krijojmë partneritete të qëndrueshme në një frymë të vërtetë bashkëpunimi dhe integriteti. Jam me fat dhe krenar që jam pjesë e një organizate dhe e një komuniteti global që rrit vizibilitetin, partneritetet dhe aftësinë për të trajtuar këto tema - tema që kanë një rëndësi të konsiderueshme për ne si individë, organizata, kombe dhe botën.

Vitet e fundit, teknologjia dhe të dhënat kanë ndikuar shumë në iniciativat anti-korrupsion dhe transparencën, kështu që nuk është për t'u habitur që këto tendenca janë në rritje në përputhje me komunikimet tona. Në të njëjtën kohë, të theksuarit e përpjekjeve për komunikim, bashkëpunim dhe për zhvillimin e kapaciteteve janë thelbësore, pasi këto elementë do të mbeten përherë në thelb të luftës kundër korrupsionit.

Zyra e Auditimit të Qeverisë së SHBA-së (GAO) ka bërë përparime të mëdha në krijimin e një klime të pasur me përbërësit thelbësorë të nevojshëm për të ndihmuar në luftën ndaj mashtrimit, shpërdorimeve, abuzimeve, keq-menaxhimit dhe në promovimin e mirëqeverisjes. Kritike për suksesin në këtë luftë janë zhvillimi dhe përdorimi nga GAO i mjeteve të tilla si Standardet e Auditimit të Përgjithshëm të Pranuara nga Qeveria, Standardet për Kontrollin e Brendshëm në Qeverinë Federale, dhe Kuadri për Menaxhimin e Rreziqeve të Mashtrimit në Programet Federale. Nën udhëheqjen e Kontrollorit të Përgjithshëm të SHBA, Gene L. Dodaro, GAO është munduar për shpërndarjen e njohurive gjerësisht dhe në të qenit një partner i gatshëm për të ndihmuar kudo dhe kurdo të jetë e nevojshme.

Unë dëshiroj të përdor të njëjtën qasje me funksionet si Drejtor i Planifikimin Strategjik dhe Përfaqësues i Marrëdhënieve me Jashtë i GAO-s (SPEL), që në përmbushje të këtyre detyrave të mbikëqyr disa programe me shtrirje globale - Revista Ndërkombëtare e Auditimit të Qeverisë (INTOSAI Journal), Programi Ndërkombëtar i Bursave për Audituesit (IAFP) dhe Qendra e Ekselencës në Auditim (CAE), të cilat i janë dedikuar aftësive për të komunikuar, lidhur dhe kultivuar me qëllim nxitjen e ndryshime pozitive në komunitetin global të llogaridhënies.

Revista është organi zyrtar i komunikimit i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), një organizatë ombrellë që siguron një kornizë të institucionalizuar për 194 Institucione Supreme të Auditimit (SAI) anëtare. Një burim thelbësor për informim dhe edukim, kjo gazetë ka qenë e dobishme në rritjen e aftësisë tonë për të ndarë këndvështrimet dhe praktikat më të mira mes anëtarëve të INTOSAI-t, gjë kjo që në mënyrë më gjithëpërfshirëse dhe të shpejtë është bërë përmes mediave sociale (audienca jonë në Twitter është më tepër se dyfishuar gjatë dy viteve të fundit) dhe gjithashtu nëpërmjet prezantimit të botimeve, të cilat meritojnë vëmendje dhe mes zhvillimit të qasjeve tematike, siç është edhe ky botim mbi anti-korrupsionin dhe mirëqeverisjen.

Aftësia e Revistës për të përfshirë dhe përçuar këndvështrime dhe përvoja të ndryshme në hapësira globale krijon një shumëzues forcash në përpjekjet tona për të lidhur më gjerësisht dhe ekspozuar qasje që mund të ndihmojnë në formimin e bashkësisë së llogaridhënies në të ardhmen.

Ndërkohë që komuniteti ynë vazhdon të përshtatet dhe përmirësohet, komunikimi do të bëhet një aftësi gjithnjë e më e

rëndësishme që, kur kombinohet me bashkëpunim dhe udhëheqje, transformon mënyrën se si ne luftojmë korrupsionin dhe avancojmë drejtë mirëqeverisjes.

IAFP-ja i gërsheton të gjitha këto koncepte së bashku duke vënë theksin tek komunikimi dhe bashkëpunimi mes rajoneve dhe kulturave të ndryshme dhe duke i dhënë rëndësi gjithashtu edhe udhëheqjes. Programi, i krijuar për të fuqizuar gjeneratat e ardhshme, ka certifikuar më shumë se 600 profesionistë të auditimit në historinë e tij 40-vjeçare dhe ka krijuar një rrjet kolegësh me një mirëkuptim kolektiv në lidhje me fuqinë e komunikimit, bashkëpunimit dhe udhëheqjes. Por më kryesorja, ka krijuar një rrjet njerëzish që janë të ndërgjegjshëm për fuqinë që mbart shfrytëzimi i këtyre aftësive drejt qëllimit për të realizuar ndryshimin.

Ndryshimi nuk është i lehtë, veçanërisht në përballje me e korrupsionin dhe përgjegjshmërinë e kufizuar. Përmes CAE, ne përdorim njohuritë dhe përvojën e ish-profesionistëve të nivelit të lartë të GAOs dhe partneritetin me organizata të njohura botërore për të siguruar trajnim dhe mbështetje teknike me qëllim përmirësimin e performancës dhe transparencës dhe për të siguruar përdorimin e shëndoshë të fondeve publike. Kohët e fundit kemi nënshkruar një marrëveshje me Bankën Botërore që forcon partneritetin tonë ekzistues dhe zgjeron mbështetjen e zhvillimit të kapaciteteve.

Përpjekjet bashkëpunuese të SPEL përfshijnë menaxhimin e pjesëmarrjes së GAO-s në INTOSAI, e cila ka disa grupe pune, (Lufta kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave, Vlera dhe Përfitimet e SAI-ve dhe Big Data) që promovojnë integritet, të dhëna të hapura dhe nisma transparence. GAO gjithashtu ka realizuar në Bashkëpunimin INTOSAI-Donator (IDC), një partneritet global strategjik midis INTOSAI-t dhe 23 partnerëve të zhvillimit. IDC ka mbështetur shtimin e kapaciteteve të SAI-ve, që ka rezultuar në suksese që kanë prekur rajone mjaft të largëta, të cilat kanë ndikuar pozitivisht tek SAI-t në të gjithë globin, veçanërisht në rajonet e Afrikës dhe Paqësorit.

Përveç partneriteteve ekzistuese, krijimi i partneriteve të reja është gjithashtu pjesë e axhendës. Grupe si Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe Aleanca e Audituesve sigurojnë forume unike globale që inkurajojnë bashkëpunimin dhe lehtësojnë shkëmb-imin e informacionit për tema me interes botëror. Në mars, unë ndoqa takimin e Aleancës së Audituesve, takim i cili këtë herë iu dedikua temës "Audituesit dhe Teknologjia" dhe u karakterizua nga diskutime të pasura lidhur me tendencat dixhitale që ndikojnë në punën e auditimit, duke i vënë theks të veçantë mënyrës se si institucionet e auditimit ndërmarrin hapa për të parandaluar korrupsionin dhe shpërdorimin e burimeve.

Përparimet teknologjike në inteligjencën artificiale, automatizimi dhe analizimi i të dhënave provokuan shkëmbime stimuluese në mënyrën e përdorimit të këtyre mjeteve, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe forcimin e auditimeve;

megjithatë, modernizimi nuk eliminon nevojën e audituesve. Në disa raste, modernizimi do të përfshijë më shumë bashkëpunim dhe ndërveprime njerëzore. Përdorimi i platformave të komunikimit është i rëndësishëm për të shpërndarë më gjerësisht gjetjet e auditimit me qëllim rritjen e transparencës dhe interpretimin njerëzor për rezultatet e të dhënave për të ndihmuar në zbulimin e shkaqeve thelbësore që çojnë në korrupsion. Qëllimi është integrimi, jo zëvendësimi. Përfshirja e teknologjive dhe qasjeve të reja do të na detyrojnë të rishikojmë strategjitë tona, të ndërtojmë sisteme të të dhënave dhe të gjejmë mënyra për një punë më bashkëpunuese.

Evolucioni dixhital sjell mundësi të bollshme, si dhe sfida të konsiderueshme. Ky evolucion, së bashku me klimën globale, do të kërkojë përshtatje të konsiderueshme-individuale, organizative, kombëtare dhe globale - e cila, nga ana tjetër, do të kërkojë forca të konsiderueshme në komunikim, bashkëpunim dhe zhvillimin e kapaciteteve, me dëshirën për të bërë më tepër përparim drejt mirëqeverisjes dhe trajtimit me sukses të "kancerit të korrupsionit".

Përktheu: Reinis Xhelili

Specialist, Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga: James-Christian Blockwood, Drejtor i Zyrës së Planifikimit Strategjik dhe Drejtor i Revistës INTOSAI Journal

KUADRI NDËRKOMBËTAR I ANGAZHIMEVE TË SIGURISË, NJË GARANCI MË SHUMË PËR SHËRBIME PROFESIONALE CILËSORE

Një angazhim i sigurisë përfshin pesë elementë: një marrëdhënie tre palëshe; një çështje në fjalë (çështje që i nënshtrohet verifikimit apo shqyrtimit); kriterin apo kriteret ku do të bazohet matja apo vlerësimi i një çështje në fjalë; evidencën ku bazohet konkluzioni i profesionistit; dhe raportin e sigurisë.

Nga: Prof.Dr. Hysen Çela |CA,CPA
President, IEKA
Partner Crowe AL shpk
Anëtar i Crowe Global
Tirana, Albania
Anëtar i IESBA and IASB CAG,
IFAC, NYC.

Hyrje

Federata Ndërkombëtare e Kontabilisteve (IFAC) përfaqëson sot organizmin global më të madh profesional në fushën kontabël. Roli i saj ka pësuar evoluim të vazhdueshëm veçanërisht në dekadën e katërt dhe të peste të ekzistencës.

Padyshim, njeri nga rolet e këtij organizmi, përveç rregullimit të profesionit kontabël në mbare botën, është edhe trajtimi i aspekteve teknike të standardeve profesionale, duke i parë ato si një shtyllë e pazëvendësueshme në garantimin e cilësisë së shërbimeve profesionale. Për ketë qëllim, pranë IFAC-ut janë ngritur dhe funksionojnë disa Borde të pavarura, të cilat kanë si objekt të punës së tyre hartimin dhe përditësimin për një gamë të gjerë të standardeve profesionale, teknike dhe të edukimit, ku mund të përmendim: Standardet Ndërkombëtare të Menaxhimit të Cilësisë (SNM); Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve për të Rishikuar (SNAR); Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Sigurisë (SNAS), Standardet Ndërkombëtare të Edukimit (SNE); Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik; Standardet Ndërkombëtare të Etikes (kodin IESBA), etj. Shumëllojshmëria e standardeve dhe sidomos, një proces i duhur e transparent i hartimit të tyre, kanë bërë që standardet e IFAC-ut të përdoren gjerësisht edhe nga shumë organizma ndërkombëtare, përfshirë këtu qeveritë dhe organet supreme të auditimit, Bursat, etj, pra nga shumë juridiksione.

Në këtë shkrim do të përpiqemi të trajtojmë rolin që luan dhe rëndësinë qe ka një kuadër bazë për profesionistët

(kontabilistë, auditues të sektorit privat publik dhe të tjerë) për kryerjen e shërbimeve cilësore të dhënies se sigurisë.

1. Kuadri i angazhimeve të sigurisë - objekti

Kuadri i angazhimeve të sigurisë i hartuar nga IAASB[1] nuk është një Standard specifik, dhe për rrjedhojë, nuk përcakton ndonjë kërkesë (ose parime bazë apo procedura) lidhur me kryerjen e auditimeve, rishikimeve, apo angazhimeve të tjera të sigurisë[2]. Kjo është arsyeja pse një raport i sigurisë, nuk mund te pretendojë se një angazhim ka qenë kryer në pajtim me këtë kuadër, por duhet t`ju referohet standardeve përkatëse të sigurisë, të cilat zbatohen në auditimet, rishikimet dhe angazhimet e tjera të sigurisë. Këto të fundit, janë hartuar bazuar në kuadrin e angazhimeve të sigurisë dhe përmbajnë objektivat, kërkesat, materialin zbatues dhe shpjegimet përkatëse.

Por, edhe pse nuk është një standard i veçantë, kuadri i angazhimeve të sigurisë shërben si referencë bazë: për *profesionistet e fushës kontabël* kur ata kryejnë shërbime profesionale të dhënies së sigurisë; përdoret nga *individët e tjerë që marrin pjesë në kryerjen e angazhimeve të sigurisë*, përfshirë përdoruesit e synuar të një raporti sigurie dhe palët qe angazhojnë një profesionist kontabël; dhe padyshim, përdoret nga *Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të Dhënies së Sigurisë* (IAASB) për zhvillimin e Standardeve të Sigurisë, dhe dokumenteve praktike dhe dokumenteve të tjera.

Objekti i kuadrit janë angazhimet e dhënies së sigurisë dhe roli i profesionistit kontabël në kryerjen e këtyre angazhimeve. Një angazhim i sigurisë përfshin pesë elementë: një *marrëdhënie tre palëshe; një çështje në fjalë (çështje që i nënshtrohet verifikimit apo shqyrtimit); kriterin apo kriteret ku do të bazohet matja apo vlerësimi i një çështje në fjalë; evidencën ku bazohet konkluzioni i profesionistit; dhe raportin e sigurisë*. Të pesë këto elementë në kuadër janë trajtuar të lidhur ngushtë me dy llojet kryesore të angazhimeve për dhënien e sigurisë, të cilat janë respektivisht: angazhimet e sigurisë së arsyeshme dhe angazhimet e sigurisë së kufizuar.

2. Parimet Etike dhe standardet e menaxhimit te cilësisë

Kryerja e shërbimeve cilësore të sigurisë, dhe për rrjedhojë, të vepruarit me interes publik, e bën të domosdoshme që profesionistët kontabël, anëtarë ose të angazhuar nga firmat profesionale që kryejnë angazhime të sigurisë (përfshirë auditimet), të jenë në pajtim të plotë me kërkesat e standardeve të menaxhimit të cilësisë dhe të respektojnë parimet etike, përfshirë kërkesat për pavarësinë. Profesionistët kontabël që angazhohen në

[1] *IAASB – International Auditing and Assurance Standard Board*

[2] *Sikurse përcaktohet në Manualin e Deklaratave Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë, Auditimit, Rishikimit, Sigurive të Tjera dhe Shërbimeve të Lidhura, në këto shërbime përfshihen angazhimet e sigurisë së kufizuar dhe ato të sigurisë së arsyeshme.*

kryerjen e shërbimeve të dhënies së sigurisë, kanë detyrimin të jenë në pajtueshmëri të plotë me parimet etike të Kodit IESBA të IFAC-ut, të cilat janë:

- Integriteti;
- Objektiviteti;
- Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur;
- Konfidencialiteti; dhe
- Sjellja profesionale

Respektimi i këtyre parimeve themelore etike bëhet i mundur përmes zbatimit të një kuadri konceptual etik bazë, i cili ndihmon që profesionistët kontabël të identifikojnë kërcënimet që ju bëhen parimeve themelore etike, të vlerësojnë nivelin e kërcënimeve dhe, kur është nevoja, të zbatojnë masat mbrojtëse, për të eliminuar kërcënimet ose zvogëluar ato deri në një nivel të ulët të pranueshëm.

Një indikator i rëndësishëm i të vepruarit në mënyrë etike është pavarësia, e cila shihet në të dy aspektet e saj: *pavarësia në të menduar* dhe *pavarësia ne dukje*. Pavarësia garanton aftësinë për të formuar një konkluzion të sigurisë, duke mos qenë i ndikuar nga influencat që mund të kompromotojnë konkluzionin. Pavarësia përmirëson aftësinë për të vepruar me integritet, për të qenë objektiv dhe për të mbajtur një qëndrim profesional skeptik.

Vendosja e theksit tek zbatimi i standardeve të menaxhimit të cilësisë nënkupton që një firmë profesionale, vendos në zbatim një sistem të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm të cilësisë për angazhimet e sigurisë. Pajtueshmëria me standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë kërkon, midis të tjerash, që firma të vendosë dhe të mbajë një sistem të kontrollit të cilësisë që përfshin politikat dhe procedurat, të cilat adresojnë çdonjërën nga çështjet e mëposhtme:

- Përgjegjësitë e lidershipit për cilësinë e punës brenda firmës;
- Kërkesat përkatëse etike;
- Pranimin dhe vazhdimin e marrëdhënieve me klientin dhe të angazhimeve specifike;
- Burimet njerëzore;
- Performancën e angazhimit; dhe
- Monitorimin.

Të gjitha këto aspekte duhet të komunikohen për të gjithë anëtarët e grupit, që marrin pjesë në angazhim dhe gjithashtu duhet të dokumentohen si pjesë e procedurave të dokumentimit të shërbimeve të sigurisë.

3. Angazhimet e sigurisë – një përshkrim i shkurtër

Një angazhim i sigurisë është një angazhim, në të cilin një profesionist kontabël (në praktikën publike) kryen një seri procedurash për të grumbulluar evidencën e nevojshme me qëllim që të shprehë një konkluzion, i cili synon të përmirësojë shkallën e besimit të përdoruesve të synuar, për rezultatin e vlerësimit ose të matjes së një çështje në fjalë përkundrejt një ose disa kritereve të caktuara.

Sipas kuadrit të angazhimeve të sigurisë, rezultati i matjes ose i vlerësimit të një çështje në fjalë është informacioni që rezulton nga zbatimi i kriterit/kritereve

kundrejt kësaj çështje (në shqyrtim). Për shembull:

- Pasqyrat financiare (rezultati) janë rrjedhoje e matjes së pozicionit financiar, performancës financiare dhe flukseve të parasë (çështja në fjale në shqyrtim) duke u bazuar në kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, siç mund të jenë SKK ose SNRF-të. (kriteret)
- Një pohim për efektivitetin e kontrollit të brendshëm (rezultati) rrjedh nga vlerësimi i efektivitetit të procesit të kontrollit të brendshëm të entitetit (çështja në fjalë) duke zbatuar kriteret përkatëse. (kriteret)
- Një deklaratë në lidhje me pajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat (rezultati), rrjedh nga vlerësimi i pajtueshmërisë së një entiteti (çështja në fjalë) me, për shembull ligjin dhe rregullin (kriteri).

Rezultati i matjes ose vlerësimit të një çështje kundrejt kriterit në këtë kuadër është shprehur me formulimin *informacioni për çështjen në fjalë*. Pikërisht për këtë informacion ose këto informacione profesionisti grumbullon evidencën e nevojshme, e cila shërben si bazë për të formuluar dhe raportuar konkluzionin e tij.

Angazhimet për dhënien e sigurisë kategorizohen në: (a) angazhimet për të provuar informacionet dhe (b) angazhimet direkte, në të cilat profesionisti mat ose vlerëson çështjen në fjalë kundrejt kritereve.

Në rastin e një angazhimi për të provuar, nuk është profesionisti, por një palë e ndryshme, e cila mat ose vlerëson çështjen në fjalë kundrejt kriterit. Kjo palë e tretë shpesh herë paraqet edhe informacionet që lidhen me çështjen në fjalë në formën e një raporti ose deklarate. Konkluzioni i profesionistit të praktikës, adreson faktin nëse informacioni për çështjen në fjalë përmban ose jo anomali materiale.

Në rastin e një angazhimi direkt ose të drejtpërdrejtë është profesionisti i praktikës ai që mat ose vlerëson çështjen në fjalë kundrejt kriterit. Ky i fundit përdor zotësitë dhe teknikat për sigurinë për të grumbulluar evidencën e nevojshme rreth rezultatit të matjes ose vlerësimit të çështjes në fjalë kundrejt kriterit/kritereve. Në një angazhim direkt, konkluzionet e profesionistit të praktikës, adresojnë rezultatin e raportuar të matjes ose të vlerësimit të çështjes në fjalë kundrejt kriterit.

Angazhimet e Sigurisë, siç e përmendëm edhe më sipër, kategorizohen në angazhime të sigurisë se arsyeshme dhe angazhimet e sigurisë së kufizuar.

Në një angazhim të sigurisë së arsyeshme, profesionisti i praktikës zvogëlon rrezikun e kryerjes së angazhimit në një nivel të pranueshëm të ulët për rrethanat e angazhimit, si bazë për konkluzionin e tij. Konkluzioni i profesionistit të praktikës në një angazhim të tille shprehet në një formë që tregon opinionin e tij mbi rezultatin e matjes ose vlerësimit të çështjes në fjalë kundrejt kriterit.

Ndërsa në një angazhim të sigurisë së kufizuar profesionisti i praktikës zvogëlon rrezikun e angazhimit në një nivel të pranueshëm për rrethanat e angazhimit, por ky rrezik është më i lartë se ne rastin e një angazhimi të sigurisë së arsyeshme, si bazë për shprehjen e konkluzionit në një forme që tregon nëse, bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e siguruar, vëmendjen e profesionistit e ka tërhequr ndonjë çështje, e cila e bën atë të besojë se informacioni mbi çështjen në fjalë ka anomali materiale.

Natyra, afatet dhe shtrirja e procedurave që duhen kryer, ndryshojnë sipas të dy llojeve të angazhimeve. Ato janë më të kufizuara në një angazhim të sigurisë së kufizuar dhe janë më shumë të zgjeruara në rastin e një angazhimi të sigurisë së arsyeshme.

Megjithatë, në të dyja këto raste, profesionisti i praktikës duhet të hartojë planin për të marrë nivelet e kërkuara të sigurisë, të cilat sipas gjykimit të tij janë të pranueshme dhe ka të ngjarë të përmirësojnë besimin e përdoruesve të synuar rreth informacioneve për çështjen në fjalë.

4. Raportimi për angazhimet e sigurisë

Pas përfundimit të procedurave të angazhimit, dhe pas vlerësimit që një profesionist bën në lidhje me faktin nëse është siguruar evidenca e nevojshme, hapi i fundit është formimi i konkluzionit, i cili përfshihet në raportin e sigurisë dhe shpreh qëndrimin e profesionistit në lidhje me informacionin për çështjen në fjalë.

Në një angazhim të sigurisë së arsyeshme, konkluzioni i profesionistit shprehet në *forme pozitive*. Këtu profesionisti jep opinion mbi rezultatin e matjes ose të vlerësimit të çështjes në fjalë. Shembull i një konkluzioni për një angazhim të sigurisë së arsyeshme do të ishte rasti kur një profesionist shprehet në termat e çështjes në fjalë dhe kritereve të zbatueshme me formulimin *"Sipas opinionit tonë, entiteti ka qenë në pajtim në të gjitha aspektet materiale, me ligjin XYZ".*

Po kështu, edhe në një auditim, si një angazhim i sigurisë së arsyeshme, konkluzioni do të shprehej në termat e informacioneve të çështjes në fjalë dhe kritereve te zbatueshme me formulimin *"Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të entitetit me datën dhe performancën financiare e flukset e parëse për vitin që mbyllet në pajtim me Kuadrin XYZ*".

Një formulim i ngjashëm përdoret edhe në rastet kur profesionisti shprehet lidhur me informacionet e tjera që një palë e tretë mund t'i përfshijë në një deklaratë me shkrim.

Në një angazhim të sigurisë së kufizuar, konkluzioni i profesionistit të praktikës jepet në një formë kryesisht *negative*, e cila tregon nëse, bazuar në angazhimin e kryer vëmendjen e profesionistit e ka tërhequr ose jo ndonjë çështje që e bën atë të besojë se informacioni për çështjes në fjalë ka anomali materiale. Një konkluzion në këtë formë paraqitet me formulimin: *"Bazuar në procedurat e kryera dhe*

evidencën e siguruar, asgjë nuk na ka tërhequr vëmendjen që ne të besojmë se entiteti nuk ka qenë në pajtim, në të gjitha aspektet materiale, me ligjin XYZ".

Për të pasur një komunikim sa më efektiv me përdoruesit e synuar, profesionisti mund të zgjedhë të shprehë konkluzionet e tij në *forme të shkurtër* ose në *formë të gjatë*.

Raportet në formën e shkurtër, zakonisht përfshijnë vetëm elementët bazë, ndërsa raportet në formën e gjatë, përfshijnë edhe informacione të tjera dhe shpjegime që nuk synojnë të ndikojnë konkluzionin e profesionistit. Raportet në formën e gjatë, mund të përshkruajnë me detaje kushtet e angazhimit, kriteret e përdorura, gjetjet në lidhje me aspektet e veçanta të angazhimit, detajet e kualifikimeve dhe eksperiencat e profesionistit dhe të tjerëve të përfshirë në angazhim, shpjegimin e niveleve të materialitetit, dhe në disa raste edhe rekomandimet.

Konkluzionet në një raport të sigurisë mund të jenë *pa modifikuara* (pa rezervë), ose *të modifikuara* (me rezervë, kundër, apo refuzim).

Një konkluzion i modifikuar do të jepet në çdo rast kur, sipas gjykimit të profesionistit, ka një kufizim në objekt dhe efekti i kufizimit mund të jetë material. Në varësi të materialitetit dhe shkallës së përhapjes së kufizimit të objektit, profesionisti i praktikës shpreh një konkluzion me rezervë ose një mosdhënie konkluzioni. Nuk përjashtohet as mundësia e dorëheqjes (tërheqjes nga angazhimi).

Gjithashtu, kur, sipas gjykimit të profesionistit, informacioni për çështjen në fjalë ka anomali materiale, në raportin e sigurisë do të përfshihet një konkluzion me rezervë ose një konkluzion kundër. Në ato angazhime direkte, ku informacioni për çështjen në fjalë, është konkluzioni i profesionistit dhe ky i fundit arrin në përfundimin se disa ose të gjitha çështjet në fjalë, në të gjitha aspektet materiale, nuk janë në pajtim me kriteret, një konkluzion i tillë do të konsiderohej me rezervë (ose sipas rastit, kundër).

Një konkluzion me rezervë shprehet kur efektet, ose efektet e mundshme nuk janë kaq materiale dhe të përhapura, sa të kërkojnë një konkluzion kundër ose një mosdhënie të konkluzionit.

Kuadri i angazhimeve të sigurisë analizon një mori rrethanash, që lidhen si me kushtet e angazhimit, me ndryshimin e tyre, përshtatshmërinë e çështjeve në shqyrtim (në fjalë), informacionet për çështjen dhe kriteret, duke orientuar për rrugë-zgjidhjet përkatëse dhe duke treguar formën e përshtatshme të konkluzionit.

Konkluzion

Kuadri i angazhimeve të sigurisë, përfaqëson një dokument bazë për kryerjen e një shumëllojshmërie të shërbimeve të sigurisë në kohën e duhur për qëllimin e duhur dhe me cilësinë e kërkuar. Ai behet mjaft i dobishëm, sot kur kompleksiteti i biznesit po rritet, kur vlerësimit i performancës së entiteteve po varet veç të tjerash jo thjesht nga cilësia e inputeve të prodhimit e teknologjia, por edhe nga ndërveprimet efektive midis faktorëve ekonomikë, mjedisorë e socialë. Kështu që i ndërtuar në këtë mënyrë, ky kuadër paraqet një bazë të pazëvendësueshme për të gjithë profesionistët për të orientuar punën e tyre, respektuar standardet etike, teknike e profesionale dhe kontribuar në shtimin e besimit dhe të vlerës për palët e ndryshme të interesuara. Një shërbim profesional cilësor është themeli i reputacionit, personal, profesional e institucional.

Literatura

https://www.icaew.com/technical/audit-and-assurance

https:// IAASB handbook-volume-1.pdf

IAASB Handbook volume 3, 2018

IESBA Code of ethics, 2018

Kodi i Etikës i IEKAs

Framework for audit quality, IAASB

Nga: Prof.Dr. Hysen Çela |CA,CPA
President, IEKA

UJËRAT E BRENDSHME DETARE – KOHA PËR AUDITIM

(Zonat e mbrojtura detare në fokusin e auditimit)

Natyra për të kompensuar ndotjen shqiptare bën që të zhvillohen edhe më shumë livadhet me posedonia (posedonia oceanica), që ndryshe quhen pyje të detit. Natyra i zhvillon ato, në mënyrë që të arrij të pastroj ndotjen njerëzore në det.

Nga: Prof. Ing. Av. Sazan Guri,

"G&G"Group

Ing. Alush Zaçe, KLSH

Përmbledhje

Në pjesën më të madhe të sistemeve ujore (lumenj e laguna) pranë bregdetit, zhvillohen algat jeshile, në mënyrë që të bëjnë "ngrënien" e lëndës organike (nitritet, fosfatet, nitratet) të hedhura nga njeriu. Por, jo vetëm kaq, kjo ndotje ka arritur të pushtojë prej vitesh edhe bregdetin shqiptar, ku në çdo ditë flaken 300 mijë tonë (ose m^3) ujëra të përdorura (waste water) dhe po në harkun kohor të 25 vjetëve, janë flakur rreth 3000 tonë mbetje bashkiake në ditë. Ndaj, po të vihet re, 30% e bregdetit shqiptar, e përbërë nga pyjet livadhorë me posedonia oceanica (që ndryshe në shqip i thonë leshterikët e detit), vdesin dhe dalin në bregdet, duke u kthyer edhe këto në mbetje dhe në një problem edhe më të madh për vetë shqiptarët, turistët, politikanët e këdo.

Fjalë Kyçe - *lëndë organike, nitritet, fosfatet, nitratet, pyjet livadhorë, posedonia oceanica, leshterikët e detit, auditim*

Hyrje

Natyra për të kompensuar ndotjen shqiptare bën që të zhvillohen edhe më shumë livadhet me posedonia (posedonia oceanica), që ndryshe quhen pyje të detit. Natyra i zhvillon ato, në mënyrë që të arrij të pastroj ndotjen njerëzore në det. Por, njerëzia dhe politika shqiptare, me ndjesitë jo dashamirëse me mjedisin, e sulmojnë për të disatën herë bregdetin shqiptar, duke hedhur në të veç ujrave të zeza, edhe mbetje inerte si asfalte, hekura, betone, bitume, pesticide, etj. Dhe ç'ndodh? Natyra, bazuar në ligjet e brendshme të saj, arrin ta përballojë dhe mund ta mundë një shkaktar, por kur ata (shkaktarët), bëhen më shumë se një, si edhe ujëra të zeza, edhe ujëra urbane, edhe mbetje industriale, edhe mbetje të rrezikshme, edhe mbetje spitalore, edhe mbetje shkëmbore apo dhèra, sedimente, etj., ajo veçse dorëzohet. Ndaj, pyjet livadhorë

vdesin dhe dalin në bregdet, duke u kthyer edhe këto në mbetje dhe në një problem edhe më të madh.

Fig.–1 *Pamje e tufës së peshqve në kërkim të gjetjes së ujit të pastër.*



I. Marrëdhëniet historike të shqiptarëve me detin

1.1 Marrëdhënia e shqiptarëve me detin

Marrëdhënia e shqiptarëve me detin ka qenë e kufizuar, sepse historikisht prej detit, atij i kanë ardhur pushtimet, që kur ishte Pellazgji, 8400 vjet para Krishtit, kur afrikano-veriorët, gjatë çshkretëtirëzimit të Saharasë, kërkonin të dyndeshin në veri të tyre përmes Mesdheut. Por, edhe kur ishte Iliri, ku si për grekët që formuan koloni, edhe për romakët që vinin me ushtri, ishte deti ai që i sillte ata si kolonizatorë dhe pushtues. Po ky det në shekujt pas Krishtit solli Hunët, Visigotët, që shkretuan përfundimisht Ilirinë dhe më vonë (në fillim të mijëvjeçarit te kaluar) kryqëzatat dhe vikingët, që e kthyen Arbërinë në shesh betejash. Mjaftuan këto reprezalje që për popullin shqiptar të humbte lidhja me detin, aq sa kur hanin peshk thoshin se u detyruan ta bënin se nuk kishin mishin pranë.

Fig.– 2 Pamje e leshterikëve të detit ose livadheve me posedonia apo leshterikë, pa të cilën nuk ka kuptim jeta detare.

Ndaj edhe një pjesë e popullit, megjithëse afër bregdetit, ushqeheshin me trupa mishtorë të gjësë së gjallë të tokës dhe jo të detit. Më pas Shqipërisë i erdhi e keqja nga malet dhe grykat e lumenjve (pushtimet serbe dhe osmane).

Ndërsa sot, e keqja i vjen nga grykësia e shqiptarëve në përgjithësi, e veçanërisht e politikë-bërësve. Këta të fundit, në hakmarrje të asaj çfarë iu bënë malet dhe grykat e lumenjve, fillimisht i zaptuan, keq-shfrytëzuan, i goditën deri sa në fund i nënshtruan, duke i ngopur me plehra, mbetje industriale, ujëra të zeza, mbetje spitalore, ujëra urbane etj.

Historikisht, shqiptarët kanë derdhur ujëra të zeza e të përdorura në lumenjtë e pastaj në det, por asnjëherë në përmasat dhe shkallën e ndikimeve të sotme, për shkak se dikur ka qenë numër i kufizuar i popullsisë dhe i industrisë. Ndërsa sot janë tre milion banorë, tre milion turistë dhe 110 mijë biznese që pasi e përdorin ujin, e flakin të papërpunuar në rrëketë përkatëse për të shkuar më tej drejt lumenjve dhe për të përfunduar në det. Madje në sasi 200 fish më shumë se ajo historike.

Fig.– 3 *Harta e Shqipërisë me zonat përkatëse me posedonia oqeanika ose pyjet e detit aq të domosdoshme për jetën detare.*



Kjo pavetëdije njerëzore e 25 viteve të fundit, ka bërë që ujërat tanë të kthehen nga ujëra të pastër dhe të pasur me shumëllojshmëri gjallesash, me ujëra mezotrofik dhe eutrofik që ndryshe do të thotë, nga ujëra ku jetonin peshqit, në ujëra ku natyra zhvillon gjallesa si bretkosa, gaforre etj., për të pastruar ndotjet njerëzore.

1.2 Algat jeshile

Ndaj në pjesën më të madhe të sistemeve ujore (lumenj e laguna) pranë bregdetit, zhvillohen algat jeshile, në mënyrë që të bëjnë “ngrënien” e lëndës organike (nitritet, fosfatet, nitratet) të hedhura nga njeriu. Por, jo vetëm kaq. Kjo ndotje ka arritur të pushtojë prej vitesh edhe bregdetin shqiptar, ku në çdo ditë flaken 300 mijë tonë (ose m3) ujëra të përdorura (waste water) dhe po në harkun kohor të 25 vjetëve, janë flakur 3000 tonë mbetje bashkiake në ditë.[1]

Nëna natyrë, për të kompensuar ndotjen shqiptare, apo hakmarrjen e shqiptarëve ndaj maleve, grykave të lumenjve dhe deteve, bëri që të zhvilloheshin edhe më shumë livadhet me posedonia (posedonia oceanica), që ndryshe quhen pyje të detit. Natyra i zhvilloi ato, në mënyrë që të arrinte të pastronte ndotjen njerëzore në det. Por, shqiptarët e pavetëdijshëm, por

[1] ***Roli ekologjik i livadheve -*** *Në mënyrë të përmbledhur roli ekologjik i livadheve lidhet me sa më poshtë:*

1. ***Kanë prodhimtari mjaft të lartë****: 500-1300 gr/m2/vit në thellësi 1m, 150-300 gr/m2/vit në thellësi 20m. Kjo prodhimtari është e krahasueshme me atë të një pylli dushku. Rreth 30% e prodhimtarisë primare të livadheve mbetet në trajtën e gjetheve të vdekura në zonat më të thella.*

2. ***Grumbullojnë vlera të biodiversitetit detar****: livadhet e posidonias janë rezervuar i biodiversitetit; ato strehojnë rreth 20-25% të llojeve të Mesdheut (400-500 lloje algash dhe mbi 1.000 lloje kafshësh); shumë nga këto jetojnë ekskluzivisht në livadhe.*

3. ***Janë prodhuese të oksigjenit****: në 1 m2 livadh, si rezultat i procesit të fotosintezës, prodhohen në vartësi të dendësisë, nga 4-20 litra oksigjen në ditë ose mesatarisht rreth 14 litra. Për këtë arsye ato janë quajtur dhe “mushkëritë e gjelbra” të Mesdheut.*

4. ***Janë vend strehimi dhe ushqimi****: livadhet krijojnë mikro-habitate që shërbejnë për strehim e mbrojtje, për ushqim dhe për riprodhim për një numër të madh organizmash detare. Ndër to ka grupe organizmash me rëndësi të madhe ekonomike si peshq, cefalopodë dhe krustace.*

5. ***Luajnë rol të rëndësishëm në ekuilibrin e sedimenteve****: zhvillimi i një sistemi rrënjor dhe kërcellor të fuqishëm ndikon në stabilitetin e tabanit të detit. Masa gjethore e livadheve me Posidonia zvogëlon intensitetin e dallgëve dhe ndikon në rritjen e sedimenteve. Në këtë aspekt livadhet me Posidonia përbëjnë një brez mbrojtës për ruajtjen e brigjeve nga veprimi eroziv i dallgëve. Ato e ulin forcën e valëve detare deri në 30%. Njohuritë e deritanishme për llojin Posidonia oceanica në Shqipëri kanë qenë mjaft të pakta, duke theksuar se mungonte informacioni mbi shpërndarjen e llojit përgjatë bregut.*

sidomos pushtetarët dhe politikanët e babëzitur, e sulmuan për të dytën herë bregdetin shqiptar, duke hedhur në të mbetje inerte si asfalte, hekura, betone, bitume, pesticide, etj.

Fig. – 4 Pamje e barit në det

Dhe ç'ndodh? Natyra, bazuar në ligjet e brendshme të saj, arrin ta përballojë dhe mund ta mundë një shkaktar, por kur ata (shkaktarët), bëhen më shumë se një si edhe ujëra të zeza, edhe ujëra urbane, edhe mbetje industriale, edhe mbetje të rrezikshme, edhe mbetje spitalore, edhe mbetje shkëmbore apo dhëra, sedimente etj., ajo veçse dorëzohet. Ndaj, po të vihet re, 30% e bregdetit shqiptar (Fig. - 1), e përbërë nga pyjet livadhorë me posedonia oceanica (që ndryshe në shqip i thonë leshterikët e detit) vdesin dhe dalin në bregdet, duke u kthyer edhe këto në mbetje dhe në një problem edhe më të madh për vetë shqiptarët, turistët, politikanët.

Fig. – 5 Vlerësimi i aspekteve mjedisorë

2. Ç'janë dhe ç'bëjnë leshterikët e detit?

2.1 Zonat e mbrojtura me leshterikët e detit

Në zonën bregdetare shqiptare, në shelfin e brendshëm 0-30 m thellësi me distancë 0-5 km nga bregdeti, zënë vend 5-6 zona të mëdha, të mbrojtura, me pyje detare dhe kombinimi i natyrës është perfekt dhe për këtë shqiptarët janë me shumë fat.[2] Dhe

[2] **Njesia 1 (gjiri i Vlorës përfshire lagunën e Orikumit)**: Gjiri i Vlorës shtrihet nga qyteti i Vlorës (lindje) deri në kepin e Gallovecit (perëndim). Bregdeti është kryesisht shkëmbor, me plazhe të vogla me gurë, përveç zonës lindore që është ranor, dhe zonës qendrore te gjirit qe është e mbushur me rërë dhe baltë. Zonat me ujë të ceket janë të mbushura me livadhe të posidonias, të cilat janë shumë të rëndësishme ekologjikisht. BSAP propozon që laguna e Orikumit të shpallet zonë e mbrojtur. Peshkimi është një aktivitet i rëndësishëm në gji.
Njesia 2 (Ishulli i Sazanit): Kjo njësi është studiuar më pak, sepse shpesh për qëllime strategjike përjashtohet nga shkallët studimore.

Njesia 3 (gadishulli i Karaburunit): Zona shtrihet nga Kepi i Gallovecit deri tek Kepi i Gjuhëzës në brigjet veriore dhe perëndimore, dhe në gjirin e Bristanit në drejtimin veri-veriperëndim dhe jug-juglindje. Shpatet janë shumë të pjerrëta, karakterizohen nga shkëmbinj të lartë *vertikalë që zhyten në det në thellësi te mëdha. Mjedisi bregdetar nënujor është i shumëllojshëm. Zona është shumë e rëndësishme ekologjikisht me parkun Kombëtar të Llogorasë dhe Rezervën e Menaxhuar Natyrore Karaburun – Rrëza e Kanalit (shih Fig. -1). Peshkimi është një aktivitet i rëndësishëm ekonomik.*
***Njësia 4 (zona e Rrëzes se Kanalit)**: Njësia shtrihet nga gjiri i Bristanit deri në Dhërmi. Ajo ka peizazhe mbresëlënëse, me kanione që bien në det. Tabani i*

shiko se sa e mëncur është mëma natyrë. Atje, ku ka laguna pranë bregdetit, nuk ka posedonia dhe atje ku mungon laguna, zhvillohen pyjet me posedonia, si në rastet e Kepit të Rodonit, Gjirit të Lalëzit, Karpen – Currilave, ishullit të Sazanit, Gjirit të Vlorës, Gadishullit të Karaburunit, Dhërmi – Porto Palermos, Qeparo – Kepit të Qefalit deri në Kepi i Qefalit – Kepi i Stillos. Këta leshterikë prodhojnë një biomasë, apo një rritje të vetvetes, në 1 m thellësi 500-1300 m^2/vit, aq sa rritet lënda drusore në një pyll me lisa.

Ato strehojnë 20-25% të specieve detare (400 – 500 lloje algash dhe mbi 1000 lloje kafshësh). Ato prodhojnë 4 – 20 litra oksigjen në ditë, për 1m^2 livadh, si rezultat i procesit të fotosintezës, duke thithur dyoksidin e karbonit të çliruar nga mbetjet. Për këtë arsye quhen edhe mushkëritë e gjelbra të detit. Ato krijojnë ushqim dhe strehë, duke mbrojtur dhe zhvilluar mikro-habitatet, duke bërë të mundur riprodhimin dhe rritjen e peshqve, cefalopodëve, etj. Mbi të gjitha luajnë një rol perfekt në balancën e sedimentit, duke thithur lëndët, grimcat në suspencë të ujit, pra saktësisht bëjnë atë që bëjnë pemët në tokë.[3]

Pikërisht nisur nga dobitë e mësipërme, quhet paudhësi e pushtetarëve lokalë dhe aktivitetit të bizneseve, ku përpos të tjerave i mbysin këto qenie jetësore me sedimente të hedhura si në Vlorë, Sarandë,

detit tregon aktivitet aroziv përgjatë vijës bregdetare. Flora dhe fauna detare janë të ngjashme me ato të gjetura në gadishullin e Karaburunit. Në BSAP propozohet që kanioni i Gjipesë të behet zonë e mbrojtur (shih Hartën 4).

***Njesia 5 (Dhërmiu deri në Porto Palermo)**: Relievi bregdetar është me i butë. Livadhet me barishte deti dominojnë zonat me ujë të cekët. Mjedisi bregdetar është mjaft i shumëllojshëm Njësia është zona më prodhuese me peshk e gjithë bregdetit shqiptar. BSAP propozon Porto Palermon si zonë të mbrojtur.*

***Njësia 6 (Qeparoi deri tek kepi i Qefalit)**: Vija bregdetar karakterizohet nga suksesione të peizazheve të ndryshme. Në këtë njësi mbizotërojnë plazhet me rërë të bardhe, që shtrihen deri në 20 m thellësi dhe ku janë të zakonshme popullatat e Posidonia oceanica dhe Cymodocea spp. BSAP propozon dy zona që duhen mbrojtur: Përroi i Borshit dhe gjiri i Kakomesë (shih Fig-1.*

***Njësia 7 (Kepi i Qefalit deri tek kepi i Stillos)**: Profili bregdetar nuk është kaq spektakolar sa në njësitë e tjera, megjithëse ndahet në një sërë sektorësh specifikë. Parku Kombëtar i Butrintit është një zonë Ramsar. BSAP propozon zgjerimin e sipërfaqes së parkut që duhet mbrojtur, përfshirë dhe kepin e Stillos (shih Fig. – 1).*

*[3] Të gjitha këto specie bimore përbejnë një aset të madh kombëtar, me vlera ekonomike dhe shkencore. Disa prej tyre janë mjaft të rralla, disa kanë vlera shkencore, dhe shumica kane përdorime ekonomike si: mjekësore, aromatike, ushqimore dhe dekorative. Për shkak të karakteristikave gjeografike dhe të florës, bregdeti jugor përfaqëson habitate interesante për entomofaunen. Diversiteti i këtij grupi është shumë i madh krahasuar me madhësinë e zonës së studimit. Referuar fluturave të rendit Rhopalocera**,** në zonë janë vërejtur 93 specie, nga të cilat disa kanë rëndësi ndërkombëtare. Është vërejtur një numër i madh speciesh të rendit Coleoptera: 152 specie qe i përkasin 21 familjeve. Bregdeti jugor është i pasur në grupe verteratesh. Ne zonën e studimit ka rreth 252 specie peshqish, 11 specie amfibësh (nga 15 qe njihen në Shqipëri), 30 specie reptilësh (nga 37 specie), 250 specie zogjsh (nga 330 specie) dhe 55 specie gjitarësh (nga 71 specie). Plani i Menaxhimit të Integruar të Zonës Bregdetare (ICZMP) i 1995 ishte shumë i orientuar nga mbrojtja e biodiversitetit. Ai identifikoi 5 Zona të Ndjeshme Mjedisore (ESA): Gadishulli i Karaburunit; Kanioni i Vunoit; Porto Palermo; Plazh i Kakomesë; Butrinti.*

ESA-te u identifikuan sipas kritereve të mëposhtme: cilësia apo "natyraliteti" i mjediseve bregdetare detare e tokësore; bukuria natyrore; ekzistenca e rrënojave kulturore dhe arkeologjike; potenciali për qëllime argëtuese dhe edukative; ekzistenca e përdorimeve tradicionale; kompleksiteti i lartë i ekosistemeve; biodiversiteti i pasur; burime të rëndësishme natyrore për përdorim human; nevoja për një zhvillim të integruar dhe të saktë mjedisor.

Shëngjin, etj. Por më tipike është rasti i qytetit të Durrësit dhe më skandal është hedhja vetëtimthi nga punimet bashkiake e dhèrave, tubave të ujërave të zeza, inerteve, asfalteve pranë portit të qytetit të Durrësit.

Fig. – 6 Pamje e kultivimit të midhjeve në lagunën e Butrintit

2.2 Pse asfiksohet jeta e livadheve pyjorë në det?

Veç ujërave të zeza të 200,000 banorëve dhe 300,000 të tjerëve në kohë piku turistik, flaken edhe këto sedimente që bëjnë të asfiksohet jeta e livadheve pyjorë në det. Ndaj, nga Karpeni deri në Currila, apo edhe në Gjirin e Lalëzit, etj., turizmi shqiptar përballet vitet e fundit me një mbetje shtesë që kërkon investime marramendëse financiare për t'u zhvendosur, përpunuar dhe asgjësuar. Pra jemi në kohën, ku natyra po hakmerret, jo ndaj pakujdesive njerëzore, por ndaj paudhësive, ndaj shpërdorimeve të detyrës. Pra, po gjen vend proverbi popullor "Atë që hedh në det, e gjen në kripë".

Fig. – 7 Pamje e biodiversitetit detar në zonën jonike

3. Koha për auditime në zonat e brendshme detare

3.1 Auditimet e kryera për Detin Mesdhe

Ballafaquar me auditimet e kryera për Detin Mesdhe, kuptuam që ata kishin problem mungesën e zonave të mbrojtura detare dhe mundoheshin ti krijonin ato artificialisht (psh reef-et artificiale), pra ata në shumicën e rasteve nuk e kanë dhe e krijojnë, ndërsa ne e kemi dhe e shkatërrojmë. Tek ne nuk mjaftoi shkatërrimi i posedonias që mban 25% të jetës së gjallë në det dhe mban me oksigjen ujin e detit, por tek ne kërkohet që të ngrihen mbi 60 kompani në Gjirin e Vlorës për zhvillimin e Acquakulturës. Mbi 70 kompani veprojnë për rritjen e midhjeve në lagunën e Butrintit dhe kompani të tjera të mëdha për rritjen e peshkut, kërkojnë të zënë vend në Sarandë.[4] Në një kohë që ky

[4] ***Zonat e ndjeshme mjedisore*** *- Zona e bregdetit dallohet për diversitetin e habitateve të saj dhe pasurinë më specie të florës dhe faunës. Shumë prej tyre janë në mbrojtje në nivele ndërkombëtare, kombëtare dhe rajonale. Në të gjendet një gamë e gjerë habitatesh, siç janë: ekosistemet e maleve të larta (deri në 2,000m); kullotat alpine dhe sub-alpine; tipe të ndryshme pyjesh (përzierje e koniferëve me gjethegjerët, përzierje e gjethegjerëve ku dominojnë pemë që i rrezojnë gjethet, përzierje e gjethegjerëve ku dominojnë pemë gjithmonë të gjelbra, shkurre dhe makje, pyje aluviale); kullota të ulëta, habitate*

vend nuk ka kryer rifreskimin e matjeve, rrymave dhe sidomos të gjireve detare shqiptare, zhvillimi i këtyre aktiviteteve, e pastudiuar nga ana e institucioneve kompetente, do të sjellë një ndotje të akumuluar super gjigande për ujërat detare.

Fig. – 8 Si të auditojmë aspektet mjedisore

3.2 Koha për auditim

Ndaj si ekspertë audit të një institucioni ku 'shteti vjen era shtet', nisur edhe nga eksperienca e vendeve fqinjë në marrëdhënien me detin, kemi guximin të bëjmë thirrje, së pari vetvetes, së dyti qeverisë, së treti organeve të pushteteve lokale, së katërti kompanive të biznesit, të bashkëpunojnë me institucionin e auditimit shqiptar që nesër edhe vendi ynë të radhitet për marrëdhënie me detin, në nivelin e vendeve të tjera të Mesdheut.

Fig. – 9 Vlerat e auditimit mjedisor të orientuar

Ndotja aktuale detare nuk pret më, ajo thërret për auditim, sa bashkëpunues, po aq edhe të ashpër. Auditimi mjedisor është mjet menaxhimi për të përcaktuar përputhjen e aktiviteteve private me ligjet komplekse, me rregulloret mjedisore, si edhe me politikat, proçedurat apo udhëzimet në fuqi.

4. Përfundime dhe mendime për tu marrë parasysh

Auditimi mjedisor na bën të mundur të kemi:

- instrumentin për mbrojtjen e mjedisit;
- fuqizimin e komunitetit për veprime në mbrojtje të mjedisit;

bregdetare ranore e shkëmbore, ligatina bregdetare si liqeni i Butrintit, liqeni i Bufit (Rrëza) dhe laguna e Orikumit, përrenj, rrjedha, burime karstike, shpella etj. nga pikëpamja ekologjike, prania e një shumëllojshmërie të madhe habitatesh, krijon një numër të madh njësish ekologjike dhe për pasoje një nivel të lartë të biodiversitetit në zonë, e cila vështirë se gjendet në zonat e tjera të Shqipërisë apo në vendet fqinje. Flora dhe fauna e bregdetit jugor janë shumë të pasura dhe interesante. Siç u përmend më sipër, ne zonën e studimit ka rreth 1,400 bimë enësore (baraz me 42.4% të florës se Shqipërisë). Kjo shpjegohet: nga historia e vjetër e florës në këtë rajon (siç është prania e specieve apo relikeve të Terciarit), nga influenca e florave te tjera siç është ajo e Egjeut, (iii) nga izolimi gjeografik i rajonit (male te larta dhe barriera detare), dhe (iv) nga marrëdhëniet natyrë-njeri që janë vendosur këtu nëpër shekuj, duke krijuar habitate komplekse (natyrore, semi-natyrore, të modifikuar, artificialë) dhe peizazhe.

- kontrollin në përdorimet e burimeve natyrore;
- rritjen e mirëqenies nga manaxhimi afatgjatë i resurseve;
- mbrojtjen e pasojave financiare dhe socio-psikologjike;
- Bashkëpunimin komunitet-qeverisje lokal në gjetjen e zgjidhjeve të reja.

Auditimi Mjedisor detar është sot kërkesë e kohës. Pse …? Sepse vendos lidhjet midis njerëzve e mjedisit duke na sjell përfitime si:

- Mbrojtjen e pasurive natyrore;
- Minimizimin e goditjes ndaj mjedisit;
- Shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- Minimizimin e mbetjeve;
- Përzgjedhjen e teknologjisë "green" në përgjigje të sfidave mjedisore;
- Zvogëlimin e humbjeve dhe rritjen e përfitimeve.
- Mbi të gjitha mbrojtjen e shëndetit njerëzor.

Mekanizmat e auditimit mjedisor

Mekanizmat e auditimit mjedisor janë përdorimi i mjeteve të thjeshta ose të sofistikuara si:

- Sistemi i menaxhimit mjedisor;
- ISO 14001 ose EMAS;
- Vlerësimi i përmirësimit ambiental;
- Respektimi i standardeve;
- Produkte të pastra;
- Mbetjet, shkarkimet, rritja e eficensës, përcaktimi i mundësive të kursimit;
- Produktet ambientale;
- Zhvillimi i produkteve mjedisore, eko-etiketim.

Nga: Ing. Av. Sazan Guri, "G&G"Group
Ing. Alush Zaçe, Kryeauditues, KLSH

NDIKIMI I FAKTORËVE MAKROEKONOMIKË NË NUMRIN E NJËSIVE EKONOMIKE TË FALIMENTUARA

Dështimi mund të vijë për shkaqe të brendshme të njësisë ekonomike (keqmenaxhimi, shpenzime të larta, mosrealizim i të ardhurave, etj), por edhe për shkaqe të jashtme që nuk varen nga ajo (faktorët makroekonomikë dhe të tregut).

Nga: Doktorant Brunilda Neli,
Dr. Eni Numani, Pedagoge
Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Financës

Abstrakt

Sektori privat luan një rol shumë të rëndësishëm në ekonominë e vendit tonë, qëndrueshmëria dhe rritja e të cilit është vendimtare për ekonominë në përgjithësi. Krahas analizës së përfitueshmërisë dhe suksesit të njësive ekonomike, një rëndësi të veçantë në fushën e financave të ndërmarrjeve merr edhe falimentimi i njësive ekonomike. Njohja e faktorëve që ndikojnë në dështimin e njësive ekonomike është thelbësore jo vetëm për pronarët dhe drejtuesit e njësisë ekonomike, por edhe për punonjësit, furnitorët, qeverinë, huadhënësit dhe grupet e tjera të interesuara. Dështimi mund të vijë për shkaqe të brendshme të njësisë ekonomike (keqmenaxhimi, shpenzime të larta, mosrealizim i të ardhurave, etj), por edhe për shkaqe të jashtme që nuk varen nga ajo (faktorët makroekonomikë dhe të tregut). Ky punim ekzaminon faktorët makroekonomikë që ndikojnë në numrin e njësive ekonomike të falimentuara në Shqipëri nëpërmjet regresionit të shumëfishtë linear. Për të shprehur numrin e njësive ekonomike të falimentuara është përdorur numri i njësive ekonomike të mbyllura, ndërsa faktorët e përfshirë në analizë janë: GDP (rritja reale e prodhimit të brendshëm bruto), POP (përqindja e popullsisë në qytetin e Tiranës), GS (përqindja e kursimeve bruto në raport me prodhimin e brendshëm bruto), CI (norma e interesit për huadhënie), INFL (norma e inlacionit), REM (dërgesat e emigrantëve në raport me prodhimin e brendshëm bruto) dhe W (paga mesatare mujore). Nga analiza e kryer rezulton që vetëm norma e rritjes së GDP, norma e interesit të huadhënies dhe norma e inflacionit janë të rëndësishme statistikisht për të shprehur numrin e njësive të mbyllura në vendin tonë.

JEL classification: G32, G33

Fjalët kyçe: falimentimi; të ardhurat; përfitueshmëria; faktorë makroekonomikë.

1. Hyrje

Tregu në Shqipëri karakterizohet nga roli dominues i sektorit privat, si rrjedhim i decentralizimit ekonomik në vitet '90. Roli i sektorit privat në zhvillimin ekonomik dhe urban të një vendi është shumë i rëndësishëm. Zhvillimi ekonomik do të ishte më i kufizuar, nëse njësitë ekonomike private dhe tregtia e lirë nuk do të ekzistonin. Rëndësia dhe roli i sektorit privat në ekonominë e një vendi ndryshon në varësi të karakteristikave strukturore të tij. Njësitë ekonomike të suksesshme ndikojnë në rritjen e punësimit dhe në rritjen e të ardhurave tatimore në buxhetin e shtetit, të cilat sjellin rritjen e investimeve private dhe publike dhe rrjedhimisht, edhe të nivelit ekonomik të një vendi dhe të mirëqënies së popullsisë.

Meqë sektori privat luan një rol shumë të rëndësishëm në ekonominë e vendit tonë, qëndrueshmëria dhe rritja e tij është vendimtare për ekonominë në përgjithësi. Njohja e faktorëve që ndikojnë në dështimin e këtyre njësive është thelbësore jo vetëm për drejtuesit e njësisë ekonomike, por edhe për punonjësit, furnitorët, qeverinë, huadhënësit dhe grupet e tjera të interesuara. Dështimi mund të vijë për shkaqe të brendshme të njësisë ekonomike (keqmenaxhimi, shpenzime të larta, mosrealizim i të ardhurave, etj), por edhe për shkaqe të jashtme që nuk varen nga ajo (faktorët makroekonomikë dhe të tregut). Ky studim do të përqëndrohet në grupin e dytë të faktorëve.

Në seksionin e dytë të punimit jepet një vështrim i shkurtër rreth literaturës kyçe që ekziston rreth faktorëve që ndikojnë në numrin e njësive ekonomike të mbyllura. Në seksionin e tretë shpjegohen faktorët e përfshirë në studim, ndërsa seksioni i katërt përmban metodologjinë e përdorur, rezultatet e testimit dhe analizën e tyre. Së fundi, në seksionin e pestë, jepen konkluzionet e arritura nga studimi.

2. Objektivi dhe rishikimi i literaturës

Krahas analizës së përfitueshmërisë dhe suksesit të njësive ekonomike, një rëndësi të veçantë në fushën e financave të ndërmarrjeve merr edhe falimentimi i njësive ekonomike për vetë rëndësinë që kanë ato në zhvillimin ekonomik të çdo vendi dhe në mirëqënien e grupeve të shumta të interesit. Hapi i parë në këtë proces është identifikimi i faktorëve që çojnë në mbylljen e njësive ekonomike. Ekzistojnë shumë punime që studiojnë shkaqet që çojnë njësitë drejt falimentimit, duke u përqendruar kryesisht tek faktorët e brendshëm të njësisë. Më pak studime ka rreth faktorëve të jashtëm që ndikojnë në mbylljen e njësive ekonomike, duke krijuar kështu hapësirë për studime të reja. Në vijim janë përmendur studimet më të rëndësishme që kanë analizuar faktorët makroekonomikë që ndikojnë në mbylljen e njësive ekonomike.

Korol (2017) përdori të dhënat e 17 treguesve makroekonomikë për të

përcaktuar faktorët që ndikojnë në numrin e njësive ekonomike të falimentuara në Poloni. Nga modeli i ndërtuar rezultojnë vetëm tre variabla të rëndësishëm nga ana statistikore. Rezultatet e këtij punimi tregojnë që rritja e normës së papunësisë dhe rritja e GDP ndikojnë në rritjen e numrit të njësive ekonomike të falimentuara, ndërsa dobësimi i monedhës vendase ndikon në uljen e numrit të njësive ekonomike të falimentuara.

Një tjetër studim në lidhje me ndikimin e faktorëve makroekonomikë në numrin e njësive ekonomike të falimentuara është kryer nga Liu dhe Pang (2009). Në këtë punim u përdorën të dhënat për një periudhë 38 vjeçare të njësive ekonomike të falimentuara në Mbretërinë e Bashkuar. Rezultatet e Liu dhe Pang tregojnë që luhatjet e politikës monetare ndikojnë në rritjen e numrit të njësive ekonomike të falimentuara, e cila nga ana tjetër ka një ndikim të rëndësishëm në luhatjen e treguesve makroekonomikë.

Mačerinskienė dhe Mendelsonas (2013) studiuan faktorët makroekonomikë që ndikojnë në shkallën e falimentimit të njësive ekonomike që operojnë në Lituani. Për këtë qëllim ata përdorën analizën e regresionit dhe përdorën të dhënat tremujore nga viti 2002 deri në vitin 2011. Rezultatet e modelit përfundimtar tregojnë se vetëm tre variabla makroekonomikë ndikojnë në numrin e njësive ekonomike të falimentuara në Lituani: norma e rritjes së GDP, norma e inflacionit dhe norma bazë e interesit.

Një tjetër studim në këtë fushë është kryer për njësitë ekonomike që operojnë në Francë (Aleksanyan dhe Huiban, 2016). Objekti i këtij punimi janë njësitë ekonomike që i përkasin industrisë ushqimore. Rezultatet e studimit tregojnë se dy faktorët kryesorë që ndikojnë në falimentimin e njësive ekonomike janë rënia e produktivitetit dhe kosto e financimit.

Jacobsen dhe Kloster (2005) arritën në përfundimin se faktorët më të rëndësishëm në shpjegimin e numrit të njësive ekonomike të falimentuara janë ndryshimi i marzhit të fitimit, konkurueshmër, norma reale e interesit dhe luhatjet ciklike në ekonominë norvegjeze dhe atë ndërkombëtare. Ata përdorën të dhënat tremujore nga viti 1991 deri në vitin 2004.

Një studim tjetër i rëndësishëm është kryer në Suedi nga Salman, Friedrichs dhe Shukur (2011) me fokus sektorin e prodhimit. Për realizimin e qëllimit të punimit është përdorur metoda e katrorëve më të vegjël dhe të dhënat tremujore për periudhën 1986 – 2006. Rezultatet tregojnë se rritja e pagës reale ndikon në rritjen e numrit të njësive ekonomike të falimentuara. Gjithashtu, autorët arritën në përfundimin se rritja e aktivitetit industrial, ofertës monetare, produktit kombëtar bruto dhe hapjes ekonomike ndikojnë në reduktimin e numrit të njësive ekonomike të falimentuara.

3. Baza e të dhënave dhe variablat e përfshirë në studim

Ky punim ekzaminon faktorët makroekonomikë që ndikojnë në numrin e

njësive ekonomike të falimentuara në Shqipëri nëpërmjet regresionit linear të shumëfishtë, duke kontribuar në këtë mënyrë në shtimin e literaturës dhe rritjen e kërkimit shkencor vendas, meqë punimet shkencore në këtë fushë në Shqipëri nuk ekzistojnë.

Për ndërtimin e modelit janë përdorur të dhënat vjetore zyrtare të siguruara nga "Banka e Shqipërisë", "Instituti i Statistikave" dhe "Banka Botërore". Në këtë punim janë përfshirë në total 12 vrojtime.

3.1 Matja e numrit të njësive ekonomike të falimentuara

Procesi i falimentimit në vendin tonë rregullohet sipas Ligjit Nr. 110, datë 27.10.2016 "Për falimentimin". Sipas këtij ligji, shkaku i hapjes së procedurës së falimentimit mund të jetë gjendja e paaftësisë paguese e debitorit ose paaftësia paguese e debitorit në një të ardhme të afërt, nëse hapja e procedurës së falimentimit kërkohet nga vetë debitori. Debitori konsiderohet i paaftë për të paguar nëse nuk është në gjendje të shlyejë detyrimet e tij në datën e maturimit. Nga ana tjetër, debitori ndodhet në gjendjen e paaftësisë paguese në një të ardhme të afërt, kur debitori parashikon se nuk do të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet e tij në datën e maturimit. Duke qenë se të dhënat në lidhje me numrin e njësive ekonomike të konsideruara të falimentuara sipas ligjit për falimentimin nuk mund të sigurohen, si variabël i varur në këtë studim është përdorur numri i njësive ekonomike të mbyllura, bazuar në të dhënat e INSTAT.

3.2 Faktorët e përfshirë në model

Faktorët makroekonomikë të përfshirë në këtë punim bazohen në studimet e ngjashme, duke shtuar disa faktorë që janë specifikë për vendin tonë. Ata janë: rritja reale e prodhimit të brendshëm bruto (GDP), përqindja e popullsisë në qytetin e Tiranës (POP), përqindja e kursimeve bruto në raport me PBB (GS), norma e interesit për huadhënie (CI), norma e inflacionit (INFL), dërgesat e emigrantëve në raport me PBB (REM) dhe paga mesatare mujore (W).

Në këtë punim përdoret rritja reale e prodhimit të brendshëm bruto në regresion për të treguar rritjen e mirëqënies ekonomike të banorëve të vendit. Rritja e mirëqënies ekonomike mund të ndikojë në rritjen e shpenzimeve të konsumatorëve dhe rrjedhimisht në rritjen e të ardhurave të njësive ekonomike, duke ndikuar në rënien e numrit të njësive ekonomike të falimentuara.

Përqindja e popullsisë në qytetin më të madh të vendit, Tiranë, do të përdoret për të treguar efektin e ndryshimeve demografike. Ky variabël pritet të ketë një ndikim në rritjen e numrit të njësive ekonomike të falimentuara, pasi lëvizja e popullsisë nga qytetet e tjera drejt Tiranës ndikon negativisht tek të ardhurat dhe përfitueshmëria e njësive ekonomike në ato qytete.

Raporti i kursimeve bruto ndaj prodhimit të brendshëm bruto i shprehur në përqindje përdoret për të parë se si ndikon ndryshimi i qëndrimit të popullsisë ndaj parasë. Ky tregues pritet të ketë efekt negativ tek ecuria e njësive ekonomike. Kjo, për shkak se rritja e kursimeve sjell ulje të konsumit dhe si rrjedhim ulje të të ardhurave dhe të përfitueshmërisë së njësive ekonomike.

Norma e interesit të huadhënies përdoret për të parë se si kosto e burimeve të huajtura ndikon në numrin e njësive ekonomike të falimentuara. Efekti i rrijes së këtij treguesi pritet të çojë në shtimin e njësive të falimentuara. Kjo do të thotë që, sa më e lartë të jetë norma e interesit të huasë, aq më të larta janë shpenzimet e interesit dhe risku financiar i njësisë ekonomike. Rrjedhimisht, në këtë mënyrë bëhet më e vështirë mbijetesa për njësitë ekonomike.

Norma e inflacionit përdoret si tregues i ndikimit të rritjes së vazhdueshme të nivelit të përgjithshëm të çmimeve në numrin e njësive ekonomike të falimentuara. Meqënëse inflacioni ndikon në reduktimin e konsumit, ai pritet të sjellë shtim të numrit të njësive të falimentuara. Në rast të kundërt, efekti pritet të jetë negativ.

Raporti i dërgesave të emigrantëve ndaj prodhimit të brendshëm bruto, i shprehur në përqindje, tregon ndikimin e të ardhurave dytësore të familjeve në numrin e njësive ekonomike të falimentuara. Ky raport pritet të ketë një ndikim negativ në falimentimin e njësive, pasi rritja e dërgesave të emigrantëve shoqërohet me rritjen e konsumit të banorëve, e cila çon në rritjen e të ardhurave dhe përfitueshmërisë së njësive ekonomike.

Paga mesatare mujore është treguesi i fundit i përfshirë në këtë studim, i cili pritet të ndikojë negativisht në falimetim, pasi rritja e pagës ndikon në rritjen e shpenzimeve të konsumit dhe rrjedhimisht në përmirësimin e performancës financiare të njësive ekonomike.

Në tabelën e mëposhtme (Tabela 1) jepet një listë e variablave që përdoren në studim për të shprehur numrin e njësive ekonomike të falimentuara dhe përcaktuesit e tij, si edhe efekti i pritshëm i këtyre variablave.

Tabela 1: Variablat e përfshirë në model

	Variabli	Përshkrimi	Efekti i pritshëm
Variabli i varur	**BANKR**	Numri i njësive ekonomike të mbyllura	
Variablat e pavarur	**GDP**	Rritja reale e prodhimit të brendshëm bruto	-
	POP	Përqindja e popullsisë në qytetin e Tiranës	+
	GS	Përqindja e kursimeve bruto në raport me PBB	+
	CI	Norma e interesit për huadhënie	+
	INFL	Norma e inflacionit	+/-
	REM	Dërgesat e emigrantëve në raport me PBB	-
	W	Paga mesatare mujore	-

Burimi: Punim i Autorëve

4. Metodologji

Për të testuar lidhjen ndërmjet numrit të njësive ekonomike të mbyllura dhe faktorëve makroekonomikë, ne bazohemi në modelin e mëposhtëm të regresionit linear:

$Yt = \delta t + \alpha jt * Xjt + \varepsilon jt$ (1)

Duke përfshirë në formulë variablat e studiuar në këtë punim, ekuacioni (1) merr formën e mëposhtme:

$BANKR = \delta o + \alpha_1 * GDP + \alpha_2 * POP + \alpha_3 * GS + \alpha_4 * CI + \alpha_5 * INFL + \alpha_6 * REM + \alpha_7 * W + \varepsilon$ (2)

4.1 Analiza e rezultateve

Në tabelën e mëposhtme (Tabela 2) jepen rezultatet e regresionit linear:

Tabela 2: Rezultatet e regresionit linear

Regression Statistics	
Multiple R	0.987099
R Square	0.974365
Adjusted R Square	0.929504
Standard Error	0.027825
Observations	12

Burimi: Punim i Autorëve

Duke u bazuar në rezultatet e regresionit, shikojmë që koefiçienti i korrelacionit është 0.987, gjë e cila tregon për një lidhje të fortë ndërmjet variablave të përshirë në model. Koefiçienti i përcaktueshmërisë në modelin tonë është 92.95%, që do të thotë se 92.95% e numrit të njësive ekonomike të mbyllura shpjegohet ose ndikohet nga 7 variablat e përfshirë në modelin tonë, ndërsa pjesa e mbetur e njësive ekonomike të mbyllura ndikohet nga faktorë të tjerë që nuk janë përfshirë në model ose nga faktorë që nuk mund të maten nga ana sasiore.

Ngrejmë hipotezat për të vlerësuar rëndësinë e modelit:

Ho: modeli është jo i rëndësishëm statistikisht

Ha: modeli është i rëndësishëm statistikisht.

Në tabelën 3 jepet në mënyrë të përmbledhur informacioni në lidhje me rëndësinë statistikore të modelit.

	df	*SS*	*MS*	*F*	*Significance F*
Regression	7	0.11771	0.01682	21.71963	0.00496
Residual	4	0.00310	0.00077		
Total	11	0.12081			

Tabela 3: Tabela ANOVA

	df	*SS*	*MS*	*F*	*Significance F*
Regression	7	0.11771	0.01682	21.71963	0.00496
Residual	4	0.00310	0.00077		
Total	11	0.12081			

Burimi: Punim i Autorwve

Në kolonën e fundit shikojmë se sa i rëndësishëm është nga ana statistikore modeli ynë. Vëmë re se P < 0.05, gjë e cila tregon se modeli i përdorur në studim është i rëndësishëm statistikisht në shpjegimin e numrit të njësive ekonomike të mbyllura. Pra, hipoteza 0 bie poshtë dhe pranohet hipoteza Ha.

Në tabelën e mëposhtme (Tabela 4) jepet në mënyrë të përmbledhur informacioni në lidhje me koefiçientët dhe rëndësinë e çdo variabli të përfshirë në modelin e regresionit.

Tabela 4: Koefiçientët dhe rëndësia e çdo variabli

	Coefficients	*Standard Error*	*t Stat*	*P-value*	*Lower 95%*	*Upper 95%*	*Lower 95.0%*	*Upper 95.0%*
Intercept	- 14.012	6.445	- 2.174	0.095	- 31.906	3.883	- 31.906	3.883
GDP	**4.057**	1.406	2.886	**0.045**	0.155	7.960	0.155	7.960
POP	46.648	27.036	1.725	0.160	- 28.414	121.711	- 28.414	121.711
GS	1.057	0.416	2.537	0.064	- 0.100	2.213	- 0.100	2.213
CI	**7.186**	1.450	4.956	**0.008**	3.161	11.211	3.161	11.211
INFL	**- 16.780**	2.461	- 6.819	**0.002**	- 23.612	- 9.948	- 23.612	- 9.948
REM	1.927	2.256	0.854	0.441	- 4.336	8.191	- 4.336	8.191
W	0.000014	0.000	1.048	0.354	- 0.000	0.000	- 0.000	0.000

Burimi: Punim i Autorëve

Nga rezultatet e regresionit shikojmë që variablat që janë të rëndësishëm statistikisht në shpjegimin e modelit janë vetëm: GDP, CI dhe INFL.

Ndikimi i rritjes reale të prodhimit të brendshëm bruto, ndryshe nga ajo që parashikohej, është pozitiv. Rezultatet tregojnë se një rritje (ulje) e prodhimit të brendshëm bruto rrit (ul) numrin e njësive ekonomike të mbyllura që operojnë në Shqipëri. Ky rezultat mund të shpjegohet me arsyen se rritja e GDP fuqizon bizneset e mëdha, duke e bërë më të vështirë mbijetesën për bizneset e vogla dhe të mesme, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të bizneseve në vendin tonë.

Norma e interesit të kredisë, ashtu siç parashikohej, ka një ndikim pozitiv në numrin e falimetimeve të njësive, duke sugjeruar se sa më e lartë të jetë norma e interesit të kredisë aq më i lartë është numri i njësive ekonomike të mbyllura. Nga kjo kuptohet që normat e kredisë janë shumë të larta dhe njësitë nuk mund të përfitojnë nga efekti i levës financiare.

Koefiçienti i normës së inflacionit është negativ dhe ky rezultat sugjeron se rritja e normës së inflacionit nuk ndikon në uljen e kërkesës për produkte nga ana e

konsumatorëve. Si rrjedhim të ardhurat e realizuara nga njësitë ekonomike nuk pakësohen, duke ndikuar në uljen e njësive ekonomike të mbyllura. Ky rezultat, megjithëse në dukje paradoksal, është evidentuar edhe në studime të tjera empirike, ku është identifikuar që gjatë periudhave me normë të lartë inflacioni, norma e falimentimit ka qenë më e ulët.

Rezultatet e modelit të ndërtuar tregojnë se përqindja e popullsisë në qytetin e Tiranës, përqindja e kursimeve, paga mesatare mujore dhe dërgesat e emigrantëve nuk janë të rëndësishme nga ana statistikore në shpjegimin e numrit të njësive ekonomike të mbyllura.

Duke përjashtuar nga modeli variablat që rezultuan më sipër të parëndësishëm nga ana statistikore, marrim modelin përfundimtar, i cili ka formën e mëposhtme:

BANKR = - 14.012 + 4.057*GDP + 7.186*CI – 16.78*INFL (3)

5. Konkluzionet

Roli i sektorit privat në zhvillimin ekonomik dhe urban të një vendi është shumë i rëndësishëm. Mungesa e njësive ekonomike private dhe tregtisë së lirë do të kufizonin zhvillimin ekonomik, duke ndikuar negativisht në rritjen e punësimit dhe në rritjen e të ardhurave tatimore në buxhetin e shtetit, të cilat më pas do të shoqëroheshin me një rritje të kufizuar në investimet private dhe publike dhe rrjedhimisht, edhe të nivelit ekonomik të vendit dhe të mirëqënies së popullsisë. Për këtë arsye, studimi i faktorëve që ndikojnë në falimentimin e njësive ekonomike merr një rëndësi të veçantë.

Në këtë punim janë studiuar faktorët makroekonomikë që ndikojnë në numrin e njësive ekonomike të falimentuara në Shqipëri nëpërmjet regresionit të shumëfishtë linear. Për shkak të mungesës së databazës në vendin tonë në lidhje me bizneset e falimentuara në përputhje me ligjin e falimentimit, për të shprehur numrin e njësive ekonomike të falimentuara është përdorur numri i njësive ekonomike të mbyllura.

Faktorët e përfshirë në regresion në këtë punim janë GDP (rritja reale e prodhimit të brendshëm bruto), POP (përqindja e popullsisë në qytetin e Tiranës), GS (përqindja e kursimeve bruto në raport me prodhimin e brendshëm bruto), CI (norma e interesit për huadhënie), INFL (norma e inlacionit), REM (dërgesat e emigrantëve në raport me prodhimin e brendshëm bruto) dhe W (paga mesatare mujore).

Nga testimi i modelit të ndërtuar rezultatet tregojnë se modeli është i rëndësishëm statistikisht në nivelin 5% dhe se faktorët e përfshirë në studim shpjegojnë rreth 92.95% të numrit të njësive ekonomike të mbyllura. Faktorët që rezultojnë të rëndësishëm në aspektin statistikor në analizë janë vetëm rritja reale e prodhimit të brendshëm bruto, norma e interesit të huadhënies dhe norma e inflacionit. Ashtu siç mbështetet edhe në literaturë, norma e interesit të huadhënies ka efekt pozitiv në falimentim, pasi nëse arrin nivele të larta, njësitë nuk arrijnë të përfitojnë nga efekti i levës financiare, por shpenzimet e interesit

ndikojnë ndjeshëm në uljen e përfitueshmërisë, derisa njësitë dështojnë financiarisht.

Përfundime më kontradiktore vihen re edhe në literaturë lidhur me normën e rritjes së GDP-së dhe inflacionin. Studimi ynë tregon se rritja e normës së rritjes së GDP-së në fakt rrit numrin e njësive të mbyllura. Kjo mund të shpjegohet me arsyen se rritja e GDP fuqizon bizneset e mëdha, duke e bërë më të vështirë mbijetesën për bizneset e vogla dhe të mesme, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të bizneseve në vendin tonë. Nga ana tjetër, rritja e inflacionit çon në reduktimin e njësive të mbyllura. Të dyja fenomenet mund të rezultojnë gjithashtu edhe nga operimi i biznesit në kushtet e ekonomisë informale, qarkullimi i sasive të mëdha të parasë së padeklaruar, etj, që bëjnë të vështirë matjen e saktë të këtyre dy treguesve.

Ky studim përbën një bazë të rëndësishme analize për politikëbërësit dhe bizneset për të kuptuar faktorët makroekonomikë që çojnë njësitë ekonomike drejt falimentimit. Qeveria duhet të mbështesë më tepër bizneset e vogla dhe të mesme, që të sigurojnë qëndrueshmëri afatgjatë në treg dhe të krijojë stimuj ekonomikë që t'i mbijetojnë konkurencës me bizneset e mëdha. Gjithashtu, një vëmendje më e madhe duhet shtuar drejt mënyrave të financimit të këtyre bizneseve dhe rishikimit të normave të interesit, pasi huatë bankare rezultojnë shumë të shtrenjta. Nga ana tjetër, institucionet qeveritare duhet të jenë më transparente në drejtim të informacionit rreth njësive të falimentuara, duke krijuar një bazë të dhënash që mund të aksesohet nga të gjithë të interesuarit. Kjo krijon mundësinë e studimeve dhe analizave më të thelluara në këtë fushë, por gjithashtu shërben si një pasqyrë për bizneset e reja që do të krijohen për të identifikuar edhe sektorët më riskorë (në bazë të kompanive të falimentuara për çdo sektor).

Referencat

Aleksanyan, L., Huiban, J. P. (2016). "Economic and financial determinants of firm bankruptcy: evidence from the French food industry", *Review of Agricultural, food and environmental studies*.

Banka Botërore: https://www.worldbank.org/

Banka e Shqipërisë: Databaza statistikore. https://www.bankofalbania.org/

Instituti i Statistikave: Databaza statistikore. http://www.instat.gov.al/

Jacobsen, D. H., Kloster, T. B. (2005). "What influences the number of bankruptcies", *Norges Bank, Economic Bulletin,* Vol. 4/2005.

Korol, T. (2017). "Evaluation of the factors influencing business bankruptcy risk in Poland", *e-Finance*, Vol. 13, No. 2.

Ligji Nr. 110, datë 27.10.2016 "Për falimentimin".

Liu, J., Pang, D. (2009). "Business failures and macroeconomic factors in the UK", *Bulletin of Economic Research*, Vol. 61, Issue 1.

Macerinskiene, I., Mendelsonas, T. (2013). "Macroeconomic determinants of corporate insolvency", *KSI transactions on knowledge society*, Vol. 6, No. 3.

Salman, A. K., Von Friedrichs, Y., Shukur, G. (2011). "The determinants of failure of small manufacturing firms: Assessing the macroenonomic factors", *International Business Research* Vol. 4, No. 3.

Nga: Doktorant Brunilda Neli, Dr. Eni Numani, Pedagogë Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Financës

OPINIONET E GJYKATËS EVROPIANE TË AUDITUESVE PËR PROPOZIMET LIGJORE TË KOMISIONIT PËR LUFTËN KUNDËR MASHTRIMIT

Kontrolli i brendshëm i shpenzimeve të BE-së është forcuar ndjeshëm në dhjetë vitet e fundit. Efektiviteti në rritje i sistemeve të kontrollit të brendshëm të Komisionit Evropian dhe të shteteve anëtare ilustrohet gjithashtu me rënien nga viti në vit të nivelit të vlerësuar nga ECA të gabimeve në pagesa, i cili gjithashtu mund të shihet si vlerësim i shkallës në të cilën shpenzimet nuk respektojnë rregullat financiare të BE-së.

Nga: Eva Lindström, anëtare e ECA

Publikuar në revistën e ECA, Nr.2, 2019

Kontrollet të brendshme më të mira - më pak gabime

Kontrolli i brendshëm i shpenzimeve të BE-së është forcuar ndjeshëm në dhjetë vitet e fundit. Efektiviteti në rritje i sistemeve të kontrollit të brendshëm të Komisionit Evropian dhe të shteteve anëtare ilustrohet gjithashtu me rënien nga viti në vit të nivelit të vlerësuar nga ECA të gabimeve në pagesa, i cili gjithashtu mund të shihet si vlerësim i shkallës në të cilën shpenzimet nuk respektojnë rregullat financiare të BE-së. Për të tretin vit radhazi, puna jonë e auditimit në kontekstin e Deklaratës vjetore të Sigurisë (DVS) tregon një nivel në rënie të gabimeve në shpenzimet e BE-së. Për vitin financiar 2015, niveli i vlerësuar i gabimit në pagesa arriti në 3.8%, ndërkohë që në vitin 2016 ishte 3.1% dhe në 2017 ishte 2.4%. Për përgatitjen e Deklaratës vjetore të Sigurisë për vitin 2017, audituesit tanë shqyrtuan rreth 700 transaksione. Për shkak të dyshimit për mashtrim të mundshëm, 13 prej tyre iu përcollën Zyrës së Anti-Mashtrimit të BE-së (OLAF) për hetime të mëtejshme. Raportet tona speciale 1/2019 për luftën kundër mashtrimit në shpenzimet e BE-së dhe 6/2019 për trajtimin e mashtrimit në shpenzimet e kohezionit të BE-së bëjnë të qartë se: lufta kundër mashtrimit dhe korrupsionit duhet të forcohet, si në nivelin e BE-së ashtu edhe në atë të shteteve anëtare. Kjo është e rëndësishme për projektin evropian, jo vetëm në dritën e rritjes së skepticizmit të BE-së në një numër vendesh.

Opinioni i ECA mbi Programin e ardhshëm të BE-së kundër mashtrimit.

Në Opinionin tonë Nr 9/2018, të botuar në nëntor 2018, ne komentuam propozimin për krijimin e programit të ardhshëm të BE-së kundër mashtrimit, për të cilin buxheti i propozuar është 181 milion € për të gjithë periudhën 2021-2027. Ky program, i cili administrohet drejtpërdrejt nga Komisioni është i vetmi i këtij lloji i dedikuar për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian. Objektivat specifike të programit janë:

- të parandalojë dhe të luftojë mashtrimin, korrupsionin dhe çdo veprimtari tjetër të paligjshme që prek interesat financiare të BE-së;
- të mbështesë raportimin për parregullsitë, përfshirë mashtrimet;
- të sigurojë mjete për shkëmbimin e informacionit dhe mbështetje për aktivitetet operacionale në fushën e ndihmës administrative të ndërsjellë në çështjet doganore dhe të agrikulturës.

Në veçanti, ai mbështet ndihmën e ndërsjellë midis autoriteteve administrative të shteteve anëtare, si dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre dhe Komisionit për të siguruar zbatimin e saktë të ligjit për doganat dhe çështjet e agrikulturës. Programi në thelb do të jetë në vazhdim të programeve paraardhëse si programi Hercule III, ndërkohë që do të financojë gjithashtu Sistemin e Informacionit Anti-Mashtrim (AFIS) dhe Sistemin e Informacionit të Parregullsive (IMS). Në opinionin e dhënë, ne mirëpritëm iniciativën për të thjeshtuar menaxhimin e buxhetit në këtë mënyrë. Ne gjithashtu konsiderojmë se një qasje e tillë mund të kontribuojë në përdorimin efiçient dhe efektiv të burimeve në fusha të ngjashme. Sidoqoftë kritika jonë konsistonte në atë që propozimi nuk ishte bazuar në një vlerësim gjithëpërfshirës të ndikimit që do të kishte implementimi i këtij programi. Për më tepër, ne vumë në dyshim vlerën e shtuar të programit dhe theksuam riskun e mbivendosjeve dhe mungesës së sinergjive me veprimet e tjera të BE-së. Në përfundim ne vumë re se monitorimi i zbatimit, vlerësimi i rezultateve dhe targetimi efektiv i fondeve për veprimet që sigurojnë vlerën e shtuar do të ishte i vështirë, pasi objektivat e programit dhe treguesit e tij të performancës nuk ishin mjaftueshëm të qartë dhe specifikë. Duke marrë parasysh rëndësinë që i është dhënë luftës kundër mashtrimit të buxhetit të BE-së, Parlamenti Evropian rriti fondet e programit në 321 milion €.

Opinioni i ECAs për hetimet EPPO dhe OLAF

Opinioni ynë i fundit 8/2018 i publikuar në nëntor 2018, në lidhje me luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit lidhej me propozimin e Komisionit për të ndryshuar rregulloren e OLAF dhe përshtatjen e funksioneve të tij me krijimin e Zyrës së Prokurorit Publik Evropian (EPPO).

Që nga themelimi në vitin 1999 OLAF, (Zyra evropiane për luftën kundër mashtrimit e BE) ka qenë përgjegjëse për zhvillimin e politikave kundër mashtrimit dhe kryerjen

e hetimeve të pavarura administrative për rastet e dyshuara të mashtrimit, korrupsionit dhe aktiviteteve të paligjshme që prekin interesat financiare të BE. Qëllimi i këtyre hetimeve administrative është të rikuperojnë paratë e harxhuara në mënyrë të gabuar. OLAF nuk mund të kryejë ndjekje penale nën dyshimin e mashtrimit, por vetëm mund të bëjë rekomandime. Në vend të kësaj, autoritetet kombëtare duhet të veprojnë. Hetimet administrative të kryera nga OLAF dhe të nisura në bazë të dyshimeve për mashtrim janë shpesh komplekse dhe sensitive. Nëse ekzistojnë arsye të cilat ngrenë dyshime për mashtrim, është e rëndësishme të sigurohen prova, dhe nëse dyshimet rezultojnë të gabuara, procedura duhet të respektojë integritetin e individit ose organizatës së përfshirë. Aktualisht një hetim i OLAF zgjat mesatarisht midis 17 dhe 18 muaj. Kësaj i duhet shtuar edhe koha e nevojshme për procedurat gjyqësore në gjykatat kombëtare. Koha në vetvete është një faktor thelbësor për të shmangur mundësitë që mashtruesit të zhduken ose të mbulojnë gjurmët e tyre.

Është e vështirë të vlerësohet se sa shpenzime të BE-së mund të konsiderohen të humbura për shkak të mashtrimit. Në vitin 2017, OLAF hapi 215 hetime për raste të dyshuara mashtrimi dhe përfundoi 197 hetime. Si rezultat i këtyre hetimeve OLAF rekomandoi rikuperimin e 3 miliardë eurove.

Zyra e Prokurorit Publik Evropian - EPPO - do të fillojë të funksionojë në fund të vitit 2020 ose në fillim të vitit 2021 e më tej. Kjo zyrë do të jetë përgjegjëse për hetimin, ndjekjen penale dhe përcjelljen për gjykim të veprave penale që prekin interesat financiare të BE-së, në kuptimin e direktivës PIF (Mbrojtja e interesave financiare). EPPO po krijohet duke u bazuar në modelin e bashkëpunimit të zgjeruar të 22 shteteve anëtare aktualisht. Duke pasur parasysh që EPPO do të jetë e autorizuar të hetojë dhe ndjekë penalisht interesat financiare të BE-së në shtetet anëtare pjesëmarrëse, krijimi i saj ndryshon ndjeshëm mjedisin ligjor dhe institucional, i cili adreson luftën kundër mashtrimet të interesave financiare të BE-së.

Qëllimi i propozimit ishte të lehtësonte bashkëpunimin e ardhshëm midis dy organeve në luftën kundër mashtrimit dhe të forconte efektivitetin e funksionit hetimor të OLAF. Çështjet që lidhen me OLAF dhe punën e tij kanë qenë një temë me interes për shumë vite si për Parlamentin Evropian dhe për Komitetin e tij për Buxhetin dhe Kontrollin, ashtu edhe për Këshillin. Kjo është një çështje komplekse që përfshin jo vetëm sfida organizative, por gjithashtu adreson varësinë dhe proporcionalitetin nga këndvështrimi i shteteve anëtare. Ne konsideruam që propozimi pasqyron mirë parimet që duhet të qeverisin bashkëpunimin midis OLAF dhe EPPO, të tilla si bashkëpunimi i ngushtë, shkëmbimi i informacionit, plotësimi dhe mos-dublikimi i punës. Sidoqoftë, gjetëm edhe disa dobësi, siç është nevoja për të rritur efektivitetin e hetimeve të OLAF, afatet dhe rikuperimin e fondeve. Këto mbeten sfidat kryesore për t'u adresuar.

Propozimi përfshin një numër të kufizuar masash, të cilat ne i mirëpritëm sepse ato duhet të ndihmojnë në përmirësimin e efektivitetit. Ndër të tjera, këto masa kanë të bëjnë me: qartësimin se në cilat raste gjen zbatim ligji kombëtar ose evropian gjatë kontrolleve në objekt të OLAF; aksesin e OLAF në informacione mbi llogaritë bankare; ndërtimin e mekanizmave për të forcuar pranimin e provave të mbledhura nga OLAF; qartësimin në propozim të mandatit të OLAF për çështjet e Taksës së Vlerës së Shtuar (TVSH).

Në të njëjtën kohë, ne gjithashtu deklaruam se ndryshimet e propozuara nuk do të zgjidhnin çështjen e përgjithshme të efektivitetit të hetimeve administrative të OLAF. Kjo është vlerësuar edhe nga Komisioni, i cili planifikon të propozojë një modernizim më gjithëpërfshirës të kornizës rregullatore të OLAF në një fazë të mëvonshme. Aktualisht nuk ka një afat kohor për një reformë të mëtejshme të OLAF dhe nuk janë identifikuar qartë se cilat çështje do të adresohen.

Ne gjithashtu theksuam nevojën për veprime të mëtejshme. Ne propozuam fillimisht që Komisioni të adresojë çështjen e përgjithshme të efektivitetit të OLAF dhe të rishqyrtojë rolin dhe përgjegjësitë e OLAF në luftën kundër mashtrimit me shpenzimet e BE-së. Në këtë drejtim, OLAF mund t'i jepet një rol strategjik dhe mbikëqyrës në veprimet e BE kundër mashtrimit. Në planin afatmesëm, Komisioni duhet të vlerësojë bashkëpunimin midis OLAF dhe EPPO dhe, kur të jetë e përshtatshme, të propozojë veprime të mëtejshme legjislative. Aktualisht, propozimi është ende në negociata midis Këshillit dhe Parlamentit Evropian.

Bashkëpunimi i suksesshëm do të jetë thelbësor në luftën kundër mashtrimit

Autoritetit të shteteve anëtare dhe institucioneve të BE-së duhet t'u jepet prioritet në trajtimin e dyshimeve për mashtrim dhe korrupsion. Kjo është thelbësore për ruajtjen e besimit të qytetarëve tek BE. Në këtë drejtim, propozimi i Komisionit për EPPO mund të sjellë ndryshimin, nëse EPPO ngrihet siç duhet dhe me burime të përshtatshme. Megjithatë, deri më tani, jo të gjitha shtetet anëtare kanë zgjedhur të marrin pjesë në EPPO. Danimarka, Irlanda, Hungaria, Polonia dhe Mbretëria e Bashkuar nuk po marrin pjesë. Bazuar në fjalimin e Kryeministrit të Suedisë në Parlamentin Evropian më 4 Prill 2019 këtij propozimi pritet ti bashkohet edhe Suedia. Për të ardhmen është e rëndësishme që bashkëpunimi midis OLAF dhe EPPO të funksionojë mirë dhe të rrisë efektivitetin e hetimeve të OLAF. Kur krimi ndërkombëtar siç është mashtrimi nuk i njeh kufijtë e BE, ndërsa lufta kundër tij i njeh ato, atëherë ekziston qartë një situatë e pafavorshme. Mundësia për të ndjekur penalisht përtej kufijve rritet me krijimin e EPPO dhe kjo përbën një mundësi më të madhe për dekurajimin e mashtrimit dhe rritjen e sasisë së parave të kthyera mbrapsht.

Dyshimi i thjeshtë se shtetet anëtare, autoritetet kombëtare ose institucionet nuk po i trajtojnë interesat financiar të BE-së me shqetësimin e duhur tashmë ka dëmtuar besimin e qytetarëve në BE. Si auditues të jashtëm të BE-së, ne do të vazhdojmë të jemi vëzhgues të tyre dhe shqyrtojmë përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të financave të BE-së, si dhe të sigurojmë një vlerësim të pavarur të politikave dhe programeve të BE-së. Në fund të fundit, bëhet fjalë për paratë e taksapaguesve.

Përktheu: Alma Shehu

Specialiste, Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga: Eva Lindström, anëtare e ECA
Publikuar në revistën e ECA, Nr.2, 2019

LIDERSHIPI I NDERSHËM SI NJË PËRGJIGJE NDAJ KORRUPSIONIT DHE MASHTRIMIT

Mashtrimi dhe korrupsioni mund të dobësojnë themelet e këtij bashkëpunimi dhe mund të gërryejnë besimin e qytetarëve në shoqëritë tona. Për shembull, shumica e programeve të BE menaxhohen nga Komisioni Europian, së bashku me Shtetet Anëtare. Ky menaxhim i përbashkët kërkon besim dhe, mbi të gjitha, bashkëpunim reciprok.

Nga: Alex Brenninkmeijer, Anëtar i ECA

Publikuar në revistën e ECA, Nr.2, 2019

Si një ish gjykatës dhe Avokat i Popullit në Holandë, si një akademik dhe tashmë si një anëtar i ECA, Alex Brenninkmeijer ka punuar gjerësisht me procedurat dhe vendimmarrjen e institucioneve qeveritare. Në fillim të vitit 2019 ai botoi një libër mbi udhëheqjen e ndershme, të cilën ai e konsideron si një element kyç në përcaktimin se ç 'drejtim do të marrë një person, një biznes, një institucion apo edhe një shoqëri. Në këtë artikull, ai argumenton se udhëheqja (lidershipi) e ndershme mund të jetë një përgjigje ndaj korrupsionit dhe të parandalojë mashtrimin, duke vënë dukje disa hapa kyç që mund të na ndihmojnë për të qenë drejtues të ndershëm.

Reflektimi moral për të ndaluar mashtrimin dhe korrupsionin

Nuk është e nevojshme imagjinata për të lidhur mashtrimin dhe korrupsionin me mungesën e integritetit dhe udhëheqjen e ndershme. Eksperienca, gjithsesi, na tregon që në shumë vende mashtrimi dhe korrupsioni mund të lulëzojnë kur mungojnë kufizimet dhe reflektimi moral. Ish Presidenti i Shteteve të Bashkuara Barack Obama, në fjalimin e tij me rastin e 100 vjetorit të lindjes së Nelson Mandelës, argumentoi se të ashtuquajturit 'të fortë' kanë potencialin të kërcënojnë shtetet tona demokratike dhe sundimin e ligjit. Bota jonë e bazuar në rregulla, e mirë organizuar dhe liberale mund të kthehet në një mënyrë të të bërit biznes të vjetruar, më të rrezikshme dhe më brutale. Ekziston gjithashtu risku që këta 'të fortë' të minojnë institucione në të cilët demokracia është e rrënjosur.[1] Ndryshe nga kjo, bashkëpunimi Europian, në natyrën e tij është i bazuar mbi respektimin e rregullave të pranuara nga të gjitha palët, balancën e interesit brenda shoqërisë e midis shteteve, dhe bashkëpunimin besimplotë.

[1] The Guardian, 17 Korrik 2018.

Mashtrimi dhe korrupsioni mund të dobësojnë themelet e këtij bashkëpunimi dhe mund të gërryejnë besimin e qytetarëve në shoqëritë tona. Për shembull, shumica e programeve të BE menaxhohen nga Komisioni Europian, së bashku me Shtetet Anëtare. Ky menaxhim i përbashkët kërkon besim dhe, mbi të gjitha, bashkëpunim reciprok. Në këtë sistem, ne në Gjykatën Europiane të Audituesve ofrojmë sigurinë për qytetarët europianë që paraja e BE është shpenzuar në mënyrë të vlefshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sepse shpenzimi i parasë nga BE nuk nënkupton pasurimin e disa individëve që përpiqen të fshehin qëllimet e tyre për mashtrim.

Dinjiteti njerëzor përkundrejt autoritarizmit

Demokracia dhe rregulli i ligjit janë pjesë kyçe të udhëheqjes së ndershme. Historia na tregon se drejtues të ndershëm të rëndësishëm siç janë Mahatma Gandhi, Martin Luther King, Vaclav Havel dhe Nelson Mandela luftuan të gjithë për dinjitetin njerëzor, si shprehje e të drejtave të njeriut, si pjesë e luftës kundër autoritarizmit dhe regjimeve koloniale. Thelbi i bindjes së tyre morale do të ishte njohja si të barabartë të çdo qenieje njerëzore. Njerëzit mund të jenë të ndryshëm, po janë të gjithë njerëz.

Demokracia – 'një njeri një votë' – dhe rregulli i ligjit, së bashku me barazinë përpara ligjit janë principet më themelorë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Të gjitha janë të riskuara drejtpërdrejt nëse udhëheqësit tanë, apo gjykatësit, ose audituesit dhe kushdo që shërben në administratën publike nuk kanë qasje drejt principeve të integritetit dhe ndershmërisë, por përkundrazi priren drejt mashtrimit dhe korrupsionit. Pra, pyetja kyçe është: si mundemi ne si individë të mbështesim integritetin dhe ndershmërinë? Si mundemi ne të identifikojmë dhe shfaqim udhëheqjen e ndershme?

Të menduarit, shpejt dhe ngadalë

Në analizat e mia mbi 'ndjekjen e udhëheqjes së ndershme', kam argumentuar se dy aspekte janë themelorë: të menduarit ngadalë, nëse është e nevojshme, dhe të gjeturit e një balance midis tre aspekteve fondamentalë të jetës sonë të përditshme: dija, pasioni dhe karakteri.

Dija, pasioni dhe karakteri

Në librin e tij *Retorika*, Aristoteli paraqet analizën e tij mbi mënyrat e bindjes. Elementët që ai paraqet për bindjen nga fjalët e folura janë dija, pasioni dhe karakteri. Dija lidhet me mendjen, të arsyetuarit, dhe zakonisht përdoret për të përshkruar faktet dhe figurat, duke prezantuar përbërjen faktike. Ajo e bën folësin të duket i ditur. Pasioni lidhet me ndjesinë që folësi mund të përcjellë tek publiku i tij dhe shfaqet tek emocionet e audiencës. Pra ai mund të cilësohet si ndjenjat e vetë folësit, ose ndjenjat e përcjella ndaj audiencës. Së fundmi, karakteri lidhet me aspektin moral, në formën e një gjykimi, dhe gjithashtu tregon diçka nga karakteri personal i folësit

Në jetën tonë të përditshme, ne jemi mësuar të aplikojmë shumë shkurtime në mendjen tonë dhe përdorimi i tyre shpesh herë është shumë i efektshëm, duke na dhënë mundësinë për të vepruar me shpejtësi duke u bazuar në njohuritë dhe eksperiencën e fituar gjatë kohës. Ato janë rezultat i procesit të të mësuarit tonë individualisht dhe të huazuarit prej të tjerëve. Të ndaluarit në një dritë të kuqe semafori është një automatizim i cili ndihmon sigurinë në rrugë. Shumë vendime në jetën tonë të përditshme bazohen në këto zgjedhje të shpejta. Gjithsesi, fituesi i çmimit Nobel, Daniel Kahneman prezantoi diferencën mes 'të menduarit shpejt dhe të menduarit ngadalë', duke treguar dy sisteme të ndryshme në të menduarit tonë[2]. Nëse futemi në një 'fushë të njohur, ne duhet së pari të identifikojmë riskun që lidhet me situatën specifike në jetën tonë shoqërore. Me fjalë të tjera, Kahneman thekson se jo çdo vendim, jo çdo situatë mund të zgjidhet me 'të menduarit shpejt'. Në disa situata ne duhet të bëjmë një hap mbrapa, të mbledhim sa më shumë informacion që të jetë e mundur, dhe duhet të kryejmë një reflektim tërësor.

Për më tepër, ne jemi qenie racionale, me ndjenja, por së pari dhe më së shumti, ne duhet të gjejmë orientimin tonë drejt vlerave. Duke lexuar 'Udhëtimi i gjatë i lirisë' të Nelson Mandelas, u impresionova nga mënyra me të cilën ai balanconte dijen, pasionin dhe karakterin përmes veprimeve të tij. Por dija, pasioni dhe karakteri nuk janë vetëm elemente kyçe në aspektin e një retorike, balancimi i këtyre tre aspekteve të jetës sonë, është kyçi për gjetjen e rrugës drejt udhëheqjes së ndershme.

Mund t'u shpjegoj të tjerëve se me çfarë merrem unë

Imagjinoni sikur ju filloni të punoni në një organizatë publike, e cila merret me certifikimin nëse kostot që do të financohen nga BE janë realizuar për një projekt të dakordësuar me Komisionin. Kjo organizatë sigurisht që do të ketë një rutinë në kryerjen e deklarimeve të kostos. Duke menduar shpejtë, ju thjesht ndiqni 'traditën' dhe mënyrën e të vepruarit të organizatës. Por papritur, ju mendoni që këto deklarime të kostos nuk janë kryer në mënyrën e duhur dhe rezultojnë në mbingarkim dhe përfitime të palës marrëse. Ju mendoni se kjo nuk është e thjeshtë, aq para sa janë marrë, dhe ngrihen pyetje siç janë: 'Xhepat e kujt po mbushen?' dhe 'A është e ligjshme kjo?'. Shembuj të ngjashëm mund të gjenden përsa i përket procedurave të prokurimit publik.

Në rastet e deklarimeve të kostos, të menduarit ngadalë mund të jetë i dobishmëm: Cilët janë ligjet? Cilat janë shpenzimet? Çfarë është e arsyeshme? Çfarë do të mendojnë njerëzit për këtë deklarim kostoje dhe pagesat pasuese? Nëse një kamera do të ndiqte këtë transaksion, a do të ishte e qetë me të bota e jashtme? Sigurisht, transparenca mund

[2] Daniel Kahneman, Thinking, Fast and Slow, Penguin Books Ltd, Janar 2012

të gjenerojë reagim të vlefshëm. Të ndiesh vetëbesim që 'Unë mund të shpjegoj veprimet e mia për të tjerët' është një fillim i mirë për të aplikuar metodën e të menduarit ngadalë.

Gjithsesi, Kahneman thekson se ne, si qenie njerëzore, kemi vetëm kapacitet të limituar të trurit dhe ne riskojmë të fusim shumë paragjykime kur procesojmë të dhënat përkatëse dhe pasojat e veprimeve tona. Ne gjithmonë përpiqemi të përshtatim pikëpamjen tonë mbi realitetin në formën e zonës sonë të qetësisë. Për më tepër, mund të ketë risk të diskutoni një praktikë të vendosur në organizatën tuaj, ose të diskutoni një rutinë të caktuar, e cila është e pëlqyeshme nga një apo disa persona të tjerë në të njëjtën organizatë. Grekët e lashtë i referoheshin kësaj situate si 'parrhesia', e cila mund të përkthehet të qenurit i sinqertë dhe i hapur, duke thënë të vërtetën për të mirën e përbashkët, për një botë të vetme, gjithashtu të quajtur 'të folurit me fuqinë e së vërtetës'.

Në pikëpamjen time, të folurit me fuqinë e së vërtetës mund të fillojë që herët në mëngjes kur shihem në pasqyrë, dhe i drejton vetes një pyetje të sinqertë: 'Pse po e bëj këtë?' – dhe 'A mundem unë ta shpjegoj përgjigjen e kësaj pyetjeje për njerëzit e mi më të afërt?' Nuk është e rëndësishme vetëm të dimë çfarë ne bëjmë dhe si e bëjmë atë. Pyetja më e rëndësishme është 'pse'-ja. Kjo pyetje 'pse' mund të na drejtojë jashtë fushës së njohur që Kahneman përmend në studimin e tij mbi 'Të menduarit, Shpejt dhe Ngadalë'.

Duke synuar arsyetimin e brendshëm

Bota jonë është komplekse dhe jeta jonë profesionale është pjesë e këtij kompleksiteti. Mendoj se kjo është arsyeja se pse kujdesja për kopshtin, ecja ose të ngarit e biçikletës kthehen në gjëra kaq tërheqëse: mund të jenë shumë më të thjeshta se të praktikojmë profesionin tonë. Por, kjo është ajo për të cilën paguhemi dhe zgjedhim të bëjmë. Në këtë botë komplekse, ne shpesh gjejmë një qetësi të sigurtë tek ligjet, procedurat, zakonet, protokollet dhe buxhetet. Gjithsesi, këto janë vetëm një pjesë e asaj ç'ka është e nevojshme në marrjen e vendimeve të duhura. Për të qenë bindës ne nuk mund t'i referohemi vetëm ligjeve dhe procedurave. Ka gjithmonë nevojë për drejtësi të brendshme ose arsyetim. Nëse unë i shpjegoj mbesës time 13-vjeçare se me çfarë merrem unë, ajo do të mendonte: 'Kjo është e drejtë!'. Dhe mbesat 13-vjeçare kanë gjithmonë një matës të mirë për drejtësinë.

Të gjeturit e kësaj drejtësie apo arsyetimi kërkojnë një reflektim në tre aspektet themelorë të ekzistencës sonë si qenie njerëzore: ne nuk jemi vetëm 'racional' por kemi gjithashtu ndjenjat dhe bindjet tona. Në një botë racionale, 'ndjenjat' përshkruhen shpesh si 'dobësi' ose 'brishtësi'. Kjo dikton që më së shumti në kulturën ka një hierarki, ku racionaliteti dhe dija qëndrojnë mbi pasionin. Gjithsesi, psikologjia na tregon se ne mendojmë se jemi vetëm racionalë, por veprimet tona diktohen nga emocionet. Duke ditur këtë, mund të jetë ndihmesë reflektimi mbi shqetësimet tona, frikën dhe krenarinë, dhe ato të personave të tjerë të përfshirë

në çështje. Nëse një vendim merret sipas ligjeve dhe procedurave por ndjesia për të nuk është e mirë, ndoshta ne jemi duke hyrë në atë fushën njohëse që Kahneman ka identifikuar. Nëse bëhet fjalë për bindjet tona-dhe ato të të tjerëve-një palë e tretë e ekzistencës tonë të njohur shfaqet: normat etike, të cilat ne dhe të tjerët synojmë.

Këto norma etike mund të përputhen me ligjet dhe rregulloret në fuqi, por janë shpesh herë më të gjera. Jo çdo gjë që është brenda kornizës ligjore është e arsyetuar nga ana etike. Normat etike mund të jenë themelore, siç janë të drejtat themelore të çdo njeriu siç mishërohen në traktatet ndërkombëtarë dhe në Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së. Gjithsesi, shumë rregulla etike bazohen në bindjet e brendshme të gjithsecilit prej nesh. Të jesh një shembull i mirë dhe të inspirosh të tjerët për të vepruar në mënyrë të drejtë është thelbi i drejtimit të ndershëm.

Të menduarit ngadalë, drejtimi i ndeshëm dhe mashtrimi dhe korrupsioni.

Çfarë është një shembull i mirë? Çfarë është 'thjeshtë'? Këto janë pyetje themelore – do të thosha ekzistenciale – të jetës sonë të përditshme, profesionale dhe personale. Përgjigja e këtyre pyetjeve mund të gjendet në balancimin e dijes, pasionit dhe karakterit. Për shembull, nëse unë kam 'një ndjenjë të keqe' për disa deklarime kostosh të caktuara apo një qëndrim të caktuar për një praktikë të vendosur në organizatën time, unë do të kaloja në të menduarit ngadalë. Duke bërë kështu unë mund të reflektoj mbi të dhënat dhe rregullat, shqetësimet dhe ndjesitë lidhur me këtë çështje dhe principet etike, të cilat unë dhe pa dyshim të tjerët mbështesim. Ky ushtrim i njohur demonstron se si drejtimi i ndershëm mund të jetë një përgjigje kundër korrupsionit dhe të parandalojë mashtrimin. Qasja e drejtuesit nuk është 'Si ata duhet të sillen?', por 'Çfarë sjellje kam unë?'

Ky kontribut bazohet në librin Alex Brenninkmeijer, të publikuar në Janar të 2019 në Holandë. Ai analizon drejtimin e ndershëm dhe e aplikon këtë analizë në politikë, gjyqësor, vendimmarrje dhe në media. Libri i tij nuk flet për liderët e ndershëm në vetvete por për zhvillimin e një drejtimi të ndershëm si në jetën profesionale, ashtu edhe në atë personale. Teza e tij kryesore është qe çdokush mund të zhvillojë drejtimin e ndershëm, duke kaluar nga të menduarit e shpejt në të menduarit ngadalë dhe duke balancuar tre aspektet themelore të ekzistencës sonë, dijen, pasionin dhe karakterin; racionalitetin, emocionet dhe principet etike.

Përktheu: Aldo Kita

Përgjegjës i Sektorit IT

Nga: Alex Brenninkmeijer, Anëtar i ECA

Publikuar në revistën e ECA, Nr.2,

NDRYSHIMI I KËNDVËSHTRIMIT: NGA LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT NË NDËRTIMIN E INTEGRITETIT

Sado e mirë të jetë lufta kundër korrupsionit, vetë termi shpesh krijon një konotacion negativ: pra ka diçka të" keqe" që duhet të zhduket, ose të paktën të mbahet në nivel sa më të vogël që të jetë e mundur.

Nga: Ina de Haan, Gjykata Hollandeze e Auditimit

Publikuar në revistën e ECA, Nr.2, 2019

Into-SAINT

Sado e mirë të jetë lufta kundër korrupsionit, vetë termi shpesh krijon një konotacion negativ: pra ka diçka të" keqe" që duhet të zhduket, ose të paktën të mbahet në nivel sa më të vogël që të jetë e mundur. Publiku pret që audituesit e jashtëm të luajnë një rol të rëndësishëm në mbajtjen e figurës së pastër të qeverisë - por a mund të ofrojë SAI-t këtë? Dhe a e kanë SAI-t të përmbushur pritshmërinë si një organizatë model, duke udhëhequr nëpërmjet shembullit. Ina de Haan, Audituese e Lartë në Algemene Rekenkamer (Gjykata Hollandeze e Auditimit), ka kontribuar në mënyrë aktive në zhvillimin e një mjeti të vetëvlerësimit për integritetin institucional të SAI-ve, të quajtur IntoSAINT. Ajo jep pikëpamjen e saj mbi atë që është IntoSAINT, dhe një numër përshtypjesh nga institucionet e auditimit që kanë punuar me IntoSAINT.

Korrupsioni në sytë e qytetarëve: një histori e komplikuar

Besimi i publikut në qeveri është komoditet i palëvizshëm. Sipas Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), niveli i besimit publik ka rënë në të gjithë botën. Sidoqoftë, ekzistojnë përjashtime, d.m.th. në disa vende rezulton të jetë rritur. Me kalimin e kohës ka pasur ndikime të mëdha në besim, duke treguar që besimi mund të humbasë dhe të rimerret.

Korrupsioni është një shkak kryesor i thyerjes të besimit dhe asnjë shoqëri nuk është pa korrupsion. Lufta kundër korrupsionit është në radarin e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe organizatave të tjera ndërkombëtare dhe është një biznes në rritje për Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ), agjencitë e donatorëve dhe konsulentët. Sidoqoftë, 25 vitet e kaluara me shqetësime dhe përpjekjeve të mëdha për të luftuar korrupsionin nuk e kanë

zhdukur fenomenin. Ka shumë arsye pse ky është rasti. Një arsye është se korrupsioni "i madh" drejtohet nga pushteti politik dhe ushqehet me ekzistencën e ndërtimeve ndërkombëtare komplekse, të përdorura për transferime të paligjshme të parave. Një arsye tjetër është se korrupsioni 'i vogël' zakonisht është i rrënjosur thellësisht në normat dhe rrethanat shoqërore dhe ndonjëherë madje ka kuptim perfekt për "shtete të brishta". Sido që të jetë arsyeja, pyetja është nëse "lufta kundër korrupsionit" është një këndvështrim i efektshëm që ndihmon për të mbajtur korrupsionin larg dhe për të rivendosur besimin në qeverisje.

Kjo pyetje është veçanërisht e rëndësishme kur shikojmë rolin e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI). Publiku pret që audituesit e jashtëm publikë të luajnë një rol të rëndësishëm në mbajtjen "pastër" të qeverisë, por a mundemi ne ta shpërndajmë? Sa herë që ne nuk arrijmë të zbulojmë raste korrupsioni që nxirren në dritë nga entitetet e tjera ose media, ne kemi dështuar në sytë e qytetarëve. Shumica e SAI-ve janë të pafuqishme kur bëhet fjalë për zbulimin dhe ndëshkimin e rasteve të korrupsionit, qofshin ato të "mëdha"apo të "vogla". Në të vërtetë nuk është roli i tyre, i cili është të mbajnë qeverinë transparente dhe të përgjegjshme. Kjo është një histori e ndërlikuar për të cilën publiku duhet të ketë dijeni.

Nevojë për një këndvështrim tjetër

Për të qenë efektiv, dhe për të kontribuar në fitimin e besimit në qeverisje, na duhet një tregim(një këndvështrim) tjetër: një narrativë për ndërtimin e integritetit, me shembuj të mirë, të udhëheqjes frymëzuese. Kjo nevojë është njohur nga INTOSAI dhe Standardi Ndërkombëtar i Institucioneve Supreme të Auditimit, ISSAI 12, na jep udhëzime se si mund të bëhet kjo: SAI-t sjellin ndryshimin në jetën e qytetarëve, duke forcuar integritetin e qeverisë dhe enteve të sektorit publik dhe duke qenë organizata model, që udhëheqin nëpërmjet shembullit. Kjo e kthen narrativën: nga lufta kundër korrupsionit në ndërtimin e integritetit.

Ndërgjegjësimi për integritet

Që nga prezantimi në 2010 në IntoSAINT, mjeti INTOSAI-t për Vetëvlerësimin e Integritetit, ka qenë një shtytës i rëndësishëm në këtë ndërrim të metodave kërkimore.

IntoSAINT është një strukturë *workshop*-i dy-ditore, ku realizohet një seksion kryq i stafit të SAI-t, i ndihmuar nga dy moderatorë të jashtëm, të cilët analizojnë pikat e forta dhe të dobëta të integritetit të organizatës. Rezultati është një raport me rekomandime nga stafi i vetë SAI-ve për të forcuar politikën e integritetit institucional. IntoSAINT është projektuar të ketë një ndikim të dyfishtë, kur aplikohet:

- Boshti që drejton në këtë rast mjetin është një grup i dy pyetësorëve që siguron bazën për një vlerësim të plotë të riskut të integritetit, i plotësuar nga një pyetësor që siguron njohuri mbi pjekurinë e kontrolleve të integritetit. Kjo i lejon organizatës të mendojë në

lidhje me riskun e integritetit dhe të forcojë kontrollet e brendshme;

- aplikimi i mjetit përmes një *workshop*-i me punonjësit ngre ndërgjegjësimin për riskun e integritetit dhe dilemat etike në punën e tyre dhe, më e rëndësishmja, punonjësit fillojnë të kuptojnë se integriteti nuk është vetëm një karakteristikë personale, por një përgjegjësi e ndarë nga e gjithë organizata.

Dy objektiva kryesore të IntoSAINT

Qëllimi i përfshirjes së IntoSAINT në komunitetin INTOSAI është arritja e dy objektivave. Me aplikimin e IntoSAINT brenda SAI-ve, SAI fillon zbatimin e ISSAI 30 dhe në të njëjtën kohë njihet me qasjen e integritetit. Kjo e bën SAI-n të gatshëm për të udhëhequr nëpërmjet shembullit në hapin e dytë: implementimi i qasjes së integritetit në sektorin publik dhe punës së tij të auditimit.

Pjesmarrës në *workshop*-in e IntoSAINT

Burimi: Rekenkamer Curacao

Reagimet e SAI-ve ndaj përvojës IntoSAINT

Disa SAI kanë ndarë përshtypjet se çfarë workshop i IntoSAINT u ka sjellë atyre, si edhe disa rezultate paraprake; (shiko tekstin më poshtë).

Integriteti brenda SAI-ve

SAI i Meksikës (ASF)

Në SAI-n e Meksikës, *workshop*-i IntoSAINT çoi në krijimin e një Politike Integriteti, e cila përfshin një Kod të Etikës, një Kod të Sjelljes dhe një Udhëzim për Parandalimin e Konflikteve të Interesave. Për më tepër, u krijua një komitet i integritetit dhe një mekanizëm zyrtar për t'u marrë me shkeljet e integritetit. Është emëruar një koordinator i integritetit, i cili është i ngarkuar të kujdeset për zbatimin e Politikës së Integritetit.

"Ndikimi më i dukshëm i IntoSAINT është ndërgjegjësimi për çështjet e integritetit nga stafi. Pasi mjeti u aplikua në SAI-n e Meksikës në vitin 2012, personeli filloi të mendojë për qasjen e re të integritetit të mbështetur nga metodologjia IntoSAINT. Punonjësit dinin për dilemat etike me të cilat përballeshin në punën e tyre të përditshme, por ky ushtrim mendor nuk kishte qenë kurrë i vetëdijshëm për ta. Kjo analizë e vetëdijshme për çështjet e integritetit dhe si të veprojmë siç duhet është një ndryshim i menjëhershëm i sjelljes së stafit, si pasojë e IntoSAINT."

SAI Irakut (FBSA)

Në vitin 2012 dhe 2017, dy *workshop*-et u mbajtën në FBSA në bashkëpunim me Gjykatën e Auditimit të Holandës. Qëllimi ishte të identifikonte pikat e forta në punën e FBSA-së dhe pikat që kishin nevojë për mbështetje dhe përmirësim gjatë kryerjes së detyrave të auditimit në një

mënyrë që rrit marrëdhëniet me palët e interesuara.

Drejtuesit e lartë të FBSA-së kanë një vizion të qartë për rëndësinë e zbatimit të mjetit dhe zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar në lidhje me rezultatet e *workshop-it* dhe zbatimin e tij.

SAI i Marokut (CdC)

IntoSAINT vlerësohet si një mjet strategjik i zhvillimit që mbështet integritetin e CdC dhe stafit të saj. Konsiderohet si një mjet me të cilin, standardet e sjelljes dhe procedurave mund të përgjithësohen midis strukturave dhe subjekteve të CdC-së. Debati mbi çështjet e integritetit zbuloi domosdoshmërinë e krijimit të një sistemi të përhershëm të monitorimit të integritetit në nivelin e *La Cour des Comptes* për të përmbushur me sukses këto objektiva. Përpjekjet për të zbatuar rekomandimet përfshijnë emërimin e një komisioni etik prej gjashtë anëtarësh, duke i besuar atij misionin e këshillimit të Presidentit të Parë për shqetësimet në lidhje me etikën. Komisioni gjithashtu ka për detyrë të promovojë integritetit dhe të kryejë aktivitete trajnuese për gjykatësit e *La Cour des Comptes* dhe stafit administrativ.

Integriteti në sektorin publik

SAI Irakut (FBSA)

Ideja është që të përfitojmë nga ky mjet efektiv për forcimin e integritetit institucional në sektorin publik përmes një qasje parandaluese të bazuar në të kuptuarit e veprimtarisë dhe analizimin e rreziqeve të shkeljes së integritetit, si dhe krijimin e procedurave të nevojshme për menaxhimin e këtyre risqeve. Në përputhje me sa më sipër, FBSA ka përfshirë një objektiv strategjik në planin e saj strategjik (2018-2022) që përqendrohet në "Përmirësimin e Parimeve të Transparencës dhe Integritetit" dhe zhvillon projekte, standarde dhe mjete për të zbatuar këtë objektiv dhe për të matur progresin.

SAI Hungarisë (SAO)

Frymëzuar nga një projekt i Binjakëzimit i BE-së për hartën e rrezikut të korrupsionit me Gjykatën e Auditimit të Holandës në vitin 2008, vizioni i SAI-t hungarez ishte të zhvillonte Projektin e tij të Integritetit: Integritet kundër Korrupsionit. Që nga viti 2009, SAO ka realizuar një studim vjetor të integritetit midis subjekteve të sektorit publik, i modeluar në pyetësorët e përdorur në IntoSAINT. Sondazhi synon të shërbejë si një mjet efektiv për të dhënë reagime ndaj institucioneve publike për ekspozimin e tyre ndaj risqeve që lidhen me korrupsionin dhe vlerësimin e masave të kontrollit të kërkuara për të menaxhuar rreziqet e korrupsionit.

SAI Marokut (CDC)

Një seri seminaresh do të mbahen në nivel kombëtar dhe regjional me temën "Promovimi i Integritetit të Shërbimit Publik".

Frymëzimi nga njëri-tjetrin

SAI Hungarisë (SAO)

SAO organizon Seminare të rregullta ndërgjegjësimi për SAI-t përreth, për t'i

njohur ata me Projektin e Integritetit të SAO-së dhe përdorimin e Anketës së Integritetit.

SAI Marokut (CdC)

Ne kemi pasur mundësinë që të kemi dy nga stafi i CdC të trajnuar për modelimin e IntoSAINT. Këta dy moderatorë nga ana e tyre lehtësuan vetëvlerësimin e integritetit për Institucionet Supreme të Auditimit në Liban dhe Tunizi. Ne po planifikojmë të ftojmë institucionet partnere për bashkëpunim mbi integritetin. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është të zgjerojë fushën e shkëmbimit të përvojave dhe shkëmbimit të praktikave më të mira në promovimin e integritetit midis SAI-ve, dhe kështu të kontribuojë në shpërndarjen dhe forcimin e mëtejshëm të IntoSAINT dhe qasjen e integritetit.

Ndryshimi i këndvështrimit

Thelbësore për suksesin e IntoSAINT është se siguron terren të përbashkët dhe një kornizë të përbashkët për SAI-t në lidhje me integritetin në shumë kontekste dhe kultura të ndryshme. Kjo i lejon ata të mbështesin njëri-tjetrin, të mësojnë nga përvojat e njëri-tjetrit, si në trajnime ashtu edhe në takime dhe përmes përvojës së vlefshme për të qenë një moderator IntoSAINT në një SAI tjetër. Brenda Organizatës Evropiane të Organizatave Supreme të Auditimit (EUROSAI), Task Force për Auditimin dhe Etikën e ka përfshirë këtë në planin e saj të punës. Kështu mund të fillojnë SAI-t dhe në të vërtetë kanë filluar të ndryshojnë këndvështrimin: nga lufta kundër korrupsionit tek ndërtimi integritetit. IntoSAINT i ndihmon ata të frymëzojnë njëri-tjetrin me shembuj të mirë, udhëheqje frymëzuese dhe shpresë, duke sjellë kështu një ndryshim në jetën e qytetarëve, duke forcuar integritetin e qeverisë dhe enteve të sektorit publik dhe duke qenë një organizatë model që udhëheq nëpërmjet shembullit.

Përktheu: Erieta Këlliçi, Audituese

Departamenti i Auditimit të Performancës

Nga: Ina de Haan, Gjykata Hollandeze e Auditimit

Publikuar në revistën e ECA, Nr.2, 2019

MASHTRIMI DHE KORRUPSIONI NË BE: STUDIMI I KATËR RASTEVE TË FUNDIT

Ka shumë arsye për të qenë të vendosur në luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit. Ato minojnë demokracinë dhe sjellin dëme ekonomike – që variojnë nga 179 në 990 miliardë euro në vit për Europën vet.

Nga: Camilla Barlying, Drejtoria e Presidencës, ECA

Publikuar në revistën e ECA, Nr.2, 2019

Mashtrimi është jo vetëm një çështje e qeverive. Marrë si shembuj rastet e fundit, Camilla Barlyng, e cila ka studiuar mbi çështjet e lidhura me mashtrimin dhe që aktualisht po ndjek një trajnim në ECA, ka shqyrtuar fenomenin e mashtrimit në sektorin privat në Europë. Rastet e përzgjedhura përfaqësojnë forma të ndryshme të mashtrimit dhe përfshijnë aktorë të ndryshëm politikë, financiarë përgjatë kontinentit.

Ka shumë arsye për të qenë të vendosur në luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit. Ato minojnë demokracinë dhe sjellin dëme ekonomike – që variojnë nga 179 në 990 miliardë euro në vit për Europën vet. Por, përpos kësaj, çka është me e keqja konsiston në atë se mashtrimi cënon besimin publik. Mekanizma të fortë mbikëqyrjeje janë arma kryesore e qeverisë kundër mashtrimit, por shpesh, dobësitë në këto mekanizma mund të jenë shkaku vet i mashtrimit.

Zbulimi dhe ndëshkimi i këtyre keq-bërjeve nuk është një detyrë e lehtë sepse çdo masë që mund të merret për të parandaluar apo luftuar aktivitete të tilla mund të shfaqë mangësi. Sikur të mos mjaftonte kjo, globalizimi e përkeqëson situatën për shkak të problemeve ndërkufitare.

Mashtrimi nuk është vetëm çështje e qeverive dhe sektorit publik. Por, ndikon në një sërë industrish, vjen në forma të ndryshme dhe mund të përfshijë aktorë të ndryshëm. Më poshtë, jam fokusuar në katër raste të ndryshme, të njohura në opinionin publik, për shkak të peshës, karakteristikave, pasojave politike dhe ndikimeve të drejtpërdrejta që kanë pasur në jetët e qytetarëve.

RASTI 1: DANSKE BANK DHE NORDEA

Sipas *Transparency International*, Danimarka është një nga të vendet më pak të korruptuara në botë. Ka fituar njohje ndërkombëtare për qeverisjen e mirë,

ekonominë e shëndetshme dhe standardet e larta të jetës. Anketat tregojnë se danezët janë në mesin e njerëzve më të lumtur në botë, diçka që ekspertët ia atribuojnë një përbërësi "sekret": besimit. Për këto arsye, Danimarka është shteti që s'të bie ndërmend kur flet për mashtrimin. Megjithatë, vendi është ndeshur me skandale të shumta të pastrimit të parave brenda sistemit bankar në vitet e fundit, çka sugjeron një dobësi në mekanizmat danezë të monitorimit.

Qysh prej 2015, dy banka të mëdha skandinave, Danske Bank dhe Nordea, janë përmendur në lidhje me disa hetime ndërkombëtare dhe kombëtare mbi transaksione të paligjshme. Supozohej se bankat ishin përfshirë në skema të pastrimit të parave që sistematikisht dukeshin pagesa të dyshimta në disa degë daneze dhe estoniane. Njohja me klientin ishte një çështje e rëndësishme.

Në këtë kohë, rreth 200 miliardë euro në pagesa kishin rrjedhur përmes degës së Danske Bank në Estoni, mes vitit 2007 dhe 2015. Në rastin e Nordea, Financial Times vlerësoi se rreth 700 milionë euro të dyshimta kishin kaluar nga Rusia dhe ish-shtetet sovjetike përmes kësaj banke gjatë viteve 2005-2007.

Një nga problemet kryesore: cili ishte përgjegjës për mbikëqyrjen e jashtme. Meqenëse Danske Bank është daneze, aktivitetet e dyshimta ndodhën në degën estoniane dhe ky vend ndryshon shumë nga ai danez. Kështu që, nuk ishte e qartë si për autoritetet mbikëqyrëse daneze dhe ato estoniane se cili duhej të raportonte për aktivitete të dyshimta tek agjencitë përkatëse ligj-zbatuese. Natyra përtej kufitare e rastit e kufizoi bashkëpunimin dhe çorientoi mekanizmat mbikëqyrës, të cilat e zbehën çështjen se kush duhej të mbante përgjegjësi.

Një logjikë e njëjtë vlen edhe për rastin Nordea, e cila bën biznes në Danimarkë, Suedi dhe Finlandë. Sfidat për mbikëqyrjen përtej kufirit kombëtar u bën shqetësuese kur Nordea u riorganizua nga një strukturë varësie në një strukturë me degëzime, ku fill pas së cilit zhvendosi selinë qendrore nga Suedia në Finlandë, një vend ky anëtar i Unionin Bankar Europian, qysh prej 2018. Problemi kryesor në këto situata është se pastruesve të parave u duhen vetëm pak sekonda për të përfunduar transaksionet përmes bankave në shumë vende, ndërkohë që organeve ligj-zbatuese u duhen vite apo dekada për të zbuluar rrjedhën e parave.

Si reagim ndaj këtyre skandaleve, ligjvënësit danezë së fundmi kanë përforcuar luftën kundër krimit financiar, duke u dhënë autoriteteve financiare mbikëqyrëse daneze "FSA" më shumë burime. Danske Bank dhe Nordea kanë krijuar mosbesim tek klientët dhe investitorët. Aksionet e tyre kanë rënë ndjeshëm dhe klientët janë larguar.

RASTI 2: OPERACIONI MARQUES

Në 2014, Portugalia u trondit nga një skemë ndërkombëtare e përvetësimit të parave, evazioni fiskal dhe financime ilegale të fushatave që përfshinte aktorë nga të gjithë shtresat e shoqërisë, kryesisht në Portugali dhe Brazil. Skema përfshinte

zyrtarë të larë, deri në nivelet më të lartë të qeverisë, të cilët u jepnin kompanive të ndërtimit tendera ose shisnin e blinin kompani shtetërore telekomunikacioni. Një institucion i madh financiar portugez qarkullonte dhe pastronte para nga Portugalia në Brazil, e cila si pasojë çoi në falimentimin e bankës në fjalë, Banco Espirito Santo (BES). Me miliona klientë u lanë pa asnjë kacidhe dhe shprehja popullore ndiq paratë i çoi hetuesit europianë në vendet e Amerikës Latine dhe të Afrikës.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i skandalit ishte fakti se ndodhi në kontekstin e krizës ekonomike portugeze. Në praktikë është gjerësisht e njohur se kishte dështime të mëdha në menaxhim dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare, për të përfunduar me një sistem drejtësie të mefshtë, të kushtueshëm dhe të paparashikueshëm. Si reagim ndaj krizës, Portugalia ndërmori një sërë reformash në sistemin e drejtësisë dhe në bankën qendrore. Megjithatë, këto masa nuk parandaluan kolapsin e një sërë bankash në 2014 dhe 2015 dhe as nuk reduktuan me efektivitet mangësitë ligjore dhe ato në sistemin e drejtësisë.

Përmbledhtazi, efektet sociale dhe ekonomike që derivuan nga skandali kanë qenë të mëdha, veçanërisht në pasojat financiare që solli për aksionerët privatë. Kolapsi i BES vlerësohet se i ka kushtuar shtetit portugez rreth 5 miliardë euro dhe kostot vazhdojnë të rriten.

RASTI 3: SKANDALI I EVAZIONIT FISKAL DHE DIVIDENTI

A janë personat që gjejnë boshllëqe në kuadrin rregullator, kriminelë apo finokë që nuk u intereson shumë mbi përgjegjësinë sociale? Kjo është një nga pyetjet kryesore që trazon hetuesit në atë që u konsiderua si vjedhja më e madhe me taksa në historinë europiane.

Skema e rimbursimit të taksave përfshiu persona privatë, banka, agjenci kontabiliteti dhe studio ligjore përgjatë BE-së dhe SHBA-së. Qëllimi i skemës ishte që t'i gënjenin qeveritë që të mendonin se një aksion kishte shumë pronarë në ditën e shpërndarjes së dividentit, të cilët të gjithë zotëronin nga një divident dhe një lehtësi fiskale. Kështu, duke shfrytëzuar intepretimin e kodit fiskal, shumë persona kishin mundësi të pretendonin pronësinë më disa aksione dhe të drejtën e një kompensimi fiskal. Një element kyç në këto aktivitete mashtrimi ishte se personat e përfshirë shfrytëzuan boshllëqet apo shtigje ligjore në vendet përtej kufirit si dhe mangësitë në sistemin e shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit midis autoriteteve të vendeve të BE-së në fushën e krimit ekonomik. Ndërkohë që qeveria gjermane raportohej se kishte qenë në dijeni mbi skemat arbitrare të tregtimit të dividentit për vite me rrallë, ajo informoi vendet anëtare në 2015. Ngjashëm, autoritetet tatimore daneze dështuan që të vepronin mbi një sërë paralajmërimesh se skemat e kompensimit të taksave po keqpërdoreshin.

Një problem kryesor që shfaqet këtu është se ligjet e taksave janë bërë mjaft komplekse. Në 2016, Correctiv, një grup jofitimprurës i gazetarisë investigative,

filloi të mblidhte prova dhe të zbulonte rebusin e mashtrimit me taksa. Që prej kësaj kohe, qeveritë e vendeve anëtare kanë filluar të nisin hetime mbi praktikat e rimbursimit të taksave. Problemi është se shumë nga personat përgjegjës fshihen në vende të treta jashtë BE-së. Ndërkohë, një tjetër evazion fiskal, i njohur si 'përvetësimi i dividentit', u mori qeverive shuma të tjera parash. Vlerësohet se këto skema mashtrimi u kanë kushtuar taksapaguesve europiane rreth 55 miliardë euro.

RASTI 4: DIESELGATE

Në shtator 2015, Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të SHBA-së (EPA) zbuloi se kompania e madhe gjermane e makinave, Wolkswagen (VW) kishte manipuluar qëllimisht testet e emetimit të benzinës në rreth 11 milionë makina në të gjithë botën, nga këto 500,000 vetëm në SHBA. Për vite me radhë, VW kishte instaluar një program ilegal në modelin e makinave për t'i bërë makinat që të performonin më mirë gjatë testit sesa lëvizjes së tyre në rrugë. Pa këtë pajisje, motorët emetonin ndotës si oksidin e nitrogjenit në masën 40 herë më të lartë sesa ishte e ligjshme në SHBA. Duke vepruar kështu, VW kishte përfituar para në kurriz të mjedisit dhe shëndetit publik në SHBA.

Në vitin 2018, VW pranoi të paguante rreth 1 miliardë euro gjobë në Gjermani dhe në Holandë, pasi kishte përfituara avantazhe të padrejta.

Vështrimi drejt së ardhmes

Mashtrimi mbetet një problem në sektorin privat, siç u ilustrua me shembujt e mësipërm. Rastet e përzgjedhura janë interesante për shkak se tregojnë se institucionet financiare dhe bankare duken të jenë më të prirura. Në fund të fundit, mashtrimi është një krim i 'kollarave të bardha'. Së fundmi, globalizimi luan një rol, pasi mangësitë dhe dallimet mes vendeve i rrisin mundësitë për mashtruesit. Një shqetësim i përgjithshëm është se krimi nuk ndalon tek kufijtë ndërsa rregullimet, auditimi dhe hetimi janë të kufizuara brenda kufijve kombëtare dhe brenda kornizave ligjore dhe rregulluese kombëtare.

Megjithëse mekanizmat e ngritur për të zbuluar dhe parandaluar krimet ekonomike mund të mos jenë të mjaftueshme, rastet tregojnë se të paktën ato janë funksionale deri diku. Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar është e nevojshme për të forcuar luftën kundër krimit dhe korrupsionit.

Përktheu: Redi Ametllari, Auditues

Departamenti i Auditimit të Performancës

Nga: Camilla Barlying, Drejtoria e Presidencës, ECA

Publikuar në revistën e ECA, Nr.2, 2019

Info Kontrolli i Lartë i Shtetit

AKTIVITETE TË KLSH-së PËR PERIUDHËN JANAR - PRILL 2019

Takim i Kryetari të KLSH-së, z.Bujar Leskaj me stafin e institucionit në përfundim të mandatit të tij

Në datën 8 janar 2019, Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj në përfundim të mandatit të tij shtatë vjeçar në krye të institucionit organizoi në sallën Lech Kaczynski të Kontrollit të Lartë të Shtetit një takim me stafin e KLSH-së.

Zoti Leskaj falënderoi fillimisht drejtuesit dhe audituesit e KLSH-së për punën e përbashkët të realizuar në këto shtatë vjet, duke nënvizuar se *" ne kemi pasur si busull orientuese mandatin tonë kushtetues të sanksionuar në Nenet 161-165 të Kushtetutës së Shqipërisë, por edhe standardet tona ndërkombëtare të auditimit ISSAI, të cilat të japin siguri të mos gabosh kurrë në elementet thelbësore të pavarësisë dhe cilësisë së punës sonë audituese".*

Zoti Leskaj bëri një bilanc të punës 7 vjeçare të institucionit, duku iu referuar platformës strategjike për zhvillimin e KLSH-së që paraqiti përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë në 14 Dhjetor 2011, në cilësinë e kandidatit të nominuar nga Presidenti i Republikës për pozicionin e Kryetarit të KLSH-së dhe bëri analizën e tetë objektivave kryesore, si respektimi rigoroz i standardeve ndërkombëtare të auditimit; kthimi i vëmendjes tek auditimi i performancës, krahas rritjes se eficiencës së auditimit financiar; realizimi i sinergjizimit të politikave dhe veprimeve me organet e tjera shtetërore të kontrollit, luftës dhe parandalimit të korrupsionit;

intensifikimi i konsultimeve me Komisionin për Ekonominë dhe Financa për përafrimet strategjike të KLSH 2012-2018; intensifikimi i bashkëpunimit me ekspertët universitarë dhe akademike të auditimit të financave publike, si dhe me organizatat profesionale të fushës; intensifikimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare INTOSAI dhe EUROSAI, me institucionet e larta të auditimit të vendeve të BE-së, të vendeve të rajonit dhe në veçanti me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës si dhe përmirësimi i transparencës në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me median dhe me organizatat jo-fitimprurëse që luftojnë korrupsionin.

Konstatohet me kënaqësi që të gjitha këto objektiva janë realizuar:

- pas shtatë vitesh, institucioni ka një vizion të mirë-përcaktuar se ku dëshiron të arrijë në një vit, tre vjet apo dhe në pesë vitet e ardhshme. Me kapacitetet e tij, ai përgatiti Strategjinë e re të Zhvillimit të KLSH-së 2018-2022, e cila u përgjigjet kërkesave të ISSAI-ve dhe është mbështetur në udhëzuesit metodologjikë të publikuar për këtë qëllim nga organizatat ndërkombëtare profesionale dhe Nisma për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI).
- lufta kundër korrupsionit dhe abuzimit me pronën shtetërore si një qëllim madhor për përmirësimin e qeverisjes publike. Për periudhën janar 2012-tetor 2018, KLSH ka dërguar pranë organit të Prokurorisë 300 kallëzime penale për 953 nëpunës dhe ish-nëpunës të administratës shtetërore. KLSH në 7 vitet e fundit, 2012-2018, ka adresuar çdo javë një Kallëzim Penal, për zyrtarët e nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë, të konstatuar me shkelje të rënda nga auditimet e KLSH, apo e shprehur ndryshe 1 kallëzim për çdo 3 auditime.
- Treguesi i realizimi të auditimeve në harkun kohor të viteve 2012-2018 rezulton në 1095 auditime;
- Dëmi i zbuluar për periudhën 2012-2018 arrin vlerën 2,689 miliardë euro.
- Auditimet e performancës janë parë si një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së. Një filozofi pune që konsideron se auditimi nuk është një qëllim në vetvete, por në radhë të parë një instrument parandalimi, instrument korrigjimi dhe këshillimi për institucionin që auditohet. Gjatë vitit 2017, janë realizuar 15 auditime performance në reformat qeveritare, në aspekte të rëndësishme të financave publike, në sistemin e prokurimit publik, sistemin arsimor, projektet mjedisore, si dhe në shërbimet publike.
- Në funksion të objektivit të institucionit, për të bërë pjesë të praktikave të tij audituese dhe Auditimet e Teknologjisë së Informacionit, gjatë vitit 2015 u krijua Drejtoria e Auditimit të TI-së si pjesë e Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.
- Gjatë viteve 2012-2018 jemi përpjekur të krijojmë sinergji për mirëqeverisjen,

duke bashkëpunuar në sistem me institucionet e tjera shtetërore. Në vitet 2012-2018, KLSH ka nënshkruar 57 marrëveshje bashkëpunimi, nga të cilat 30 me OJF, 17 me institucione homologe dhe të tjera me institucione shtetërore dhe universitete publike. Bashkëpunimet me Profesoratin e Universiteteve dhe Organizatat Profesionale të fushës gjatë këtyre viteve, ka maksimizuar kontributin e tyre në Revistën Shkencore të KLSH-së, Konferencat Shkencore, trajnimet, rekrutimin e stafit, pjesëmarrjen e ekspertëve të shoqërisë civile në auditimet e KLSH, rishikimet mes kolegëve për të vlerësuar performancën e KLSH, etj.

– Gjatë periudhës 2012-2018, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka nënshkruar 17 marrëveshje bashkëpunimi me SAI-t homologe të: Austrisë, Polonisë, Kroacisë, Sllovenisë,Turqisë, Kosovës, Bullgarisë, Çekisë, Malit të Zi, Bosnje Hercegovinës, Maqedonisë, Kuvajtit, Hungarisë, Qipros, Moldavisë, Ukrainës dhe Rumanisë, duke plotësuar hartën rajonale të partneritetit me thuajse të gjitha SAI-et e vendeve të rajonit, ku natyrisht e para është ajo me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës. Këto marrëveshje partneriteti janë konkretizuar në fusha të tilla si, shkëmbimi i informacionit, trajnime, veprimtari të përbashkëta audituese rajonale, etj.

Duke vlerësuar misionin e tij si agjent i publikut dhe i Kuvendit, për përdorimin me ekonomicitet efektivitet dhe eficiencë të burimeve dhe fondeve publike, KLSH në shtatë vitet e fundit, ka synuar forcimin e besimit të qytetarit dhe publikut në tërësi, nëpërmjet njohjes më nga afër të veprimtarisë së tij, auditimeve dhe rezultateve të tyre, si dhe partneritetet që ka krijuar brenda dhe jashtë vendit për të përmirësuar qeverisjen publike, duke u përpjekur të luftojë në thellësi korrupsionin.

Mbështetur në moton e Kongresit të IX-të të EUROSAI-t, zhvilluar në Holandë, “Kur është hera e fundit që ke bërë diçka për herë të parë?”, zoti Leskaj evidentoi 10 risitë e KLSH-së në vitet 2012-2018, të cilat më parë as nuk ravijëzoheshin, ndërsa tani janë bërë të prekshme për të gjithë :

- Ligji i Ri i KLSH-së
- Auditimet e Performancës
- Auditimet IT
- Kallëzimet penale
- Botimet e KLSH-së

- Revista Kërkimore-Shkencore "Auditimi Publik"
- Muaji i Hapur
- Konferencat Shkencore Vjetore të KLSH-së
- Bashkëpunimi me OJF-të
- Godina e re e KLSH-së dhe Muzeu i KLSH

Kryetari i KLSH-së, z.Leskaj informoi audituesit e KLSH-së për Vendimin e delegimit të kompetencave të Kryetarit tek Zv/Kryetari i KLSH, znj. Lindita Milo, duke filluar nga data 8 janar 2019, pas botimit në Fletoren Zyrtare të RSH me nr.193, të Vendimit të Kryetarit të KLSH me nr. 244, datë 22.12.2018, sipas të cilit delegohet ushtrimi i detyrës dhe përgjegjësive shtetërore të titullarit të institucionit përgjatë fazës kalimtare e tranzitore nga përfundimi i mandatit kushtetues të Kryetarit të KLSH (datë 23 dhjetor 2018) deri në emërimin nga ana e Kuvendit të Shqipërisë të Kryetarit të ri të KLSH-së, tek Zv/Kryetari i KLSH, znj. Lindita Milo (Lati).

Zoti Leskaj duke i uruar suksese zj.Milo bëri edhe një përmbledhje të CV së saj, e cila ka përfunduar studimet universitare në profilin Financë- kontabilitet, mban titullin shkencor "Profesor" si dhe gradën shkencore "Doktor" në Kontabilitet (1996) nga Universiteti i Tiranës dhe Ph.D. në Ekonomiks (2001) nga "Staffordshire University", Britania e Madhe.

Në vitet 2006-2016, zj.Milo ka qenë Kryetare e Autoritetit Shqiptar të Konkurencës, që nga viti 1990 e në vijim Lektore pranë Departamentit të Kontabilitet, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tiranës. Zonja Milo në vitet 2004-2010 ka qenë anëtare e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, Bashkëpunëtore e jashtme e IEKA që në vitet e para të themelimit të profesionit të auditimit të jashtëm. Autore e disa teksteve, monografive, artikujve dhe punimeve të tjera shkencore në fushën e kontabilitetit, konkurencës, auditimit, etj.

Kryetari i KLSH-së e përmbylli fjalën e tij *...."Ky rrugëtim i yni, shtatë vite pas nisjes, duket tani më i sigurt dhe më i qartë në detyra, objektiva të vëna e plane zbatimi. Kjo qartësi e siguri është në radhë të parë fryt i punës suaj të ndershme e profesionale, për të cilën ju falenderoj!"*

Mbi bazën e treguesve të plotësuar të performancës së një SAI, eksperiencës së fituar, besimit në vlerën e parimeve që mbrojmë dhe misionit qe kryejmë, të sigurtë në ndihmën dhe mbështetjen e Kuvendit, të Institucioneve të tjera publike dhe të shoqërisë civile e qytetarëve, të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t si dhe SAI-ve partnere, duke e parë me besim të plotë punën audituese në të ardhmen".

Zhvillohen analizat e punës së Departamenteve të Auditimit dhe të strukturave mbështetëse në KLSH për vitin 2018

Në datën 24 Janar 2019, në sallën "Gene Dodaro", në Kontrollin e Lartë të Shtetit, Departamenti Metodologjisë, Standarteve dhe Sigurimit të Cilësisë zhvilloi Analizën e Veprimtarisë për vitin 2018, duke shënuar hapjen e këtij aktiviteti në nivel Institucional.

Departamenti Metodologjisë, Standarteve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit në

KLSH përcjell dhe siguron koordinimin dhe kombinimin më të mirë të funksioneve për zhvillimin institucional duke vendosur në një lidhje të ndërsjellë të tre elementëve të ndërtimit të kapaciteteve dhe progresit të qëndrueshëm:

- Standardet dhe Metodologjitë si themeli mbi të cilin ngrihet dhe zhvillohet veprimtaria audituese;
- Trajnimi dhe Edukimi Profesional - si instrument për transmetimin dhe ndarjen e njohurive mbi Standardet dhe Metodologjitë;
- Sigurimi i Cilësisë -si vlerësues dhe monitorues i performancës, zbatimit të Standardeve dhe impaktit të zhvillimit professional.

Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit dhe Drejtoria e Standarteve dhe Sigurimit si struktura funksionale të këtij Departamenti ofrojnë siguri për aplikimin e kërkesave të cilësuara në ISSAI 40 sipas të cilit ..” *SAI duhet të ofrojë një shërbim ekselent dhe cilësor. Si pjesë e menaxhimit të cilësisë..SAI duhet të vendosë politika, procedura të hartuara për t’i dhënë siguri të arsyeshme se ka burime të mjaftueshme me kompetencën, aftësitë dhe angazhimin ndaj parimeve të etikës të nevojshme për:*

I. Kryerjen e punës në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi;

II. T’i mundësuar SAI-t të përgatisë raporte që janë të përshtatshme për rrethanat.

Mbi këtë bazë, veprimtaria e Departamentit për vitin 2018 u zhvillua nën këndvështrimin analitik të elementëve të një Analize SWOT, duke vlerësuar arritjet dhe njohur fuqitë tona, duke identifikuar dobësitë e shfaqura gjatë punës, si dhe duke fokusuar vëmendjen në mundësitë që ofron zhvillimi por vlerësuar njëkohësisht dhe kërcënimet e risqet.

Analiza npërmjet PMF do të shërbejë për të kontribuar në përmirësimin e kapaciteteve të KLSH-së, përmes matjes së performancës dhe identifikimit të mundësive për të forcuar dhe monitoruar performancën e SAI-t.

Politika e zhvillimit profesional në KLSH ka vlerësuar nevojën për krijimin e vlerave të qëndrueshme, duke aplikuar një proces sistematik të mësimit profesional dhe etik duke inkurajuar dhe mbështetur një ambient zhvillimi të vazhdueshëm dhe fleksibël, të aftë për t’u përballur me situata të ndryshme,sfidat dhe rreziqet e kohës.

Implementimi i suksesshëm i Programit të Zhvillimit Profesional të Stafit te KLSH për vitin 2018, sipas synimeve të projektuara në kërkesat e Vendimit të Kryetarit të KLSH nr.230, datë 31.12.2017, mundësoi që çdo auditues në KLSH përgjatë kësaj periudhe të arrijë objektivat dhe realizojë indikatorët themelorë që nxisin forcimin e kapaciteteve profesionale përmes trajnimit.

Gjatë vitit 2018, karakteristikë është se janë alternuar në mënyrë të harmonishme të dy opsionet e mundshme, sipas vendit të kryerjes së seancave të konsolidimit të njohurive:

- Seminare dhe trajnime të zhvilluara në institucionin e KLSH-së me lektorë vendas dhe të huaj;
- Seminare dhe trajnime të zhvilluara në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë pranë SAI-ve dhe Gjykatave të Auditimit.

Në fund të vitit 2018, audituesit e KLSH kishin siguruar një mesatare prej 29 ditë trajnimi/ auditues, duke shënjestruar nivelin më të lartë të këtij treguesi përgjatë gjithë zhvillimit të këtij institucioni ndër vite, që nga krijimi i tij. Kualifikimet janë orientuar drejt njohjes së thelluar dhe zbatimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Kuadrit të Praktikave Profesionale Ndërkombëtare të Auditimit Publik, duke i konsideruar si avantazh krahasues në rritjen e cilësisë së angazhimeve vijuese.

Një sfidë e madhe me të cilën përballen të gjitha SAI-et është ofrimi i vazhdueshëm i auditimeve me cilësi të lartë, e cila ndikon në reputacionin dhe besueshmërinë e tyre si dhe aftësinë e tyre për të përmbushur me sukses mandatin.

Detyrë parësore e Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë është kryerja e kontrolleve në të nxehtë të dosjeve të auditimit përpara evadimit të tyre. Kështu është bërë mundur shqyrtimi dhe dhënia e mendimeve për rreth 150 dosje të auditimeve, në disa raste edhe nga dy herë për të verifikuar reflektimin e vërejtjeve dhe sugjerimeve për Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt-vendimin. Duhet theksuar se në vitin 2018, në aspektin e kuadrit rregullativ u kërkua konsolidimi i plotë i zbatimit të Rregullores së Procedurave të Auditimit, i cili duhet konsideruar si një nga fuqitë (Strengths), me ndikim në përmirësimin e cilësisë së auditimit. Por është konstatuar se zbatimi i plotë i kësaj Rregulloreje ka hasur në disa vështirësi, të cilat janë evidentuar gjatë praktikës së punës sonë dhe në mënyrë më të detajuar do të jepen në raportin për kontrollin e cilësisë në të ftohtë të dosjeve të auditimit të vitit 2018.

Që një sistem i kontrollit të cilësisë të jetë efektiv, ai duhet të jetë pjesë e strategjisë, kulturës, politikave, procedurave të përcaktuara për veprimtarinë audituese. Pikërisht, parimi bazë që përcaktohet në ISSAI 40 - Kontrolli i Cilësisë së SAI-ve është: *"Institucioni duhet të hartojë një proces monitorimi që i jep atij siguri të mjaftueshme që politikat dhe procedurat në lidhje me sistemin e kontrollit të cilësisë janë të duhurat, të rëndësishme dhe operojnë në mënyrë efektive."*

Krahas këtyre, kontrolli dhe sigurimi i cilësisë së auditimit i shërben KLSH për të evidentuar mangësitë dhe marrjen e masave efektive për përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë audituese, si një nga sfidat kryesore të aktivitetit në të ardhmen.

Rezultatet e veprimtarisë audituese në një shkallë të konsiderueshme varen nga zbatimi në kohë dhe sipas standardeve të procedurave të auditimit, të përcaktuara në Rregulloren përkatëse. Nën këndvështrimin të zhvillojmë e përmirësojmë mbi çfarë kemi ndërtuar pozitivisht mbështetur në pikat tona më të forta dhe duke konsideruar mundësitë që ofron e ardhmja, në fund të analizës u përcaktuan edhe objektivat kryesore ku do të mbështetet puna e Departamentit të Metodologjisë, Standarteve dhe Sigurimit të Cilësisë për vitin 2019.

Në datën 25 janar 2019 u zhvillua analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore (DAIQ). Kjo analizë u hartua nën dritën e njohjes dhe vetëvlerësimit të Kornizës së Matjes së Performancës si dhe analizës SWOT me qëllim evidentimin e fuqive, dobësive, shanseve dhe kërcënimeve që prekin punën audituese brenda Departamentit në veçanti por edhe KLSH-së në përgjithësi. Korniza e Matjes së Performancës konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për menaxhimin, matjen, identifikimin dhe raportimin e performancës së aktivitetit të vet, me qëllim përmirësimet e mëtejshme, për arritjen e objektivave e synuara, si më poshtë vijon:

Për vitin 2018 DAIQ, sipas planit vjetor të auditimeve, të miratuar nga Kryetari KLSH kishte të parashikuar për të kryer 29 auditime, të cilat janë realizuar 100%. Konkretisht: në 13 subjekte janë kryer auditime me objekt përputhshmërinë, në 4 subjekte janë kryer auditime me objekte të përzierë financiare dhe përputhshmërie, në 9 subjekte janë kryer auditime me objekt financiare, në 2 subjekte janë kryer auditive tematike dhe në 2 raste është kryer zbatimit i rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2017 dhe 4 mujorit të parë të vitit 2018.

Bazuar në metodologjinë e riskut dhe materialitetit, me këto 29 auditime janë audituar fonde buxhetore në vlerën totale rreth 34,000,000 mijë lekë, kryesisht: fondet për "Pagat e personelit" zënë rreth 13,300,000 mijë lekë ose 40%; fondet për "Mallra dhe shërbime të tjera" zënë 11,900,000 mijë lekë ose 36%; "Fondet për investime" zënë rreth 4,000,000 mijë lekë ose 12% të totalit të fondeve të audituara; etj.

Në këto auditimi, në zbatim të standardeve të auditimit financiar dhe auditimit të përputhshmërisë, janë audituar pasqyrat financiare dhe përputhshmëria e përdorimit të fondeve publike për të cilat janë dhënë sipas rastit, veçmas opinione për auditimet financiare dhe veçmas opinione për auditimet e përputhshmërisë.

Më pas u vunë në dukje problematikat e konstatuara në auditimet financiare dhe të përputhshmërisë, rekomandimet e lëna për përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore, etj.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH dhe objektivat e vitit 2019 mbyllën analizën e këtij Departamenti.

Në datën 25 janar 2019 Departameti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit të Kontrollit të Lartë të Shtetit zhvilloi Analizën e veprimtarisë së vitit 2018. Analiza u zhvillua duke u mbështetur në modelin e vlerësimit të realizimit të objektivave sipas analizës SWOT për arritjen e objektivave strategjik të KLSH 2018-2021, si dhe të objektivave dhe treguesve të planit vjetor 2018 me synimin e rritjes së cilësisë dhe programimit sa më objektiv e premtues të objektivave të vitit 2019. Periudha e veprimtarisë së Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit gjatë vitet 2018 është karakterizuar nga rritja e cilësisë dhe modernizimi i kapaciteteve audituese, tejkalimin i numrit të auditimeve në masën 130%, ka sjellë gjithashtu edhe një standardizim të cilësishëm të programeve të auditimit të mbështetura thellësisht në dy shtyllat kryesore: së pari, në përvetësimin dhe zbatimin cilësor të standardeve të auditimit dhe së dyti në ndjekjen e risqeve të identifikuara më parë, veçanërisht në identifikimin e risqeve të reja gjatë procesit të auditimeve, sintezë dhe produkt ky i forcimit dhe modernizimit të kapaciteteve nga trajnimet, zgjerimi i bashkëpunimit të KLSH me SAI-t e vendeve të Bashkimit Europian, por edhe nga përgjithësimi, shkëmbimi dhe përvetësimi i eksperiencave më të mira brenda vetë stafit të KLSH-së.

Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit për vitin 2018 ka realizuar planin e auditimeve 100%, si dhe ka kryer dhe ka në proces 5 auditime për vitin 2019, duke kryer dhe evaduar 25 auditime, nga këto kemi: 8 auditime në ZVRPP, 7 auditime në ALUIZN-et, 6 auditime në ente mjedisore nga të cilat: (3 auditime ne Drejtori Rajonale Mjedisi, 2 në AKZM dhe AdZM dhe 1 auditim në DR Isnspektoriatit të mjedisit); 1 auditim në AT Pronave Tiranë si dhe 2 auditime Zbatimi i Departamenti ka rekomanduar dhe 6 masa për përmirësim ligjor, ku theksojmë se vetëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Aluizni-t, 4 masa janë reflektuar plotësisht, duke i shoqëruar ato me ndryshime e plotësime ligjore me VKM, ndërsa në ZVRPP kemi rekomanduar, të cilat janë reflektuar në Ligjin e ri të Kadastrës.

Më tej u evidentuan disa shifra, lidhur me auditimet e realizuara si: 510 masa organizative, 53 masa zhdëmtimi dhe 70 masa disiplinore nga të cilat 40 masa “largim nga puna”, 30 masa “vërejte deri në largim nga puna”, janë kallëzuar penalisht 32 punonjës të këtyre institucioneve përfshi edhe drejtuesit e tyre, si dhe në 2 raste është përcjellë materiali për vlerësim nga prokuroria si indice për kallëzim penal.

Së fundmi u diskutua lidhur me Objektivat e vitit 2019 për këtë Departament.

Analizat vijuan me Departamentet e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, duke u bazuar në këto drejtime:

- Statistikat vjetore;
- Analiza SWOT (fuqive/dobësitë/mundësitë/kërcënimet);
- Kërkesat e Instrumentit të matjes së Performancës (PFM).

Pjesëmarrës në këtë analizë, përveç drejtuesve dhe audituesve të departamentit, ishin të pranishëm zv/Kryetar znj. Lindita Milo dhe Drejtori i Përgjithshëm znj. Manjola Naço.

Analiza vjetore filloi me fjalën hyrëse te Drejtorit te Departamentit znj. Yllka Pulashi, e cila vijoi edhe me përmbledhjen e veprimtarisë audituese, duke u përqendruar kryesisht në statistikat vjetore për plotësimin e programit vjetor të auditimit, rezultatet e tyre të shprehura në rekomandime për përmirësime e ndryshime ligjore, masat organizative, ato administrative dhe disiplinore, masat për shpërblimin e dëmit së bashku me vlerën e tyre, rastet dhe numri i kallëzimeve penale. Gjithashtu u paraqit analiza e punës një vjeçare të Departamentit duke u analizuar sipas elementeve të Analizës SWOT (fuqive/dobësitë/mundësitë/ kërcënimet) dhe instrumenteve të Matjes së Performancës.

Gjithashtu znj. Pulashi u ndal edhe në veprimtarinë e audituesve të Departamentit në drejtim të analizës dhe shqyrtimit të kërkesë-ankesave, pjesëmarrje në trajnime, cilësinë e auditimit, prezencën e audituesve në median e shkruar, plani e auditimit për vitin 2019 si dhe objektivat kryesore qe duhet të përmbushen për realizimin e planit dhe të veprimtarisë audituese për vitin 2019.

Në vazhdim fjalën e mori Drejtoresha e Përgjithshme znj. Manjola Naço, e cila ndër të tjera vendosi theksin në objektivat dhe sfidat që na presin në vitin 2019, në veçanti në kryerjen e auditimeve financiare dhe të përputhshmërisë në zbatim të manualeve përkatëse dhe në përgatitjen e letrave të punës sipas manualeve përkatëse, dokumente këto që janë në fazën e konsolidimit. Në fjalën e saj zv/ Kryetare znj. Lindita Milo vuri theksin në kujdesin që duhet të tregojmë në plotësimin e letrave te punës gjatë procesit të auditimit, si dhe ne përmbushjen e objektivave dhe realizimin e auditimeve për vitin 2019 ne frymën e një ekipi të vetëm, duke respektuar rregulloren e Procedurave të Auditimit.

Drejtori i Drejtorisë së Investimeve të Huaja, z. Xhoxhaj në fjalën e tij theksoi angazhimin që duhet të këtë çdo auditues në punën e tij, në veçanti audituesit e rinj të cilët duhet të kombinojnë punën me audituesit më me eksperience, duke qenë nën mbikëqyrjen e këtyre të fundit.

Sipas programit vjetor të auditimit për vitin 2018, Departamenti ka pasur si objektiv realizimin dhe përmbushjen e 29 auditimeve gjithsej, 20 auditime në shoqërive publike dhe 9 auditime të projekteve me financime të huaja. Në fund të vitit rezulton se numri i auditimeve të realizuara dhe të evaduara është 28 auditime gjithsej si dhe është përfunduar puna audituese në terren për tre auditime. Auditimet e evaduara i përkasin këtyre fushave: 17 auditime në shoqëritë dhe entet publike, 5 auditime në fushën e projekteve me financime të huaja, 3 auditime mbi zbatimin e rekomandimeve dhe 2 auditime tematike. Auditimet e kryera gjatë vitit 2018 janë kryesisht auditime përputhshmërie, ligjshmërie dhe rregullshmërie, si dhe auditime financiare. Nga auditimet e kryera 10 janë auditime përputhshmërie, 13 janë auditime ligjshmërie dhe rregullshmërie dhe 3 janë auditime financiare dhe dy tematike.

Për auditimet e ushtruara në vitin 2018 i janë drejtuar organit te akuzës 4 kallëzime penale, për 5 drejtues apo administrator të shoqërive dhe 4 indicie për kallëzim penal.

Gjatë vitit 2018 departamentit i janë bashkuar 8 audites të rinj te cilët përtej trajnimeve te ndjekura, janë angazhuar edhe ne auditime nën mbikëqyrjen e audituesve më me përvojë, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës por edhe përmbushjen me sa më shumë arritje të auditimeve.

Në përfundim, znj. Yllka Pulashi, prezantoi objektivat kryesore të Departamentit për vitin 2019.

Në datën 31 janar 2019, Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë (DKBMJ) zhvilloi analizën vjetore të punës për vitin 2018. Në analizën e kësaj Drejtorie morën pjesë punonjësit e DKBMJ, Zv/Kryetari i KLSH-së, zj.Lindita Milo (Lati); Sekretari i Përgjithshëm, zj.Luljeta Nano dhe Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në KLSH, z.Artur Hasanbelliu.

Një panoramë të përgjithshme të punës së Drejtorisë e bëri zj.Irena Islami, Drejtore e DKBMJ. Zonja Islami iu referua fillimisht implementimit të "Strategjisë së komunikimit të KLSH-së 2017-2019", nëpërmjet monitorimit të implementimit të kësaj strategjie, i cili është realizuar nga DKBMJ në bashkëpunim me departamentet e auditimit. Plani i Veprimit thekson rolin fondamental të KLSH për të përcjellë më fort dhe qartë mesazhet kryesore të auditimeve dhe të propozimeve të KLSH-së për përmirësimin

e administrimit të Buxhetit të Shtetit në mediat tradicionale, në gazetat dhe revistat kryesore dhe u ndal në rezultatet e monitorimit të implementimit të strategjisë së komunikimit për periudhën raportuese sipas objektivave.

Zonja Islami u përqëndrua në botimet e KLSH-së për vitin 2018 dhe në aktivitetet që lidhen me rritjen e transparencës së veprimtarisë audituese. Gjatë vitit 2018, KLSH ka realizuar 17 botime dhe kolona e botimeve të KLSH-së ka arritur në 100 tituj.



Gjatë shtatë viteve të fundit KLSH ka nënshkruar 57 marrëveshje bashkëpunimi, nga të cilat 30 me OJF, 17 me institucione homologe dhe të tjerat me institucione shtetërore dhe Universitete Publike.

Një nga aktivitetet që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e transparencës ka qenë organizimi nga KLSH i Muajit të Hapur për Qytetarët për të tretin vit radhazi, në datat 25 Tetor-14 Dhjetor 2018. Nisur tre vite më parë si një Jave e Hapur për KLSH, në dy vitet e fundit është kthyer në traditën e Muajit të Hapur për qytetaret mbështetur dhe në Strategjinë e Komunikimit të KLSH 2017-2019. Gjatë muajit të hapur u zhvilluan 54 aktivitete të ndryshme. KLSH gjatë vitit 2018 ka forcuar bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë. Me synimin e institucionalizimit të marrëdhënieve të KLSH me Kuvendin e Shqipërisë , Kryetari i KLSH ka miratuar me shkresën nr. 34/39, datë 30.06.2018 "Udhëzuesin për institucionalizimin e marrëdhënieve të KLSH-së me Parlamentin", dokument i cili përbën një platformë udhërrëfyese për sigurimin e vazhdimësisë së marrëdhënieve të mira midis dy institucioneve.

Për një monitorim sa më efektiv të veprimtarisë së institucioneve kushtetuese Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar në janar 2019 Manualin e monitorimit vjetor dhe periodik të këtyre institucioneve. Gjatë vitit 2018, KLSH ka vijuar traditën e mirë të zhvillimit të Konferencave Shkencore. Konferenca VI-të Shkencore e KLSH-së në bashkëpunim me SAI-n e Kuvajtit, u zhvillua në datat 9-11 prill 2018 në Kuvajt. Konferenca kishte si temë kryesore "Auditimi me Bazë Risku". Në datën 14 dhjetor 2018, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) organizuan në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit Konferencën Kombëtare me temë: "Për një autoritet Kombëtar anti-korrupsion të gjithëpranuar dhe mirëvendosur në sistemin e qeverisjes".

Më pas e mori fjalën zj.Alma Shehu, e cila u përqendrua në një nga veprimtaritë kryesore të Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, organizimi i aktiviteteve në bashkëpunim me SAI-t dhe institucionet e tjera homologe, brenda dhe jashtë vendit. 138 nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit, gjatë vitit 2018 morën pjesë në 51 aktivitete të zhvilluara jashtë vendit, si trajnime, workshope, konferenca, grupe

pune të EUROSAI-t dhe INTOSAI-t, internshipe në Gjykatën Europiane të Audituesve dhe fellowship-e në Zyrën e Kontrollorit të Përgjithshëm të GAO-s. Zonja Shehu u shpreh edhe në lidhje me projektin e binjakëzimit, "Forcimi i kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm", i cili u financua nga BE. Gjatë 28 muajve të implementimit të projektit të binjakëzimit janë zhvilluar 99 misione, në të cilat u përfshinë 65 ekspertë polakë, kroatë, holandezë, estonezë dhe portugezë me një numër total 1053 ditë/ njerëz. Në takimet, trajnimet e zhvilluara me ekspertët dhe vizitat studimore u përfshinë rreth 100 drejtues dhe auditues të KLSH dhe për periudhën mars 2016-30 prill 2018 u realizuan 1980 ditë/njerëz (trajnime, misione, auditime pilot, vizita studimore, etj). Në përfundim të diskutimeve, zj.Islami bëri analizën SWOT dhe nga kjo analizë u evidentuan, pikat e forta, pikat e dobëta, oportunitetet dhe kërcënimet. Bazuar në këtë analizë u përcaktuan edhe sfidat për 2019:

Takimin e mbylli zj.Lindita Milo, Zv/Kryetare e KLSH-së, e cila vlerësoi bashkëpunimin e KLSH-së me ECA dhe GAO-n, marrëdhëniet me shoqërinë civile, si edhe konsolidimin e kapaciteteve audituese të institucionit, nëpërmjet vijimit të bashkëpunimit me SAI-t homologe dhe aplikimit për projekte të reja me BE-në, USAID, PNUD, etj.

Në datën 4 shkurt 2019 u zhvillua analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së së Informacionit (DATI). Kjo analizë u hartua nën dritën e njohjes dhe vetëvlerësimit të Kornizës së Matjes së Performancës si dhe analizës SWOT me qëllim evidentimin e fuqive, dobësive, shanseve dhe kërcënimeve që prekin punën audituese brenda Departamentit në veçanti por edhe KLSH-së në përgjithësi. Korniza e Matjes së Performancës konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për menaxhimin, matjen, identifikimin dhe raportimin e performancës së aktivitetit të vetë, me qëllim përmirësimet e mëtejshme, për arritjen e objektivave e synuara.

Auditimin e TI në KLSH mbështetet në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit si dhe Legjislacionin dhe Standartet Shqiptare të fushës.

Gjatë vitit 2018, në bashkëpunim me specialistët e Projektit IPA, Drejtoria e Auditimit TI konsolidoi Manualin Aktiv të TI në gjuhën shqipe. Pas miratimit nga titullari, ky Manual po përdoret në çdo auditim të TI.

Për vitin 2018 DATI, sipas planit vjetor të auditimeve, të miratuar nga Kryetari KLSH kishte parashikuar të kryente 6 auditime, të cilat janë realizuar 100%. Konkretisht: në 6 subjekte janë kryer auditime të sistemeve të teknologjisë së informacionit, dhe në 1 rast është kryer auditim tematik,

në 4 subjekte mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2017 dhe 4 mujorit të parë të vitit 2018.

Në këto auditime janë zbuluar 120 gjetje dhe janë rekomanduar masat respektive për përmirësimin e gjendjes.

Gjatë vitit 2018 vijoi dhe u thellua më tej tendenca e rritjes së numrit të auditimeve dhe e gjetjeve përkatëse, si më poshtë:

Rezultatet e punës audituese u prezantuan në 4 prezantime të vecanta gjatë analizës. Në funksion të dhënies së suportit mbi elemente të Teknologjisë së Informacionit në auditimet financiare e të përputhshmërisë audites të Departamentitsë kanë marë pjesë në 5 auditime të grupeve të departamenteve të tjera.

Gjatë vitit 2018 në përmbushje të objektivit strategjik si dhe rekomandimit të kuvendit, struktura e auditimit të teknologjisë së informacionit në KLSH e përbërë nga 8 audites pësoi ndryshim në dy faza:

- Ndarjen nga Departamenti i Auditimit të Investimeve të Huaja dhe daljen si drejtori në varësi direkte nga Drejtori i Përgjithshëm.
- Krijimin e Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit

Në fund u përcaktuan dhe u diskutuan objektivat e Departamentit të Auditimit TI për vitin 2019.

Po në datën 4 shkurt 2019 u zhvillua analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit (DABSH). Në këtë analizë morën pjesë zv. Kryetari, znj. Lindita Lati dhe Drejtoresha e Përgjithshme, znj. Manjola Naço. Drejtori i Departamentit, z. Azmi Stringa mbajti fjalën hapëse ku paraqiti arritjet edhe problematikat kryesore të identifikuara gjatë auditimeve të realizuara gjatë vitit 2018, rekomandimet e lëna dhe shkallën e ndjekjes së tyre.

Për vitin 2018, grupet e auditimit të këtij departamenti kanë ushtruar auditime në 24 subjekte, nga të cilat 23 auditime sipas planit vjetor dhe 1 auditim i trashëguar ne proces nga plani i vitit të mëparshëm. Sipas natyrës së auditimeve, në 10 subjekte janë kryer auditime të përputhshmërisë të aktivitetit, në 4 subjekte janë kryer auditime tematike të përputhshmërisë së aktivitetit, në 8 subjekte janë kryer auditime të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë dhe në 2 subjekte janë kryer auditime të përputhshmërisë dhe financiar të aktivitetit.

Në përfundim të auditimeve, në zbatim të standardeve të auditimit financiar dhe auditimit të përputhshmërisë, pas auditimit të pasqyrave financiare dhe përputhshmërinë e përdorimit të fondeve publike janë dhënë sipas rastit, opinione për auditimet financiare dhe veçmas opinione për auditimet e përputhshmërisë. Gjatë vitit 2018 u vu në fokus dhe realizimi i auditimeve financiare me asistencën e specialistëve të NIK-ut polak, kjo dhe në kuadër të projektit të binjakëzimit i financuar me fondet IPA 2013. Auditimet financiare pilot të zgjedhura ishin subjektet ISSH dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë (aparati). Në MFE opinioni ka rezultuar i kundërt si për pasqyrat

financiare ashtu edhe për përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor; dhe në ISSH opinioni ka rezultuar i kualifikuar për përputhshmërinë dhe refuzim opinioni për pasqyrat financiare. Në total, janë dhënë opinione në 12 auditime, ku bazuar në evidencat e auditimit dhe gjykimin profesional të grupeve të auditimit sipas llojit janë dhënë 4 opinione të kualifikuara, 8 opinione të kundërt, 1 refuzim opinioni dhe 1 opinion i pakualifikuar. Për vitin 2018 në auditimet e kryera janë lënë gjithsej 519 rekomandime për përmirësimin e gjendjes dhe problematikave të konstatuara, krahasuar me 409 rekomandime që ishin dhënë një vit më parë. Për përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore janë bërë 18 rekomandime, 249 masa organizative, masat për shpërblim dëmi ekonomik të shkaktuara, të konstatuara gjatë auditimeve të vitit 2018 janë në shumën 2,287,634 mijë lekë, 14 masa administrative, 138 masa disiplinore dhe masat për eliminimin e efekteve negative të shkaktuara, të konstatuara gjatë auditimeve të vitit 2018 janë në shumën159,805,535 mijë lekë, dhe 2 indicie për kallëzim penal.

DABSH është përgjegjës për përgatitjen e raportit "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2017", ku për herë të parë është formuluar dhe opinioni i pavarur i KLSH bazuar në standardet ndërkombëtare të auditimit. Në përfundim të auditimit, rezultoi se për disa zëra buxhetorë, përfshirë nivelin e deficitit dhe borxhit publik, për shkak të rëndësisë dhe përhapjes së çështjeve të përmendura në këtë raport, ka devijime materiale (sasiore dhe cilësore) në drejtim të hartimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Procesi i ekzekutimit të buxhetit të shtetit nëpërmjet sistemit të thesarit nga të gjitha hallkat, rezulton me thyerje të përhapura të zbatimit të kontrolleve dhe masave parandaluese, detektuese, dhe korrigjuese që do të garantonin disiplinimin fiskal të sektorit publik. Procesi i buxhetimit, rishikimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit të tij rezulton të jetë akomodues dhe legjitimues ndaj shkeljeve të disiplinës fiskale nga entet publike, duke mundësuar marrjen e angazhimeve financiare pa fonde në dispozicion si dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura. Detyrimet e prapambetura dhe stoku në rritje i rimbursimit të TVSH nuk reflektohen në treguesit e konsoliduar fiskal, treguesin e deficitit, dhe treguesin e borxhit publik, duke mos dhënë një pamje të drejtë të aktivitetit financiar publik për vitin 2017. KLSH ka konstatuar që shumë nga masat dhe përmirësimet e akteve ligjore dhe nënligjore të hartuara me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, eliminimin e mundësive për mos raportimin në kohë të shpenzimeve, dhe marrjen e angazhimeve financiare pa fonde buxhetore, në

bashkëpunim dhe me FMN, kanë rezultuar joefikase dhe të pazbatuara. Masat administrative për disiplinimin e menaxhimit financiar publik, të përcaktuara në ligj, kanë qenë në disproporcion me numrin e shkeljeve të kryera nga entet publike.

Në vijim, takimin e përshëndeti zv. Kryetari, znj. Lindita Lati, ku theksoi rëndësinë dhe kontributin e DABSH në përmbushjen e misionit të KLSH gjatë vitit 2018 dhe në vijim. Drejtori Përgjithshëm, Zj. Manjola Naço, në fjalën e saj tha që viti 2018 ka qenë një vit, në të cilin standardi i punës është rritur ndjeshëm dhe si rrjedhojë kjo përbën një sfidë për vitin 2019 duke e vënë DABSH përpara përgjegjësisë për të ruajtur minimalisht të njëjtin standard pune dhe rezultatesh. Për të bërë të mundur këtë, duhet një angazhim maksimal i audituesve të Departamentit, ku secili të kontribuojë me rezultate dhe jo të bazohemi në punën e një grupi të vogël audituesish.

Më pas analiza vjetore vijoj me prezantimin nga audituesit e disa prej auditimeve kryesore të kryera nga DABSH gjatë vitit 2018.

Gjatë analizës u diskutuan dhe objektivat për të vitin 2019, që duhet të jenë në vëmendje të çdo audituesi të këtij departamenti.

Në datën 4 shkurt 2019, Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore zhvilloi analizën vjetore të punës për vitin 2018, referuar aktivitetit auditues të Departamentit për këtë periudhë. Në analizë morën pjesë Zv/Kryetarja e KLSH-së, znj. Lindita Milo dhe Drejtori i Përgjithshëm, znj. Manjola Naço.

Në analizën e Departamentit u pasqyrua realizimi i planit të vitit 2018, gjetjet nga auditimet dhe u përcaktuan objektivat për vitin 2019. Gjithashtu, u pasqyrua se eksperienca e fituar dhe zhvillimet institucionale kanë konfirmuar se procesi i modernizimit të institucionit të auditimit të jashtëm publik kontribuon për një qeverisje efektive dhe është një vlerë e shtuar në sistemin e institucioneve publike.

Gjatë vitit 2018 me Vendimin e Kryetarit KLSH ishin planifikuar 32 auditime, ndërsa janë realizuar dhe evaduar 39 auditime, pra 7 auditime mbi planin vjetor. Ku 12 auditime "Financiare dhe të Përputhshmërisë" (i kombinuar); 18 auditime "Mbi të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare"; 6 auditime "Përputhshmërie; 3 auditime Tematike.

Janë rekomanduar 496 masa organizative dhe 591 masa disiplinore dhe administrative nga të cilat 187 masa disiplinore për punonjës që janë pjesë e shërbimit civil (me status nëpunësi civil), 159 masa për punonjës për të cilët marrëdhëniet e punës rregullohen me

Kodin e punës dhe 245 masa administrative, prej të cilave në 20 subjekte janë rekomanduar 141 masa administrative në kompetencë të APP, e cila ndaj tyre ka vendosur gjoba në vlerën 18,790,000 lekë.

Masa me dëm ekonomik, si dhe për të ardhurat e munguara ose shpenzimet jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit janë në shumën 15,342 milion lekë, nga të cilat shuma 719,239 mijë lekë i përket dëmit ekonomik dhe shuma 14,077 milion lekë të ardhura të munguara dhe shpenzime jo në përputhje me 3-E.

Gjatë vitit 2018 në bashkëpunim me Departamentin Juridik janë përgatitur dhe dërguar në organin e prokurorisë 8 kallëzime penale, për 36 persona, 8 Indice për kallëzim penal dhe 1 vlerësim për kallëzim penal.

Gjatë analizës u identifikuan edhe objektivat për të ardhmen, të cilat janë në një linjë me objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2018-2022, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me pritshmërinë e larta të qytetarëve, në forcimin e kapaciteteve audituese dhe të metodologjisë së auditimit që është faktor kyç në nxitjen e përdorimit me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, për një qeverisje të mirë, nëpërmjet parandalimit dhe luftës pa kompromis kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike.

KLSH merr pjesë në worshopin e zhvilluar mbi "kontributi social dhe transparenca e auditimeve ne sektorin publik"

Në datat 7 dhe 8 shkurt 2019, u zhvillua në Budapest të Hungarisë një workshop me fokus mbi rolin e shoqërisë në veprimtarinë e SAI-t dhe transparencën e auditimeve në sektorin publik, ku u angazhuan përfaqësuesit e shtatë institucioneve të auditimit shtetëror evropian. Qëllimi i anëtarëve të grupit të projektit ishte që tëkontribuojnë dhe bëjnë aktivitetin e tyre të dobishëm për shoqërinë sa më shumë që të jetë e mundur, për të ndarë praktikat e tyre të mira përkatëse me njëri-tjetrin dhe për të zhvilluar kapacitetet e tyre në këtë fushë në mënyrë inovative. KLSH mori pjesë në worshopin e zhvilluar mbi "kontributi social dhe transparenca e auditimeve ne sektorin publik", si pjesë e Grupit Ndërkombëtar te Projektit të EUROSAI-t.

Këto seminar profesionale përshëndeti Presidenti i SAO, z. László Domokos dhe ekspertët e SAI-ve mbajtën prezantimet profesionale për praktikat e tyre të mira në kontributin social. Pjesëmarrës dhe kontribues në këtë panel ishte dhe Kontrolli i Lartë të Shtetit, ku në rastin studimor të prezantuar u konsideruan të rëndësishme aspekte të tilla si, organizimi i muajit të hapur ku qytetarët informohen mbi aktivitetin e KLSH, kontributi i audituesve të KLSH me shkrime mbi auditimin publik në shtypin e përditshëm, niveli i zbatimit te rekomandimeve nga angazhimet, prezenca ne mediat e shkruara dhe elektronike e gjetjeve dhe rekomandimeve te KLSH, vlerësimi i

ankesave dhe kërkesave të qytetarëve, sondazhet dhe matja e perceptimit publik mbi rolin e SAI në mirëqeverisje, konferencat shkencore ndërkombëtare dhe përthithja e mendimit te akademikeve dhe botes universitare, etj. Rasti i studimit i prezantuar u ndoq me shume interesim dhe me pyetje te shumta nga pjesëmarrësit ne panel.

Ky seminar ishte në vijim të proceseve të filluara në vitin 2017, ku Kongresi i 10-të i Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) miratoi Planin e ri Strategjik 2017-2023 të EUROSAI. Një element kryesor i këtij plani është rritja e kapacitetit të reagimit ndaj sfidave dhe mundësive të reja, si dhe mbështetja në zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve audituese. Duke shprehur angazhimin e saj, Zyra e Auditimit te Hungarisë SAO-ja krijoi grupin e projektit të kontributit shoqëror për të përmbushur këtë objektiv, i cili buron nga standardet ndërkombëtare të auditimit (ISSAI 12, ISSAI 20), duke synuar përdorimin e mjeteve të ndryshme, dhe duke kërkuar përgjigjen ndaj pyetjes se çfarë mjetesh objektive mund të përdoren për të monitoruar rolin shoqëror të auditimeve të financave publike në nivelet e shfrytëzimit.

Një nga objektivat kryesore të projektit është të zhvillohet një udhëzues praktik i zbatueshëm në praktikë për institucionet e auditimit shtetëror të vendeve anëtare të EUROSAI, bazuar në metodologjinë uniforme ndërkombëtare mbi shfrytëzimin shoqëror të auditimeve shtetërore (financave publike). Prandaj, gjate dy ditëve te seminarit u diskutua dhe u punua per redaktimin e ketij udhëzuesi ndërkombëtar, i përpiluar nga anëtarët e grupit të projektit.

Pjesëmarrësit diskutuan dhe kaluan çdo kapitull të këtij manuali, duke futur modifikimet dhe plotësimet e kërkuara. Sapo të përfundojë puna e redaktimit, dokumenti i përmirësuar dhe i finalizuar do te publikohet. Gjatë punës së bashku, anëtarët e grupit u përgjigjën në 75 pyetje kryesore dhe gjate workshopit pjesë-marrësit diskutuan mbi rastet e institucioneve të tyre të auditimit shtetëror.

Doracaku i hartuar nga grupi i projektit i kushton vëmendje të veçantë praktikave dhe metodologjive të mira, të aplikueshme dhe efikase, si dhe treguesve që mundësojnë matjen e tyre. Për më tepër, udhëzimet ndërkombëtare theksojnë aspekte të ndryshme nga të cilat mund të trajtohet një çështje sociale. Praktikat e ndryshme të mira theksojnë se në fushën e shfrytëzimit shoqëror nuk ekziston vetëm një zgjidhje e mirë për institucionet e auditimit, por një sërë mundësish që mund të zbatohen në aktivitetet dhe funksionet e tyre të përditshme.

Auditues të Teknologjisë së Informacionit të KLSH-së zhvillojnë një takim me një grup audituesish nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës

Në datat 28 shkurt dhe 1 mars 2019, një grup audituesish të Teknologjisë së Informacionit nga Zyra Kombëtare e Auditimit nën udhëheqjen e Ndihmës Auditores së Përgjithshme znj. Vlora Spanca dhe Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Performancës dhe të Teknologjisë së Informacionit z. Samir Zymberi, morën pjesë në një takim për Auditimet e Teknologjisë së Informacionit në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit. KLSH u përfaqësua në këtë takim nga një grup audituesish nën udhëheqjen e Drejtorit të Departamentit të Auditimit të TI-së z. Kozma Kondakçiu.

Zv/Kryetarja e KLSH dhe njëkohësisht Drejtoresha e Përgjithshme znj. Lindita Milo, përshëndeti takimin dhe u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve. Në fjalën e saj znj. Milo theksoi se ndarja e eksperiencave të ngjashme në fushën e auditimit të teknologjisë së informacionit ndihmon audituesit në krijimin praktikave të mira në auditimin e sistemeve të teknologjisë informative dhe mbështetjen e një qasjeje inovative të auditimit të TI-së.

Në ditën e parë të takimit znj. Spanca prezantoi mënyrën e organizimit të Departamentit për auditimet e TI-së në ZKA, punën e deritashme dhe përbërjen e stafit. Në fjalën e saj znj. Spanca theksoi se nga ana e Zyrës Kombëtare të Auditimit është bërë një punë e dobishme në rekrutimin e audituesve të Teknologjisë së Informacionit dhe trajnimin e tyre me qëllim realizimin e auditimeve cilësore dhe të mbështetur në standardet ndërkombëtare. Më pas fjalën e mori z. Samir Zymberi, i cili prezantoi auditimet e Teknologjisë së Informacionit të realizuara nga ZKA dhe mbështetjen e audituesve IT në Auditimet e Performacës apo Rregullshmërisë.

Nga ana e KLSH, fjalën e mori Drejtori i Departamentit të Auditimit të TI-së z.Kozma Kondakçiu, i cili prezantoi organizimin e Departamentit të Auditimeve të IT në KLSH, stafin dhe punën ndër vite në auditimet e TI-së. Më pas fjalën e mori z. Meald Habazaj, auditues, i cili bëri një demostrim të Manualit Aktiv të Auditimit IT, mjet i cili ka si objektiv kryesor vendosjen në praktikë të “Manualit WGITA - IDI mbi Auditimin e IT-së për Institucionet Supreme të Auditimit", i cili ndihmon audituesin me informacione thelbësore për të planifikuar një auditim të IT-së, mbledhjen e gjetjeve dhe shkëmbimin e njohurive.

Në ditën e dytë të takimit fjalën e mori z. Aldo Kita, auditues dhe Përgjegjës i Sektorit të TI-së në KLSH, i cili prezantoi eksperiencën e auditimit të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për platformën e-Albania, metodat, standardet e përdorura dhe gjetjet kryesore të auditimit. Më pas znj. Elsona Papadhima, audituese, mbajti një prezantim mbi “Audituesit IT, si

mbështetës në auditimet e Performancës, Përputhshmërisë dhe Financiare" me fokus kryesor përdorimin e teknikave CAAT, analizimin e të dhënave dhe metodat vizualizuese.
Në përmbyllje të takimit dy ditor të dyja palët diskutuan mundësitë për të realizuar auditime të përbashkëta në fushën e Teknologjisë së Informacionit me përfitime të ndërsjella.

Të dy ditët e takimit u ndoqën me shumë interes, ku u shkëmbyen përvojat në zbatimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit publik dhe praktikave të ndryshme në fushën e auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Kjo vizitë i shërbeu thellimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, si dhe shkëmbimit të përvojave në nivel praktik dhe teknik në fushën e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Gjatë takimit nuk munguan pyetjet, sugjerimet dhe ndarja e eksperiencës midis palëve pjesëmarrëse.

Vizite studimore në Ministrinë e Reformave dhe shpenzimeve publike të Irlandës në kuadrin e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike

Kontrolli i Lartë i Shtetit si Institucioni më i Lartë i Auditimit Publik është konsideruar si një nga shtyllat kryesore të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Financave Publike, nëpërmjet të cilit do të sigurohet mbikqyrja e funksionimit dhe efektivitetit të sistemit të mirë-administrimit financiar publik në Shqipëri.

Në 28 Shkurt – 2 Mars 2019, dy përfaqësues të KLSH znj. Luljeta Nano, Sekretare e Përgjithshme dhe Znj. Albana Gjinopulli, Drejtore e Departamentit të Metodologjisë dhe Sigurimit të Cilësisë, morën pjesë në vizitën studimore që u organizua në Dublin, Irlandë nga Projekti " Asistencë Teknike për krijimin e kapaciteteve për Strategjinë MFP".

Qëllimi i vizitës ishte mundësimi i eksplorimit nga pjesëmarrësit i praktikave të mira në lidhje me përparësitë kryesore të reformës së MFP-së për të ecur përpara, brenda një konteksti të revitalizuar, me qëllim rritjen e impaktit të reformës. Irlanda është konsideruar nga FMN dhe BE si një histori suksesi në rimëkëmbjen nga një krizë masive financiare dhe fiskale ndër vendet anëtare të BE-së.

Përveç përqëndrimit në prioritetet kryesore të reformës së MFP kjo mundësoi njohjen me disa prej faktorëve dhe qasjet optimale për rritjen e ritmit të ndryshimeve në zbatimin e rishikuar të Strategjisë. Axhenda e organizuar në Ministrinë e Reformave dhe Shpenzimeve Publike përfshiu prezantime dhe diskutime ndërmjet kolegeve të fushave kryesore të menaxhimit të financave publike të tilla si, Reforma ne Konsolidimin e Buxhetit, Këshilli Fiskal, Shpenzimet Kapitale duke i dhënë një pjesë të veçantë fokusit mbi

rëndësinë që mbikqyrja e reformave ka pasur dhe ka në suksesin e synuar.

Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2014 -2020 për Shqipërinë, ka vendosur si objektiv të përgjithshëm: arritjen e një buxheti më të mirë-balancuar dhe të qëndrueshëm me një raport të ulur të borxhit publik nëpërmjet konsolidimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe proceseve të auditimit, ku ekzekutimi i buxhetit është i lidhur siç duhet me politikat e Qeverisë. Vizioni i reformës në sistemin e Menaxhimit të Financave Publike është garantimi i një sistemi të financave publike që nxit transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik.

Auditimi publik luan një rol të rëndësishëm në mbikqyrjen aktive të këtij sistemi. Në mënyrë të veçantë tre komponentët e auditimit publik: Auditimi i Jashtëm (SAI-Institucioni Suprem i Auditimit), auditimi i brendshëm si dhe Autoriteti i Auditimit për fondet e BE-së krijojnë një mekanizëm të plotë, nëpërmjet të cilit Parlamenti i vendit merr siguri mbi shkallën e përgjegjshmërisë së treguar nga zyrtarët qeveritarë në përdorimin e fondeve publike.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka një rol të rëndësishëm në Menaxhimin e Financave Publike në vend duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në qëllimin e kësaj strategjie për rritjen e transparencës për Parlamentin, sektorin financiar, komunitetin e biznesit, partnerët ndërkombëtarë dhe publikun e gjerë, politikat e ndjekura dhe përpjekjet e bëra për forcimin e MFP-së në vend.

Nën këtë aspekt, ruajtja dhe forcimi i pavarësisë së SAI-t, kryerja e auditimeve në pajtueshmëri të plotë me Standartet e INTOSAI-t dhe forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm publik konsiderohen si një hallkë e zinxhirit të vlerës në mirë-dmisnitrimin e fondeve publike.

Reforma në sistemin e menaxhimit të financave publike nuk do të mund të konsiderohet e plotë nëse komponenti i auditimit publik nuk do të siguronte një mbikqyrje efektive, e cila do të sjellë impakte të rëndësishme në jetën ekonomiko-financiare të vendit.

KLSH merr pjesë në Workshop-in me temë "Rregullat Fiskale dhe Institucionet e Pavarura Fiskale-Mundësitë për të siguruar qëndrueshmëri fiskale"

Në datën 6 Mars 2019, u zhvillua në Vjenë të Austrisë një Workshop me temë "Rregullat Fiskale dhe Institucionet e

Pavarura Fiskale – Mundësitë për të siguruar qëndrueshmëri fiskale".

Tryeza, mblodhi rreth 55 pjesëmarrës duke përfshirë dhe zyrtarë të lartë të politikave fiskale nga vendet e Ballkanit perëndimor si ministra, zëvendësministra, drejtorë të përgjithshëm të buxhetit, përfaqësues të SAI-ve dhe anëtarë të Institucioneve të pavarura fiskale (Këshillat fiskalë). Gjithashtu në këtë tryeze morën pjesë dhe përfaqësues të Komisionit Evropian, Këshillit Fiskal Evropian, EBRD dhe EUROSTAT. Në këtë workshop, mori pjesë dhe zv. Ministri i Financave dhe Ekonomisë z. Erjon Luçi dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit morën pjesë z. Azmi Stringa, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Buxhetit dhe znj. Valbona Gaxha, Kryeauditueset pranë të njëjtit departament.

Workshop-in e përshëndeti Linda Van Gelder, Drejtor Rajonal i Bankës Botërore për Ballkanin perëndimor. Objektivi i workshop-it ishte shkëmbimi i eksperiencave, njohurive për një qasje praktike në dizenjimin e rregullave fiskale dhe fuqizimi i rolit të tyre mbështetës në praktikat e menaxhimit financiar publik. Gjithashtu u diskutuan sfidat operacionale në themelimin e këtyre strukturave të pavarura dhe sfida për ruajtjen e pavarësisë së tyre.

KLSH merr pjesë në Konferencën e tretë të Përbashkët EUROSAI-ASOSAI

Në datat 10-14 Mars 2019 në Jeruzalem u zhvillua Konferenca e tretë e përbashkët e dy organizatave të rëndësishme të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) : EUROSAI dhe ASOSAI. Në këtë aktivitet morën pjesë 42 SAI nga vendet e Europës dhe të Azisë dhe kishte rreth 130 pjesëmarrës. KLSH u përfaqësua në këtë aktivitet nga zj.Manjola Naço, Drejtore e Përgjithshme dhe zj.Irena Islami, Drejtore e Drejtorisë së Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

Tema kryesore e kësaj konference ishte trajtimi i çështjeve dhe situatave të emergjencës sepse ne jetojmë në një kohë kur çështje të tilla prekin shpesh jetët, kombet dhe shoqëritë tona. Kjo konferencë e tretë e EUROSAI-ASOSAI iu bashkua kësaj tendence dhe trajtoi këto nën-tema të rëndësishme:

- Situatat e emergjencës: përgatitja për përballimin e katastrofave natyrore (tërmete, zjarre, cunami, etj);

menaxhimi i katastrofave; sulmet terroriste; sigurinë kibernetike; etj.

- Çështje që lidhen me emergjencat: trajtimi i sfidave që lidhen me emigracionin; plakja e popullsisë; pensionet; zhvillimi i qëndrueshëm, dixhitalizimi, Big Data, etj.

Gjatë seancave plenare dhe sesione të veçanta u trajtuan gjerësisht këto tema nga drejtues dhe përfaqësues të SAI-ve, si edhe nga profesorë të Universiteteve dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Me shumë interes u ndoqën temat që trajtuan çështje të Big Data, auditimit në kohë reale të situatave të emergjencës, si të rrisim kontributin e SAI-ve në zhvillimin e qëndrueshëm, si janë të përgatitura shtete të ndryshme për përballimin e katastrofave natyrore, roli i SAI-ve në arritjen e objektivave kombëtare, menaxhimi i situatave të emergjencës, trajtimi i plakjes së popullsisë dhe menaxhimi i pensioneve, si të menaxhojmë çështje të etikës në botën dixhitale, etj.

Shumë interesant ishte një sesion special qe lidhej me trajtimin e çështjeve të auditimit të sulmeve kibernetike, të cilat lidhen me parandalimin, zbulimin dhe reagimin e menjëhershëm ndaj këtyre sulmeve. Kibernetika është aktualisht një çështje shumë e rëndësishme dhe vazhdimisht këto sulme janë në rritje dhe për këtë arsye janë subjekt i politikave të reja që po ndërmarrin shtete të ndryshme. Shumë pak auditime ka në këtë fushë, prandaj SAI-t duhet të reagojnë shumë shpejt dhe të analizojnë politikat e reja, të identifikojnë risqet, të ofrojnë zgjidhje dhe të ndërtojnë kapacitetet e nevojshme njerëzore në këtë fushë të re auditimi. Fjala e Profesor Eviatar Matania, i Universitetit të Tel-Avivit dhe Drejtorit të Shkollës mbi studimet në fushën e sigurisë ishte shumë praktike dhe pjesëmarrësit e ndoqën me interes, duke bërë pyetje dhe duke diskutuar. Çështjet që lidhen me sulmet kibernetike patën një trajtim praktik gjatë vizitës në aeroportin "Ben Gurion" të Izraelit.

Ky aeroport ka një reputacion shumë të mirë në botë në fushën e sigurisë, operacioneve, sigurisë kibernetike dhe menaxhimin komercial.

Pjesëmarrësit në këtë konferencë patën mundësinë që të vizitojnë impiantin më të madh të ç'kripëzimit të ujit të detit në botë, i cili ndodhej pak kilometra larg Jeruzalemit. Ky impiant është shembulli më domethënës i industrisë së re të ç'kripëzimit të ujit të detit. Ky impiant "prodhon" ujë të pijshëm për 1.5 milion njerëz, duke plotësuar 20% të kërkesave për ujë të pijshëm në Izrael, duke punuar njëkohësisht edhe në drejtim të ruajtjes së ambientit, duke minimizuar impaktin në eco-sistem.

Konferenca u mbyll me vizita që lidhen me historinë e pasur të këtij të vendi.

KLSH merr pjesë në Tryezën e rrumbullakët organizuar nga SIGMA dhe OECD lidhur me rritjen e impaktit të auditimeve në publik

Në datën 20-21 mars 2019, në Paris u zhvillua tryeza e rrumbullakët "Praktikat e raportimit për të rritur impaktin e auditimeve në publik". Ky aktivitet u zhvillua nga SIGMA në bashkëpunim me OECD dhe SAI-n e Malit të Zi. Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin vendet kandidate, potencial kandidate dhe përfaqësues të Gjykatës Evropiane të Audituesve.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte rritja e ndikimit të auditimeve në publik dhe përcjellja e mesazhit nëpërmjet një gjuhe sa më të thjeshtë dhe të perceptueshme për publikun e gjerë.

Tryeza e rrumbullakët mblodhi së bashku SAI-t e Shqipërisë, Bosnje&Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Turqisë. Kontrolli i Larte i Shtetit në këtë aktivitet u përfaqësua nga z. Artur Hasanbelliu, Drejtor i Audimit të Brendshëm, z. Gjovalin Preci, Drejtor i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë dhe znj. Amantja Patozi Specialiste në Drejtorinë e Komunikimit.

Rritja e efektivitetit të raportimit është një objektiv i qëndrueshëm afatgjatë i shumicës së SAI-ve. SAI-t e pranojnë se raportimi me cilësi të lartë është thelbësor për ndërtimin e besimit në integritetin dhe objektivitetin e institucionit, i cili rrjedh nga dërgimi i raporteve të duhura tek audienca e duhur në kohën e duhur.

Objektivat kryesore të tryezës së rrumbullakët ishin krijimi i një platforme për diskutim midis SAI-ve të Rrjetit në lidhje me sfidat me të cilat përballen SAI-t në arritjen e rezultateve që synojnë me punën dhe raportet e tyre të auditimit dhe zgjidhjet e mundshme që mund të gjenden.

Tryeza e rrumbullakët ishte interaktive dhe u bazua në prezantime të rasteve. Ekspertët nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE) njoftuan pjesëmarrësit rreth praktikave të BE-së dhe SAI-t e Rrjetit ndanë praktikat e tyre aktuale të raportimit dhe përpjekjet që ata kanë bërë për të rritur ndikimin e punës së auditimit përmes raporteve të tyre.

Tryeza gjithashtu u ofroi pjesëmarrësve mundësinë për t'u takuar jo-formalisht, për të krahasuar përvojat kombëtare dhe për të diskutuar çështje specifike mes kolegëve.

KLSH merr pjesë në kremtimin e 20 vjetorit të krijimit të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë së Veriut

Në datën 29 Mars 2019 në Shkup të Maqedonisë u kremtua 20 vjetori i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë së Veriut. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga SAI-t e rajonit e më gjerë, si : Kosova, Mali i Zi, Bullgaria, Serbia, Gjermania, Rumania, Polonia, Turqia, Kroacia, etj. Morën pjesë deputetë të

parlamentit të Maqedonisë, si edhe Zv/Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, z.Goran Misovski, përfaqësues të Delegacionit të BE-së në Maqedoninë e Veriut, etj. KLSH u përfaqësua në këtë aktivitet nga zj.Lindita Milo, Zv/Kryetare e KLSH-së dhe zj.Irena Islami, Drejtore e Drejtorisë së Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

Takimin e përshëndeti fillimisht Zv/Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, z.Goran Misovski, i cili uroi audituesit për këtë përvjetor të rëndësishëm. Zoti Misovski vlerësoi shumë bashkëpunimin e mirë që ka pasur mes Kuvendit dhe Zyrës Shtetërore të Auditimit. Ndryshimet e fundit që u bënë në Ligjin për funksionimin e Zyrës Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë së Veriut kishin për qëllim përafrimin e këtij legjislacioni me atë të vendeve të Bashkimit Europian. Zyra Shtetërore e Auditimit ka audites profesionistë, të pavarur dhe punon që të jetë gardian i qytetarëve për ruajtjen e parasë publike.

Zv/Kryetari i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë së Veriut, z.Naser Ademi bëri bilancin e punës 20 vjeçare të këtij institucioni, duke theksuar se rezultatet e mira të punës janë arritur me gërshetimin

e punës së të gjithë brezave të audituesve. Zyra Shtetërore e Auditimit ka sot rol parësor-nënvizoi z.Ademi në sistemin e kontrollit financiar për shpenzimin me përgjegjësi të fondeve publike në Maqedoninë e Veriut. Zoti Ademi evidentoi gjithashtu sfidat e institucionit në të ardhmen, të cilat janë të vendosura në Strategjinë e Zhvillimit të kësaj Zyre për periudhën 2018-2022. Zyra Shtetërore e Auditimit duke u mbështetur në resurset njerëzore dhe strategjinë për IT, do të orientohet drejt forcimit të pavarësisë dhe integritetit të institucionit, ngritjes profesionale të audituesve dhe përmirësimit të cilësisë së punës audituese.

Më pas e mori fjalën Presidenti i Gjykatës Turke të Llogarive (TCA), z.Seit Ahmet Bas, i cili solli urimet më të mira për përvjetorin e 20-të të SAI-t të Maqedonisë së Veriut dhe përcolli gjithashtu mënyrën e funksionimit të TCA dhe marrëdhëniet e saj me Parlamentin.

Aktualisht Zyra Shtetërore e Auditimit të Maqedonisë së Veriut është duke implementuar me SAI-n Bullgar dhe Kroat një projekt Binjakëzimi, që i dedikohet marrëdhënieve të SAI-t me Parlamentin, auditimit të Prokurimeve Publike, auditimit

të Performancës, etj. Pikërisht këtij projekti iu referua gjatë fjalës së tij Presidenti i SAI-t Bullgar, z.Tzvetan Tzvetkov, duke vlerësuar këtë bashkë-punimin dhe ekspertizën e audituesve maqedonas.

Aktivitetin e përshëndetën edhe z. Freek Janmaat, nga Delegacioni i BE-së në Maqedoninë e Veriut, z. Besnik Osmani, Auditues i Përgjithshëm i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, zj. Nedilkja Rogosic, Asistente e Auditorit të Përgjithshëm të Kroacisë, etj.

Diskutime dhe pyetje pati edhe pas fjalës së zj.Liljana Kuzmanovska, Kryetare e Komisionit të Financave dhe Buxhetit në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut.

